



**Komuna e
Junikut**

2012/2017


...për qytetin tim!

Plani Lokal i Veprimit në Mjedis



Plani Lokal i Veprimit në Mjedis

2012/2017



Komuna e Junikut

Projekti është financuar nga:



Agjencia Suedeze për Zhvillim dhe Bashkëpunim Ndërkombëtar.

Zbatimi i projektit është mbështetur edhe nga:



MMPH dhe MAPL.

Ky projekt është zbatuar nga:



REGIONAL ENVIRONMENTAL CENTER

Qendra Rajonale e Mjedisit, REC – Zyra në Kosovë.

Botim i Qendra Rajonale e Mjedisit, REC – Zyra në Kosovë.
<http://kosovo.rec.org/>; <http://www.rec.org/>

PLANI LOKAL I VEPRIMIT NË MJEDIS 2012/2017

Copyright © 2012 REC

Të drejtat e botimit të këtij publikimi i mban:

Qendra Rajonale e Mjedisit, REC – Zyra në Kosovë

Design & Layout: Arben Grajqevci (Rrjeti)

Shtypi: RRJETI, Prishtinë

Përmbajtja

Ç'është REC?	8
Fjala e Kryetarit të Komunës.....	9
Fjalorthi i shkurtesave.....	10
Akterët dhe përgjegjësitë e PLVM-së.....	11

Pjesa 1

I. HYRJE	17
Detyrimet ligjore për hartimin e PLVM-së	17
Plani lokal për Veprim në Mjedis ka për qëllim të:	17
Metodologjia e përgatitjes së PLVM-së	18
Dokumenti është i hartuar mbi tri baza kryesore:.....	19

Pjesa 2

I. Profili i Komunës	23
1. Informata të përgjithshme për Junikun	23
Historiku	23
1.2. Profili demografik	24
1. 2. 1. Popullsia	24
1. 2. 2. Trendi dhe prognoza demografike:	25
1. 3. Gjendja sociale	25
1. 3. 1. Punësimi dhe papunësia	25
1. 3. 2. Të ardhurat	26
1. 3. 3. Varfëria dhe asistenca sociale	26
1. 3. 4. Strehimi	26
1. 3. 5. Migrimi.....	26
1.3.6. Organizimi i shoqërisë civile	26
1.4. Barazia gjinore	27
1. 5. Mirëqenia sociale	27
1. 6. Shëndetësia	27
1. 7. Gjendja në arsim dhe shërbimet arsimore:	28

1. 8. Sipërfaqja, dendësia e banimit	29
1. 8. 1. Njësia Urbane	29
1. 8. 2. Njësia Fushë	29
1. 8. 3. Njësia Pyje	30
1. 8. 4. Njësia Bjeshkë	30
1. 9 Infrastruktura rrugore.....	31
Transporti publik.....	33
1. 9. Rrjeti elektrik	33

Pjesa 3

II. Vlerësimi i gjendjes ekzistuese	35
2.1 Gjendja fiziko - gjeografike.....	35
Lokacioni – Pozita Gjeografike	35
2.2 Gjendja mjedisore	37
Ndotja urbane	43
2. 3. Mbeturinat	44
2. 4. Ajri 45	
2. 5. Toka	45
Tokat erozive.....	47
2. 6. Pyjet	47
Të dhënat kryesore për sipërfaqen dhe vëllimin:	48
2. 7. Uji 49	
2. 8. Biodiversiteti natyror.....	52
2. 9. Zhvillimi ekonomik.....	58

Pjesa 4

III. Anketa me qytetarë dhe identifikimi i problemeve	65
Rezultatet e hulumtimit në Komunën e Junikut	65
Të dhëna bazike rreth të intervistuarve	65
SHPËRNDARJA E MOSTRËS PËR KOMUNËN E JUNIKUT	65
1. PERCEPTIMI PËR GJENDJEN E TANISHME MJEDISORE.....	66
1.1. Gjendja e tanishme mjedisore në territorin e Komunës suaj:.....	66
1.2 Pesë (5) problemet kryesore në fushën e mjedisit në Komunën tuaj:	66
1.3 Tre (3) ndotësitë kryesorë të mjedisit në territorin e Komunës tuaj:	67
2 STRATEGJIA E ZHVILLIMIT DHE INFORMIMIT	68
2.1 Çka duhet të jetë bazë e zhvillimit të ardhshëm të Komunës suaj?	68
2.2 A posedon Komuna personin/shërbimin që merret me mbrojtjen e mjedisit?.....	68

3	VIZIONI ZHVILLIMOR.....	69
3.1	Çfarë mendoni se do të jetë gjendja e mjedisit në pesë (5) vjetët e ardhshme në territorin e Komunës suaj?.....	69
3.2	Rrumbullakësoni tri (3) problemet që më së shumti ndikojnë negativisht në cilësinë e jetës, në lagjen tuaj?.....	70
	Identifikimi i problemeve.....	71
	Problemet mjedisore në Komunën e Junikut	71
1.	Uji	72
2.	Toka	73
3.	Ajri	74
4.	Biodiversiteti	75
5.	Mjedisi social dhe ekonomik	76
6.	Turizmi	77

Pjesa 5

IV.	Planifikimi i veprimeve	79
1.	Uji	79
2.	Toka	80
4.	Biodiversiteti	82
3.	Ajri	82
5.	Mjedisi social dhe ekonomik	83
6.	Turizmi	84
	Plani i veprimit për zbatim Turizmi.....	86



Ç'është REC?

Qendra Rajonale e Mjedisit (REC) është organizatë ndërkombëtare neutrale, joavokuese dhe jofitimprurëse, e cila mbështet zgjidhjen e problemeve mjedisore në Evropën Qendrore dhe Lindore (EQL). Kjo qendër e përmbush misionin duke promovuar bashkëpunim ndërmjet Organizatave Jo Qeveritare (OJQ), qeverive, bizneseve si dhe personave tjerë kyç mjedisor si dhe duke përkrahur këmbimin e lirë të informatave dhe pjesëmarrjen publike në vendimmarrjen për mjedis. REC është themeluar në vitin 1990 nga Shtetet e Bashkuara të Amerikës, Komisioni Evropian dhe Hungaria.

Aktualisht, REC bazohet ligjërisht në Kartën e vet, nënshkruar nga qeveritë e 29 vendeve dhe Komisioni Evropian dhe në një marrëveshje ndërkombëtare me qeverinë e Hungarisë. Zyra qendrore e REC-ut është në Szentendre, Hungari si dhe zyrat fushore dhe zyrat e shteteve në 17 vendet përfituese.



Fjala e Kryetarit të Komunës

“Juniku vërtet Unik”

Të menduarit për jetën dhe vlerat e saj, bartjen e këtyre vlerave të trashëguara gjeneratave që vijnë, është detyrim njerëzor, por edhe ligjor. Dhe në këtë kontekst, duke pas parasysh se jeta është vetë natyra (mjedisi), detyrimisht obligohemi që t'i qasemi kësaj problematike, ani pse nuk është gjithkund njësoj e shprehur.

E filloj fjalën time me moton: “Juniku vërtet Unik” ngase mundësinë e të qenit në zemër të natyrës nuk e ka çdokush, por janë raste të rralla, unike. I tillë është Juniku. Gërsheton: urbanen me natyrën, të butën me të egrën, rrafshin me kodrën, fushën me malin. Prandaj, ruajtja e mjedisit kërkon qasje në nivele të ndryshme të organizimit të shoqërisë, duke filluar nga individ, si element fundamental i shoqërisë.

Për këtë arsye edhe kemi filluar Hartimin e Planit Lokal të Veprimit në Mjedis (PLVM) që është dokument i politikave mjedisore vendore, i cili jep orientimet për mënyrat e shfrytëzimit dhe mbrojtjes së mjedisit, duke vendosur përgjegjësit para përgjegjësiave dhe njëkohësisht aktivitetet dhe koston e këtyre aktiviteteve.

Qëllimi i PLVM-së është që të orientojë kahet e zhvillimit mjedisor, por edhe mbrojtjes së tij përmes hartimit të politikave të përbashkëta në kontekst të zhvillimit ekonomik për qytetën në zemër të natyrës – Junikun.

Agjencia Suedeze për Zhvillim Ndërkombëtar (Sida), në vazhdimësi përmes organizatave të ndryshme, po e ndihmon Komunën tonë, e cila lindi dhe po rritet, njëkohësisht, bashkë me vendin dhe gjithsesi ka nevojë për mbështetje të natyrave të ndryshme.

Prandaj, dua të shfrytëzoj rastin që në emrin tim, të qytetarëve të mi dhe të Komunës së Junikut në përgjithësi të falënderoj për bashkëpunim dhe mbështetje Agjencinë Suedeze për Zhvillim Ndërkombëtar (Sida), e cila ka financuar hartimin e këtij dokumenti dhe Qendrën Rajonale për Mjedis – REC e cila ofroi ndihmë profesionale në hartimin e këtij dokumenti.

*Singerisht:
Agron KUÇI
Kryetar i Komunës së Junikut*

Fjalorthi i shkurtesave

KK	- Kuvendi Komunal
KEK	- Korporata Elektro-Energjetike e Kosovës
AKMM	- Agjencia e Kosovës për Mbrojtjen e Mjedisit
APK	- Agjencioni Pyjor i Kosovës
ASK	- Agjencioni i Statistikave të Kosovës
BE	- Bashkimi Evropian
IKSHPK	- Instituti Kombëtar i Shëndetit Publik i Kosovës
ISHP	- Instituti i Shëndetit Publik
MAPL	- Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal
MMPH	- Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor
MShP	- Ministria e Shërbimeve Publike
OBSH	- Organizata Botërore e Shëndetësisë
OJQ	- Organizata Joqeveritare
PKVM	- Plani i Kosovës për Veprim në Mjedis
PLVM	- Plani Lokal i Veprimit në Mjedis
PM10, PM2.5	- Grimcat e suspenduara në ajër
PZHK	- Plani Zhvillimor Komunal
PZHU	- Plani Zhvillimor Urban
VNM	- Vlerësimi i Ndikimit në Mjedis
VSM	- Vlerësimi Strategjik Mjedisor
QKMF	- Qendra Kryesore e Mjekësisë Familjare
REC	- Qendra Rajonale e Mjedisit
Sida	- Agjencia Suedeze për Zhvillim dhe Bashkëpunim Ndërkombëtar

Akterët dhe përgjegjësitë e PLVM-së

Ky Projekt është implementuar nga:

Qendra Rajonale e Mjedisit, REC (Regional Environmental Center) - Zyra në Kosovë.

Koordinatorë e REC për PLVM:

Eranda BAÇI

Komuna e Junikut

Koordinatorë e Komunës për PLVM:

Ferdane TOFAJ

Anëtarët e Trupit Koordinues:

1. Faik Tofaj – kryetar i TK
2. Sinan Gacaferri – anëtar
3. Ferdane Tofaj – anëtare

Personat dhe grupet e ndryshme që janë përfshirë në hartimin e PLVM-së për Komunën e Junikut janë:

- | | |
|------------------------|---|
| 1. Ferdane Tofaj | – ing. Dipl. Arkitekturës, Komuna e Junikut |
| 2. Flurije Shehu | – gjeodete, Komuna e Junikut |
| 3. Xhemë Shehu | – gjeodet, Komuna e Junikut |
| 4. Tafë Tofaj | – teknikë i pylltarisë, Komuna e Junikut |
| 5. Shkelzen Shehu | – teknik i bujqësisë, Komuna e Junikut |
| 6. Drenushe Gagjerri | – gazetare, Komuna e Junikut |
| 7. Arton Krasniqi | – profesor, Komuna e Junikut |
| 8. Beqë Gacaferri | – profesor, Komuna e Junikut |
| 9. Leonard Lllolluni | – linguist, Komuna e Junikut |
| 10. Ali Gacaferri | – ing. Dipl. i Bujqësisë, Komuna e Junikut |
| 11. Saranda Isufi | – ekonomiste, Komuna e Junikut |
| 12. Isuf Balaj | – ekonomist, Komuna e Junikut |
| 13. Blerta Lokaj | – ekonomist, Komuna e Junikut |
| 14. Dinë Maloku | – inspektor i tregut, Komuna e Junikut |
| 15. Venera Shala | – juriste, Komuna e Junikut |
| 16. Teuta Jaha | – ing. Dipl. Arkitekturës, UN HABITAT |
| 17. Lumnije Gacaferri | – teknike e ushqimit, K.U.R. Hidrodrini |
| 18. Syzana Krasniqi | – juriste, OJQ Sh. P. P. Gjeravica |
| 19. Bekim Gagjerra | – profesor, OJQ Sh. B. A. Rrasa e Zogut |
| 20. Safete Shehu | – studente, OJQ Qershiza |
| 21. Mirishahe Krasniqi | – OJQ Rrënja |


Gjithashtu, në hartimin e dokumentit ndihmuan:

- NDËRMARRJET PUBLIKE DHE KOMUNITETI I BIZNESIT PRIVAT;
- NDËRMARRJET PUBLIKE PËR MENAXHIMIN E MBETURINAVE;
- KOMPANITË RAJONALE TË UJËSJELLËS-KANALIZIMEVE DHE;
- SHOQËRIA CIVILE DHE QYTETARËT.

Legjislacioni i Republikës së Kosovës në fushën e mbrojtjes te mjedisit harmonizuar me standardet evropiane që është përdorur si referencë për përgatitjen e PLVM-së.

- Ligji për Mbrojtjen e Mjedisit (2009/03-L-025)
- Ligji për Mbeturinat (2005/02-L30)
- Ligji për Mbrojtjen e ajrit (2004/30)
- Ligji për Mbrojtjen e bimëve (2006/02-L95)
- Ligji për Mbrojtjen e natyrës (2005/02-L18)
- Ligji për Mbrojtjen e varieteteve të bimëve (2007/02-L98)
- Ligji për Mbrojtjen nga zhurma (2007/02-L102)
- Ligji për Mbrojtjen nga zjarri (2006/02-L41)
- Ligji për Bujqësi dhe zhvillim rural (2009/03-L-98)
- Ligji për Bujqësi organike (2007/02-L122)
- Ligji për Gjuetinë (2005/02-L53)
- Ligji për Plehrat Artificiale (2003/10)
- Ligji për Planifikim Hapësinorë (2003/14)
- Ligji për Pyjet (2004/29)
- Ligji për Ujërat (2004/24)
- Ligji për Ujitjen e tokave bujqësore (2005/02-L9)
- Ligji për Vlerësimin e ndikimit në mjedis (2009/03-L-024)
- Ligji për Vetëqeverisje Lokale (2008/03-L040)
- Ligji për Zonat e veçanta të mbrojtura (2008/03-L039)
- Ligji për Vlerësimin Strategjik Mjedisor (2009/03-L-015)
- Udhëzimi administrativ Nr 02/07 për mbeturina nga Bateritë dhe Akumulatorët
- Udhëzimi administrativ Nr 03/07 për administrimin e vajrave të përdorura mbeturinë
- Udhëzimi administrativ për automjete e hedhura dhe mbeturinat e tyre, 20.12. 2006
- Udhëzimi administrativ Nr. 12/2008 për asgjësimin e mbeturinave medicinale
- Udhëzimi administrativ Nr. 05/2008 për administrimin me mbeturinat medicinale
- Udhëzimi administrativ Nr. 05/2009 për administrimin e mbeturinave publike
- Udhëzimi administrativ Nr. 04/2009 për ndëshkime dhe gjoba mandatore
- Planin Kombëtar për Veprim në Mjedis i Kosovës, 2006- 2010

Baza ligjore për hartimin e PLVM-së



vendimin për themelimin e përbërjen e Grupit Koordinues dhe Grupit punues për hartimin e Planit Lokal për Veprim në Mjedis e nxjerrë Kryetari i Komunës së Junikut me propozim të Drejtorisë për Urbanizëm, Kadastër dhe Mjedis.

VI

Plani Lokal për Veprim në Mjedis në përputhje me këto udhëzime dhe nën kushtet dhe parametrat e ligjit të cekur duhet të zbatohen sipas dispozitave ligjore, rregulloreve dhe normave përmes buxhetit të komunës së Junikut.

VII

Projekti prioritar që do të dal nga dokumenti i Planit Lokal për Veprim në Mjedis do të bashkë financohet nga Qendra Rajonale për Mjedis (në shumë jo më të lartë se 40.000,00 €) dhe Komuna e Junikut (në shumë prej 20.000,00 €) sipas nenit 4 paragrafi 4 dhe nenit 5 paragrafi 6 të Marrëveshjes me numër 01-4-2889.

VIII

Ky Vendim hyn në fuqi ditën e miratimit nga Kuvendi i Komunës së Junikut

Me këtë vendim njoftohen

1. Zyra e Kryetarit,
2. Drejtoria për Urbanizëm Kadastër dhe Mjedis,
3. Arkiva e Komunës.



Pjesa 1

I. HYRJE

Planet Lokale të Veprimit në Mjedis (PLVM) janë dokumente të politikës mjedisore vendore, të cilat paraqesin prioritete mjedisore dhe listën e veprimeve për zgjidhjen e tyre. Përgatitja e këtyre planeve zhvillon më tej aftësitë e pushtetit vendor dhe subjekteve të tjera të interesuara për mjedisin dhe komunitetin.

Gjithashtu, PLVM nxit bashkëpunimin midis shoqërisë civile, publikut, pushtetit vendor dhe atij qendror, biznesit dhe subjekteve të tjera mjedisore, duke përkrahur shkëmbimin e lirë të informacionit dhe pjesëmarrjen publike në procesin e vendimmarrjes.

Detyrimet ligjore për hartimin e PLVM-së

Përgatitja e PLVM-së është e detyrueshme për vendet e Evropës Qendrore dhe Lindore që kanë filluar procesin e asocim-stabilizimit dhe që synojnë të integrohen në BE. Për vendin tonë, hartimi i këtyre planeve nga qeverisjet vendore është detyrë ligjore, e përcaktuar në **Nenin 24 të Ligji për mbrojtjen e mjedisit Nr.03/L-25**

Plani lokal për Veprim në Mjedis ka për qëllim të:

- Zgjidh problemet mjedisore nëpërmjet identifikimit të prioriteteve dhe përcaktimit të veprimeve për zgjidhjen e tyre, duke përfshirë të gjithë aktorët e mundshëm për përcaktimin e këtyre veprimeve dhe krijimin e strategjive për zbatimin e tyre në mënyrë efektive, të ndërthurura sipas një Plan Veprimi.
- Zhvillojnë shoqërinë civile nëpërmjet forcimit të koordinimit dhe komunikimit ndërmjet sektorëve të ndryshëm në komunitet, duke sjellë së bashku përfaqësues të komuniteteve të ndryshme që përfaqësojnë interesa të ndryshme në këto komunitete, përfshirë autoritetet vendore, përfaqësues të OJQ-ve, biznesin, shkencëtarë, duke shpjeguar teknikat specifike që organizatorët lokalë mund të përdorin për të përcaktuar aktorët kryesorë të procesit, të rrisin pjesëmarrjen dhe kontributin e publikut në proces, për rekrutimin dhe punën me vullnetarët dhe nxitjen e bashkëpunimit ndërmjet grupeve të interesuara dhe organizatave.

- Rrisin aftësitë e qeverisjes vendore dhe komunitetit për paraqitjen e elementëve thelbësore të planit të veprimit të komunitetit, duke vlerësuar problemet dhe mundësitë komunitare, duke organizuar komitete qytetare, duke përfshirë publikun, përcaktimin e prioriteteve, hartimin e strategjive dhe zhvillimin e një Plan Veprimi.
- Rrisin shkëmbimin e informacionit në nivel lokal nëpërmjet sjelljes së shembujve dhe modeleve nga plane të mëparshëm të komuniteteve nga të cilat pjesëmarrësit mund të nxjerrin ide dhe teknika të zbatueshme në rastet konkrete të tyre, të mbledhin me kujdes informacion mbi gjendjen e tanishme të mjedisit.
- Japin zgjidhje konkrete për problemet e komunitetit me anë të shkëmbimit të përvojave lidhur me përdorimin e aftësive në analiza, planifikime, debate dhe vlerësime që janë thelbësore për një veprim të komunitetit efektiv. Duke u dhënë pjesëmarrësve mundësinë për të vënë në praktikë punën në grupe, duke u marrë me zgjidhjen e problemeve praktike nëpërmjet ndërveprimit të grupeve të vogla të punës.

Metodologjia e përgatitjes së PLVM-së

Plani Lokal i Veprimit në Mjedis për Komunën e Junikut u hartua përgjatë një periudhe njëvjeçare dhe në hartimin e tij, janë përfshirë akterë të pushtetit vendorë dhe komuniteti i gjerë. Për këtë u ngrit një grup pune me specialistë të fushave të ndryshme (ambientalizëm, arkitekturë, turizëm, shëndetësi, arsim, sport, trashëgimi kulturore, etj.), të cilët punuan në bashkëpunim me ekspertë tjerë vendor dhe ndërkombëtarë për hartimin e PLVM.

Së pari, është bërë trajnimi i grupit punues të cilët u ftuan në projekt në aspektet e hartimit të PLVM-së dhe gjetjes së mjeteve shtesë për realizimin e aktiviteteve për përmirësimin e cilësisë mjedisore.

Në kuadër të projekti për hartimin e Planit Lokal për Veprim në Mjedis (PLVM), është bërë një anketim i qytetarëve të Komunës së Junikut. Ka qenë një numër i konsiderueshëm i pyetësorëve, të cilët kanë ndihmuar dhe orientuar grupin punues në mënyrë më të drejtë në zgjedhjen e fushave prioritare. Një falënderim për këtë i takon qytetarëve të Komunës së Junikut dhe shoqërisë civile, e cila në procesin e anketimit të respondentëve ka ndihmuar që procesi i anketimit të jetë i suksesshëm. Për të pasur një përfshirje sa më të gjerë dhe për të marrë mendimet e komunitetit dhe shoqërisë civile, janë organizuar edhe debate publike dhe debate në media.

Dokumenti i është paraqitur Kuvendit Komunal të Junikut dhe është miratuar prej tij më 03.08.2012, duke e kthyer atë në një dokument zyrtar pune.

Procesi themelor i hartimit të PLVM-së ndahet në faza, të cilat lidhen njëra pas tjetrës:

- a) Nënshkrimi i marrëveshjeve të mirëkuptimit në mes të REC – Komunë;
- b) Aktivitetet përgatitore;
- c) Formimi i trupit koordinues TK;
- d) Formimi i grupit punues GP;
- e) Trajnimi i anëtarëve të GP;
- f) Vizionimi i komunitetit;
- g) Vlerësimi i gjendjes së mjedisit;
- h) Anketimi i qytetarëve;
- i) Caktimi i prioriteteve;
- j) Hartimi i planit të veprimit për fushat prioritare dhe;
- k) Caktimi i prioriteteve në realizimin e planit të veprimit.

Dokumenti është i hartuar mbi tri baza kryesore:

1. Analiza e gjendjes mjedisore

Paraqet një analizim të hollësishëm të situatës për të gjitha çështjet e marra në konsideratë nga plani, duke e paraqitur atë në të gjitha aspektet e tij dhe të ndërlidhura ndërmjet tyre. Kjo analizë shërben për të pasur një ide më të qartë të problemeve mjedisore, të cilat shqetësojnë Komunën e Junikut.

2. Lista e problemeve mjedisore

Problemet mjedisore paraqiten sipas një matrice të paracaktuar, e cila jep në mënyrë të detajuar të gjithë treguesit për identifikimin e një problemi. Pjesët më të rëndësishme të kësaj matrice janë shkaktarët e problemit dhe prioriteti për secilin.

3. Plani i veprimeve për zgjidhje

Ky kapitull është pjesa më e rëndësishme e Planit, pasi paraqet të gjitha veprimet dhe projektet e mundshme për zgjidhjen e problemeve mjedisore të përcaktuara.

Kjo matricë u shërben autoriteteve vendore për të hartuar projektet konkrete dhe për sigurimin e fondeve nga donatorët.

VIZIONI

“Juniku vërtet Unik - park etnografik dhe ekologjik, qendër turistike në rajon dhe pjesë e parkut kombëtar”.

Vizioni për të ardhmen e Komunës së Junikut është vazhdimësi e qëllimeve të definuara me Planin Hapësinor të Kosovës, ku territori i Junikut i takon “Urave të Kosovës” Zona e verdhë.

Vizioni për Zonën e Verdhë: Urë e zhvillimit të lidhjeve të Kosovës me rajonin, rrjet funksional i qyteteve të fuqishme dhe fshatrave dinamike, atraktive për të jetuar dhe punuar në to. Duke shfrytëzuar kapacitetet e infrastrukturës, pozitën gjeografike dhe pasuritë e shumta natyrore, kulturore dhe humane, të zhvillohet në një hapësirë të qëndrueshme ekonomike agro-industriale, tregtare, shërbëse dhe turistike.

Juniku llogaritet si vend me potencial dhe traditë bujqësore, blegtorale, bletarisë dhe e një pylltarie të zhvilluar. Rajon me ndërmarrje të zhvilluara të qëndrueshme, konkurruese në tregun vendor dhe jashtë tij. Me biznese të vogla të orientuara kryesisht kah potencialet ekzistuese të zhvillimit si: plantazhet e mollës, përpunimi i drurit, industria e lehtë etj.

Për të realizuar këtë është e nevojshme që zhvillimi ekonomik në përgjithësi dhe i turizmit në veçanti të bëhet duke transformuar Junikun në vend të qetë për investitorë dhe turistë vendorë dhe të huajë. Përmirësimi i mjedisit, ruajtja dhe ngritja e resurseve dhe vlerave natyrore dhe ofrimi i kushteve për një zhvillim të qëndrueshëm për nevojat e komunitetit dhe qytetarëve në tërësi. Pastaj, ruajtja, mbrojtja dhe rehabilitimi i monumenteve të trashëgimisë kulturore dhe historike, si dhe rritja e atraksionit për investitorët e jashtëm dhe të brendshëm përmes përgatitjes së ofertës lokale zhvillimore. Meqenëse, Juniku fuqishëm mbështetet tek turizmi është e domosdoshme mbrojtja dhe ruajtja e mjedisit me të gjitha karakteristikat që ka, qoftë ato natyrore apo ato të krijuara dhe të jetë ofertë atraktive për vizitorë. Për këtë do të shfrytëzohen burimet:

- Energjetike;
- Ekologjike;
- Uji (minihidrocentralet);
- Toka (energji termale);
- Ajri (shfrytëzimi i energjisë së erës) dhe;
- Llojlojshmëria e bimëve mjekuese.

Qëllimet:

- Q1. Krijimi i kushteve të favorshme për zbatimin e PLVM-së;
- Q2. Promovimi i mjedisit të pastër dhe atraktiv, sidomos ansamblit të majave e sidomos dy pikave më të larta në Kosovë Gjeravica dhe Gusani, zhvillimi ekonomik në përgjithësi dhe turizmi në veçanti, duke e bërë Junikun vatër mikpritjeje për investues dhe vizitues;
- Q3. Përmirësimi i mjedisit, shfrytëzimi i resurseve dhe vlerave natyrore në favor të një zhvillimi të qëndrueshëm;
- Q4. Inventarizimi, ruajtja, mbrojtja, rehabilitimi dhe funksionalizimi i monumenteve natyrore e kulturore dhe;
- Q5. Bashkëpunimi ndërkufitar për zhvillime me interes të përbashkët në fushën mjedisore.

Synimet:

1. Ulja e shkallës së ndotjes, ndalimi i degradimit mjedisor dhe mbrojtja e burimeve (resurseve) natyrore;
2. Zhvillimi hapësinor i balancuar dhe ruajtja e tokës bujqësore;
3. Sigurimi i qasjes në infrastrukturë për të gjithë dhe ofrimi i shërbimeve publike cilësore;

4. Aplikimi i politikave që promovojnë zhvillim të qëndrueshëm në përgjithësi;
5. Ruajtja dhe ripërtirja e trashëgimisë kulturore;
6. Shfrytëzimi i resurseve në mënyrë të planifikuar edhe për gjeneratat e ardhshme dhe;
7. Vendosja e kontrollit dhe menaxhimi i zonave të rrezikuara nga degradimet e ndryshme.

Prioritetet strategjike:

1. Nisma për krijimin e parkut të paqes: Kosovë – Shqipëri – Mal i Zi;
2. Hartimi i një strategjie për ruajtjen e llojllojshmërisë;
3. Hartimi i një studim fizibiliteti për Bjeshkët e Junikut;
4. Hartimi i programeve për riciklim të mbeturinave;
5. Ofrimi i infrastrukturës së domosdoshme për krijimin e kushteve për investime në zhvillimin ekonomik e në veçanti në turizëm;
6. Themelimi dhe operacionalizimi i transportit publik urban dhe ndër-urban, dhe;
7. Futja e të gjitha vendbanimeve në shërbime dhe infrastrukturë publike.

Pjesa 2

I. PROFILI I KOMUNËS

1. Informata të përgjithshme për Junikun

Historiku

Sipas historisë, Juniku së pari ishte pjesë e Dardanisë Ilire, më pas e Perandorisë Romake, Bizantine e më vonë pjesë e Perandorisë Osmane. Materialet arkeologjike të zbuluara me gjetje rasti ose kërkime të tërthorta të terrenit, vendbanimi antik “Gradina” i zbuluar në grykën e majës së Gjeravicës, së bashku me materialin epigrafik të gjetur në këtë vendbanim, si dhe një mori vendbanimesh tjera të Junikut, mbetjet antike të gjetura në rrafshin aluvial të Erenikut etj., dëshmojnë se Juniku ka qenë një vendbanim Ilir.

Të dhënat arkeologjike të shekujve VIII-X tregojnë se në ato vise ku nuk është vendosur kolonizimi sllav ka lulëzuar një kulturë thjeshtë shqiptare që është quajtur kultura e Komanit, emër ky i një fshati në luginën e Rrafshit të Dukagjinit.

Gjatë kohës së feudalizmit të zhvilluar, Juniku, sikurse Gjakova e rrethinat e saj, si dhe tërë Kosova ishin përfshirë në shtetin feudal serb. Në kohën e Mbretërisë serbo-kroate-Sllovene, shqiptarët ishin shumicë dërmuese e popullsisë në rrethinën e Junikut, por që është shoqëruar me migrime masive të popullsisë të shkaktuara nga ngjarjet historike, ekonomike, politike etj.

Në fillim të sundimit osman, bazuar në defterët osmanë, përkatësisht në ata të Sanxhakut të Shkodrës të vitit 1485, Juniku ishte fshat shumë i madh dhe sikurse Gjakova ishte krijuar para ardhjes së këtij sundimi. Juniku deri më 26. IX. 1462 qeverisej nga Leka i III-të Dukagjini. Në këtë kohë, Juniku edhe pse ishte fshat, përshkruhet si qendër pazari, ashtu sikur Gjakova. Njihej me emrin Lunik dhe po ashtu ishte edhe qendër e kazasë Alltun-Ilia me gjithsej 52 shtëpi.

Gjatë shekujve XV-XVI, kisha ortodokse serbe e cila pranoi vasalitetin e sulltanit, përpiquej në çdo mënyrë t’i serbizojë shqiptarët ortodoksë dhe t’i ortodoksojë ata katolikë. Islamizimi i popullsisë së Junikut ishte një goditje e rëndë për pozitën e kishës ortodokse serbe, pasi popullsia e Junikut dhe rrethinat e saj ishin islamizuar, në këmbim të lejimit të ekzistencës së kishës së Deçanit. Kështu, në vitin 1570-1571, në Junik ndërtohet xhamia e parë në lagjen Çok e emërtuar sipas lagjes. Më vonë u ndërta edhe Xhamia në lagjen Hoxhaj në qendër të fshatit. Islamizimi e përqaftuan edhe një pjesë e aristokracisë shqiptare për të ruajtur privilegjet e veta klasore.

Nga fundi i shek. XVI, rrethina e Altun-Ilut, Peja e Gjakova janë përfshirë në kufijtë e Sanxhakut të Dukagjinit. Kjo gjendje është ruajtur edhe gjatë shekullit të XVII-të.

Gjatë viteve 1921-1923 Juniku me vendim të Konferencës së Ambasadorëve në Paris caktohet si zonë neutrale dhe njihet me emrin “Zona Neutrale e Junikut”.

Gjatë viteve 1945-1960 Juniku ekziston si Komunë. Ndryshimet politike të sistemit të atëhershëm rezultuan me suprimimin e Komunës së Junikut në vazhden e ristrukturimit të qeverisjes lokale (eliminohen rrethet), me ç’rast Juniku inkorporohet brenda Komunës së Deçanit.

Më 22 korrik 2005 nënshkruhet Urdhëresa Administrative e UNMIK-ut nr. 2005/11 për themelimin e pesë Pilot Njësive Komunale përfshirë edhe Junikun. Sipas vendimit të UNMIKU-ut nr. 2005/21, MAPL bën përcaktimin e përbërjes territoriale për secilën Pilot Njësi Komunale.

Kurse, me hyrjen në fuqi të Kushtetutës së Kosovës (15 qershor 2008) dhe miratimin e Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale, Juniku certifikohet si Komunë (më datë 13 gusht 2008, sipas shkresës njoftuese nga MAPL me numër protokoll: 02-527) me të njëjtat kompetenca dhe përgjegjësi si komunat e tjera në Republikën e Kosovës, me zonat kadastrave Junik, Jasiq dhe Gjocaj.

Burimi: Të dhënat historike nga Komuna

1.2. PROFILI DEMOGRAFIK

1. 2. 1. Popullsia

Sipas statistikave të vitit 1981 dhe disa shënimeve të pasluftës, kur Juniku u themelua si Pilot Njësi Komunale, numëronte rreth 12.500 banorë, përfshirë fshatrat: Gjocaj, Jasiq, Voksh, Sllup dhe Ras-tavicë. Ndërsa, në vitin 2008 me miratimin e Kushtetutës dhe Ligjit për Kufijtë Administrativë Juniku bëhet komunë me dy zona kadastrale. Zona kadastrale e Junikut dhe zona kadastrale Gjocaj dhe Jasiq dhe vlerësohet të ketë 9.600 banorë me diasporën (sipas LFPL).

Tabela 1. Popullsia e Junikut gjatë viteve. (Burimi: ESK, 2009.)

Nr. rend.	Vendbanimet	Popullsia						Ekonomitë Familjare						2008
		1948	1953	1961	1971	1981	1991	1948	1953	1961	1971	1981	1991	
		1	2	3	4	5	6	7	8	9	10	11	12	
1	Gjocaj	210	180	138	161	215	306	34	24	18	25	24	40	-
2	Jasiq	231	376	190	251	295	306	27	56	24	29	30	33	2
3	Junik	2,391	2,439	3,024	3,445	4553	5490	378	385	462	460	541	690	622
	Juniku gjithsej	2832	2995	3,352	3857	5063	6102	439	465	504	514	595	763	624

¹ Juniku komunë u zyrarizua në fund të vitit 2008

Të dhënat e fundit zyrtare nga ESK (2009) nga anketimi “Popullsia, ekonomitë familjare, sipas vendbanimeve dhe organizimi territorial i Kosovës deri në vitin 2008, tregojnë se Juniku, si vendbanim, ka 624 ekonomi familjare, 5423 anëtarë rezidentë, 1427 objekte ndërtimore, kurse fshatrat Jasiq- Gjocaj kanë 2 ekonomi familjare me gjithsej 7 anëtarë dhe 38 objekte ndërtimore.

Në tabelën e mëposhtme janë të dhënat për popullsinë sipas moshës dhe gjinisë. Më se 50 % e popullsisë janë nën moshën 26-vjeçare. Raporti gjinor është pothuajse i balancuar (F:M=50.26 %: 49.74 %). Popullsia i përket etnisë shqiptare.

Tabela 2. Popullsia, sipas moshës dhe gjinisë, nga analizat në terren.
(Përfshirë popullsinë në diasporë)

Popullsia sipas moshës dhe gjinisë											
1-7		8-18		19-25		26-40		41-64		>65	
M	F	M	F	M	F	M	F	M	F	M	F
7.06%	6.54%	9.92%	10.46%	8.48%	7.71%	12.70%	11.67%	8.60%	8.95%	2.98%	4.93%
13.60%		20.38%		16.19%		24.37%		17.55%		7.91%	

1. 2. 2. Trendi dhe prognoza demografike:

Popullsia e Junikut paraqitet mjaft “delikate” ndaj ndryshimeve ekonomike sado të vogla qofshin ato, apo edhe nga faktorë të jashtëm të cilët influencojnë zhvillimet demografike dhe ekonomike në qytezë. Por, pavarësisht mungesës së informacioneve zyrtare, mund të themi se Juniku është vendbanim në zhvillim dhe me tendencë për t’u rritur, prandaj është i domosdoshëm kontrolli dhe udhëzimi për këtë zhvillim. Parashikimi demografik është bazuar në llogaritjen e shkallës së shtimit të popullsisë në nivelin e Kosovës (e cila sipas statistikave të nxjerra nga Enti i Statistikave të Kosovës është rreth 1.4 %). Sipas këtij trendi, Juniku pritet që në vitin 2023+ ti ketë rreth 11.000 banorë (nëse merret e dhëna zyrtare prej 9 600 banorëve, përfshirë diasporën). Duke ditur që të dhënat në terren dhe ato nga ESK tregojnë një situatë ndryshe, numri i banorëve rezident në Junik (sipas të dhënave të ESK) deri në 2023 pritet të jetë rreth 6 600 banorë (pra pa diasporën).

1. 3. GJENDJA SOCIALE

1. 3. 1. Punësimi dhe papunësia

Ashtu sikur në tërë Kosovën, shkalla e papunësisë edhe në Komunën e Junikut është e lartë dhe paraqet një aspekt shqetësues. Nga të dhënat e marra në terren, nga anketimi, del se nga popullsia aktive për punë (të moshës 19-64 vjeç) vetëm 22.76 % e tyre janë të punësuar, respektivisht të papunë janë 77.24 %, e popullsisë aktive. Nga 22.76 % e të punësuarve, 4.03 % janë femra, ndërsa 18.73 % meshkuj, që do të thotë se raporti i punësimit sipas gjinisë është gati F:M=1:5.

Deri sa ishin në funksion kapacitetet prodhuese, numri i të punësuarve ka qenë shumë më i madh e sidomos në Fabrikën e Konfeksionit në Junik, ku kanë punuar më tepër se 230 punëtorë. Në mungesë të punësimit në këto kapacitete një numër i të punësuarve kanë gjetur mundësinë e punësimit në bizneset e vogla private. Përveç mosfunksionimit të kapaciteteve prodhuese, faktorë të tjerë që kanë ndikuar më së shumti në rritjen e shkallës së papunësisë janë:

- Procesi i privatizimit (Pronat e Ndërmarrjes Shoqërore Ereniku);
- Kushtet e vështira ekonomike dhe pozita gjeografike;
- Mungesa e investimeve në infrastrukturë;
- Mungesa e investimeve në sektorin e bujqësisë dhe;
- Mungesa e politikave të nivelit Qendror në krijimin e vendeve të reja të punës.

Tabela 3. Numri i të punësuarve në sektorin publik në Komunën e Junikut, sipas viteve.
(Burimi: GAP, 2009.)

Viti	Nr total i të punësuarve në arsim, shëndetësi dhe administratë
2009	141 ▲
2008	118 ▼
2007	119 ▲
2006	15 ▲

Të dhënat për vitin 2009 nga hulumtimi i GAP-it tregojnë se numri i të punësuarve në sektorin publik është 141. Krahasuar me vitin 2008, numri i shërbyesve civil është rritur për 23 persona. Mirëpo, sipas informatave nga Komuna numri i të punësuarve arrin në 160 dhe atë 83 të punësuar në arsim, 23 në shëndetësi dhe 54 në administratën publike.

1. 3. 2. Të ardhurat

Të ardhurat kryesore vijnë nga përpunimi dhe tregtimi i produkteve bujqësore dhe blegtorale. Mirëpo, duke pasur parasysh numrin e madh të junikasve që gjenden jashtë vendit (përgjithësisht në Zvicër dhe Gjermani), konsiderohet që ndihma ekonomike që vjen nga jashtë përbën gjithashtu një burim të ardhurash të rëndësishme për Komunën. Sipas anketimit, rezultatet mbi të ardhurat mesatare familjare janë si vijon:

Tabela 4. Të ardhurat mesatare sipas anketimit në terren

Të ardhurat	< 201 €	%	201 €	%	>201 €	%	S'ka përgjigje
Nr. i familjeve	248	33.47 %	175	23.61 %	165	22.26 %	20.64%

1. 3. 3. Varfëria dhe asistencë sociale

Sipas të dhënave nga Qendra për Punë Sociale e Komunës së Junikut, gjithsej janë 650 individë apo 12.6 % e popullsisë rezidente në Junik që jeton në varfëri. Kjo vlerë tregon se kemi të bëjmë me shkallë të mesme të varfërisë meqë % e popullsisë që marrin asistencë sociale është në vlerat 4-22 %. Rritjes së shkallës së varfërisë i kanë kontribuar: shkalla e lartë e papunësisë, shkatërrimi masiv gjatë luftës etj.

1. 3. 4. Strehimi

Komuna e Junikut nuk ka probleme të të pastrehëve dhe e gjithë popullata kanë strehim adekuat, duke marrë parasysh edhe atë se lagjja “Agim Ramadani” është duke u shfrytëzuar në një formë si banim social dhe strehim për banorët e zhvendosur nga fshatrat Jasiq dhe Gjocaj.

1. 3. 5. Migrimi

Në mungesë të regjistrimit të popullsisë, nuk dihet numri i saktë zyrtar i familjeve që jetojnë në diasporë. Sipas anketimit të bërë në terren, për nevoja të Planit Zhvillimor Komunal, del se 25 % e popullsisë së Junikut jeton jashtë Kosovës dhe interesimi për të migruar jashtë në kërkim të kushteve më të mira për jetë dhe gjetjen e mundësive për punësim është ende prezent. Kjo sipas anketimit është shprehur në gati 12 % të familjeve, të cilat kanë deklaruar se kanë të interesuar për të migruar jashtë vendit, e shprehur sidomos tek rinia mashkullore.

1.3.6. Organizimi i shoqërisë civile

Shoqëria civile në Komunën e Junikut është e organizuar dhe si e tillë është edhe aktive. Ndoshta jo në nivelin e dëshiruar, por sido që të jetë ka shoqëri që janë mjaft entuziaste për lëvizjen e gjërave dhe shtyrjen e proceseve përpara.

1.4. Barazia gjinore

Barazia gjinore është një gur bazik në procesin e zhvillimit demokratik të një kombi. Për të vendosur këtë gur atje ku duhet është e nevojshme të merren në konsideratë të gjitha pabarazitë gjinore që karakterizojnë sot familjen, komunitetin, tregun e punës dhe në përgjithësi shoqërinë.

Transformimi i thellë politik, social dhe ekonomik pas vitit '99, solli ndryshime të dukshme në strukturën e ekonomisë, nivelin e jetesës së popullatës, si dhe ekuilibrit gjinor në shoqërinë e Kosovës. Mirëpo, përkundër këtyre ndryshimeve, kjo nuk ka ndikuar në masë të madhe në përmirësimin e gjendjes së pozitës së grave në shoqëri. Nga pikëpamja demografike, gratë në Kosovë përbëjnë gjysmën e popullsisë. Deri në fund të viteve të '80-ta dominonte familja patriarkale, ku 2-3 breza jetonin në një familje. Mirëpo, pas viteve të '90-ta nga emigrimi që u bë jashtë Kosove dhe migrimi i popullatës nga zonat ruale drejtë zonave urbane, përshpejtuan shpërbërjen e familjes patriarkale.

Me gjithë përmirësimet në vitet e mëvonshme, papunësia dhe varfëria kërcënojnë një numër jo të vogël familjesh në Kosovë, por në mënyrë të veçantë papunësia dhe varfëria po ndikojnë negativisht në statusin social të grave.

Tradicionalisht gratë kanë barrën kryesore të mirëqenies në familje, megjithatë ato kanë më pak mundësi së burrat në përdorimin e burimeve dhe mjeteve që nevojiten për përmbushjen e përgjegjësisë të tyre. Niveli i lartë i papunësisë, niveli i ulët arsimor, angazhimi i grave në punë të pakualifikuara, mungesa e mundësive kualifikuese, qasja e dobët dhe mungesa e lirisë së përdorimit të metodave të planifikimit familjar, pastaj fakti që shumë shpesh gratë janë objekt i dhunës, i keqtrajtimit dhe veprimeve arbitrare në familje, si dhe përfaqësimi i dobët në strukturat publike drejtuese dhe politike, po ndikojnë në thellimin e varfërisë në Kosovë dhe në zgjatjen e saj.

1.5. Mirëqenia sociale

Kriza ekonomike Globale ka ndikimet e saj edhe tek në Kosovë. Kjo edhe më shumë kur dihet se ne jemi shtet i ri, i cili sapo ka dal nga lufta dhe po mundohet për rimëkëmbjen e tij.

Dhe problemet që la koha, fillimisht shkëputja e zinxhirit jetësor nga bota në fazën e paraluftës, pastaj lufta dhe sigurisht edhe paslufta, janë këta faktorë që ngulfatën mirëqenien sociale në Kosovë në përgjithësi.

Sipas statistikave të skemës sociale në Junik, numri i rasteve të përfshira në skemën e asistencës sociale në Komunë është 147 familje me 650 anëtarë. Janë edhe 4 kërkesa me rreth 20 anëtarë që janë paraqitur për të hyrë në këtë listë të asistencës sociale dhe të cilat janë në proces të shqyrtimit të kërkesës së tyre.

1.6. Shëndetësia

Shërbimet shëndetësore parësore ofrohen nga Qendra Kryesore e Mjekësisë Familjare (QKMF) e cila gjendet në qytezën e Junikut dhe numëron gjithsej 23 punëtorë të sistemuar në dy turne punësimi. Nga ky numër, katër (4) janë mjekë, dy (2) stomatologë, një (1) laborante, një (1) farmacistë, dy (2) teknikë të dhëmbëve dhe pjesa tjetër staf ndihmës dhe infermier. QKMF ofron të gjitha shërbimet e kujdesit parësor shëndetësor, si dhe shërbime Oftalmologjike dhe Stomatologjike. Qasja dhe gravitimi i banorëve deri tek QKMF është e lehtë dhe madje shfrytëzohet edhe nga banorët e disa fshatrave të Deçanit dhe Gjakovës.

Duke e marrë parasysh kriterin¹ se për 2000 banorë nevojitet një (1) mjek dhe dy (2) motra medicinale, QKMF në Junik e plotëson këtë kriter.

Aktualisht hapësira ekzistuese në kuadër të QKMF nuk është e mjaftueshme, mirëpo me realizimin e projektit të QKMF së re shërbimet shëndetësore do të përmirësohen dukshëm, si dhe do të ketë kapacitete të mjaftueshme për ofrimin e këtyre shërbimeve. Pritet që gjatë korrikut 2012 të kalohet në objekt të ri, meqenëse QKMF-ja aktualisht është e vendosur në objektin e Qendrës për Punë Sociale. Kuadri aktual mjekësor i plotëson nevojat për shërbimet e nevojshme për dy ndërrime, mirëpo me ndërtimin e objektit të ri synohet të ketë 24 orë shërbim (varësisht nëse lejohet rritja e numrit të të punësuarve nga organi përgjegjës). Shërbimet dytësore ofrohen nga spitalet rajonale të Gjakovës dhe Pejës.

1. 7. Gjendja në arsim dhe shërbimet arsimore:

Procesi edukativo-arsimor në Komunën e Junikut zhvillohet në nivelet: para-fillorë, klasa për fëmijët me nevoja të veçanta, fillorë (klasat 1-5), shkolla e mesme e ulët (6-9) dhe arsimi i mesëm i lartë. (shih.tab. 5).

Tabela 5. Gjendja e arsimit

Nr.	Niveli shkollor	Nr. nxënësve	Mësimdhënës	Administrata	Pastrues-roje	Totali
1.	Para-fillorë	79	2			2
2.	Fillorë	930	52	4	8	64
3.	E mesme	271	15	1	3	19
4.	Persona me nevoja të veçanta	5	1			1
	Totali	1285	70	5	11	86

Nëse shikohet kriteri i Bankës Botërore në shkollën fillore dhe të mesme të ulët ky kriter është respektuar dhe përkon me numrin e nxënësve dhe të punëtorëve të arsimit (21.3 nxënës 1 mësimdhënës, ndërsa në arsimin e mesëm të lartë numri i punëtorëve të arsimit është më i madh). Ndërtimi i objektit të ri të shkollës së mesme me kapacitete të mjaftueshme dhe kushte bashkëkohore ka përmirësuar kushtet e mësimdhënies në shkollën fillore, sepse janë liruar ambientet e shkollës fillore ekzistuese nga nxënësit e shkollës së mesme dhe ata munden tani të zhvillojnë mësimin në dy ndërrime e jo tri siç ka qenë më parë. Megjithatë, këto shkolla ende nuk kanë salla sporti. Arritja në shkollë, për diku rreth 90 % të nxënësve është deri diku e lehtë. Largësia më e madhe është në diametër prej 3 km dhe për këtë Komunë nuk ka obligim ligjor të siguroj transport. Qasje pak më të vështirë kanë vetëm nxënësit e lagjes “Agim Ramadani” dhe ata që vijnë nga zonat rurale edhe nga fshatrat e komunave fqinje, ku për këtë arsye është organizuar linja për transportin e nxënësve ku participohet Komunë/nxënës.

Juniku nuk ka institucione parashkollore të cilat sigurojnë shërbimet e çerdheve dhe kopshteve. Shërbimi i arsimit parashkollor është i organizuar në hapësirat e shkollës fillore, por kjo nuk do të thotë që Komunë nuk ka nevojë për të pasur institucione të tilla (sidomos çerdhe/kopshte).

Mundësitë për edukimin e personave me nevoja të veçanta fizike ekzistojnë, mirëpo familjarët në shumicën e rasteve nuk i dërgojnë fëmijët në paralele për persona me nevoja të veçanta.

Shënime për nivelin e analfabetizimit nuk ka, meqë nuk janë bërë ende statistika lidhur me këtë çështje.

¹ Organizata Botërore e Shëndetësisë, Strategjia e Kujdesit Parësor Shëndetësor dhe Projekt Plani Hapësinor i Kosovës.

1. 8. Sipërfaqja, dendësia e banimit

Nga sipërfaqja prej 7777 ha, sa ka Komuna e Junikut, afërsisht 3197 ha (41 %) janë pyje dhe 4277 ha (55 %) janë tokë bujqësore (këtu përfshihen 653 ha arë, 648 ha livadh, 253 ha pemishte, 2667 ha kullosa dhe 56 ha vreshta), ndërsa 4 % janë të tjera (rrugë, përrenj, lumenj, objekte ndërtimi, varreza etj.)². Juniku ka tokë bujqësore të konsiderueshme për kokë banori. Kalkulimet në nivel të Kosovës tregojnë se çdo vit humbet rreth 5000 Ha tokë bujqësore (kjo e dhënë nuk dihet saktë në Komunën e Junikut). Evidente janë vetëm faktet vizuale që tregojnë se toka bujqësore në Zonën Urbane po humbet nga fragmentimi i parcelave (oborreve të shtëpive), ndërtimet, ndotjet e ndryshme etj.

Shikuar nga aspekti morfologjik, sipërfaqja e Komunës së Junikut përbëhet nga disa njësi funksionale me karakteristika të ndryshme.

1. Njësia Urbane e Banimit;
2. Njësia Fushë;
3. Njësia Pyje dhe;
4. Njësia Bjeshkë.

1. 8. 1. Njësia Urbane

Ndodhet në lartësi mbidetare prej 450-600 m dhe përfshinë Zonën Urbane me 520 Ha. Është zonë administrative, arsimore, banuese e shërbimeve sociale dhe atyre ekonomike-tregtare. Të dhënat nga PZHU tregojnë se pjesa më e madhe e sipërfaqes së kësaj njësie është zonë e gjelbër dhe banimi (rreth 504 Ha), kurse pjesën tjetër e zënë funksionet ekonomike-tregtare, shërbimet sociale dhe të servisimit. Tipi i objekteve të banimit është individual me oborre të mëdha brenda së cilave zhvillohen edhe aktivitete tjera bujqësore, depozitimit të materialeve etj. (Shih më gjerësisht kapitullin e banimit). Aktualisht struktura e prodhimit bujqësor në këtë zonë dominohet nga kultura e misrit dhe e grurit që së bashku zënë rreth 40 % të sipërfaqes së tokës së punueshme, kurse pjesa tjetër është livadh.

Analiza e pronësisë: kryesisht private me përjashtim të sipërfaqeve të NSH “Ereniku”

1. 8. 2. Njësia Fushë

Kjo zonë përfshinë parcelat në jug-lindje të Junikut dhe ndodhet në lartësi mbidetare prej 450-600 m. Prania e peizazheve hidrografike të lumenjve “Erenik” dhe “Travë”, si dhe ato fushore paraqesin një mundësi të shfrytëzimit të kësaj zone për sport e rekreacion, hapësira publike, turizëm, zhvillimin e aktiviteteve ekonomike-tregtare etj. Për shkak të plleshmërisë së tokës, po ashtu kjo zonë ofron potencial për kultivimin e kulturave bujqësore, si dhe për kullosa.

Analiza e pronësisë: Pronësia në këtë zonë është kryesisht private.

² Sipas Elaboratit Kadastral të Komunës (1983).

1. 8. 3. Njësia Pyje

Zona e pyjeve përfshin një territor përafërsisht prej 3400 Ha. Në kuadër të kësaj zone ndodhen dy fshatrat Jasiq dhe Gjocaj, që aktualisht janë gati të depopulluara. Për shkak të karakteristikave morfologjike, kjo zonë shfrytëzohet për zhvillimin e aktiviteteve blegtorale, pemëtarisë, bujqësisë dhe po ashtu paraqet potencial për zhvillimin e turizmit e sidomos atij rural.

Analiza e pronësisë: Pronësia në këtë zonë është e përzier (shoqërore dhe private).

1. 8. 4. Njësia Bjeshkë

Kjo zonë përfshinë një sipërfaqe të madhe (rreth 4.000 Ha) dhe shtrihet në lartësi mbidetare të lartë. Është zonë e zhveshur, ndaj edhe nuk ka mundësi për kultivimin e kulturave vegjetative. Ajo që e bën karakteristike këtë zonë është pika më e lartë e Gjeravicës. Duke marrë parasysh këto karakteristika, kjo zonë mund të shfrytëzohet për kullosa dhe zhvillimin e turizmit malor (sidomos alpinizmit).

Analiza e pronësisë: Kryesisht shoqërore.

a. Vendbanimet/struktura e tyre:

Komuna e Junikut ka tri vendbanime: qytezën e Junikut dhe dy fshatrat, Jasiq e Gjocaj. Zona urbane e Junikut ka sipërfaqe prej 520 Ha dhe ndodhet në terren me pjerrtësi të vogël e cila ndërpritet nga përrenj të vegjël (jaze) që e sjellin ujin nga lartësitë dhe e shpërndajnë në fushë. Si elemente identifikuese të zonës urbane janë lumenjtë “Erenik” dhe “Travë”. Nga ana jug-lindore ky element vjen dhe zgjerohet në formën e një hinke, formë të cilën e thekson edhe më shumë relievi kodrinor i përbërë nga kodrat periferike të Moronicës dhe Rogopecit.

Me të drejtë qyteza e Junikut konsiderohet “qytezë e mbështjellë nga natyra”. Rritja urbane është vërejtur të ndodh përreth disa bërthamave, që aktualisht janë edhe qendrat e lagjeve të sotme me origjinë fisnore. Qyteza e Junikut ka gjithsej 12 njësi urbane nga të cilat 10 njësi janë të banuara, ndërsa 2 prej tyre janë zona natyrore dhe bujqësore (informacione më të hollësishme për tipologjinë, strukturën dhe funksionet e këtyre njërive urbane ofrohen në PZHU). Kjo bën që Juniku të konsiderohet si vendbanim policentrik. Mund të përjashtohet vetëm njësi Gacafer, e cila ka një shtrirje lineare të orientuar kah lumi i “Erenikut”.

Fshatrat Jasiq dhe Gjocaj, të shtrira në sipërfaqe prej 308 Ha, janë gati plotësisht të zbrazëta nga popullata, me vetëm 7 shtëpi të banueshme³. Vendosja e popullatës nga këto dy vendbanime është bërë kryesisht në lagjen “Agim Ramadani”. Arsytet pse banorët e këtyre dy fshatrave janë larguar plotësisht, duke lënë këto vendbanime me gjithsej disa shtëpi të shfrytëzuara, shpjegohen me zhvendosjen nga lufta e fundit; mungesën e infrastrukturës fizike dhe sociale në këto vendbanime; kërkimin e kushteve më të mira të jetesës në qytet; dhe fushat e minuara. Kjo bën që pjesa e madhe e popullatës së Komunës së Junikut (rreth 79 %) jetojnë në zonën urbane të Junikut.

b. Banimi dhe ndërtimet

Komuna e Junikut, sipas të dhënave të Entit Statistikor⁴, ka gjithsej 1.427 objekte ndërtimi në Zonën Urbane dhe 38 objekte në fshatrat Jasiq dhe Gjocaj. Të dhënat më të hollësishme në lidhje me banimin në Zonën Urbane ofrohen nga PZHU, sipas të cilit zona e banimit në zonën urbane zë sipërfaqe prej 121,99 Ha apo 23 % të sipërfaqes urbane. Përderisa, në vendbanimet Jasiq dhe Gjocaj, sipas të dhënave të regjistrimit 1981, banimi zë sipërfaqe prej rreth 36 Ha.

³ Sipas të dhënave nga ESK (2009).

⁴ ESK (2009), Rifreskimi i të dhënave në terren, tetor, 2008 - prill, 2009.

Lloji dhe tipologjia e objekteve të banimit: Objektet e banimit që dominojnë në Junik, janë ato të tipit individual dhe të rrethuara me oborr përkatës, i cili ka hapësirën e mjaftueshme për të organizuar brenda tij edhe funksione tjera përveç atij të banimit, si p.sh. bujqësisë dhe blegtorisë, parkimit, depozitimit të produkteve etj.

Në kuadër të objekteve të banimit, Komuna e Junikut ka edhe numër të konsiderueshëm të objekteve që prezantojnë vlera të trashëgimisë kulturore (sidomos kullat dhe shtëpitë e gurit). Gjendja aktuale e tyre nuk është e mirë, për shkak të intervenimeve që janë bërë në to me qëllim të përmirësimit të kushteve të banimit, por edhe nga shkatërrimet gjatë luftës me ç'rast është humbur krejtësisht edhe një pjesë e tyre. Prandaj, ruajtja dhe mbajtja e tyre në funksion të banimit, paraqet një aspekt sfidues.

Ndërtimet pa leje: Sikurse në gjithë Kosovën, edhe në Junik, fenomeni i ndërtimeve pa leje është prezent sidomos në zonën urbane. PZHU (paragrafi 5.2.11) sugjeron zhvillimin e një vlerësimi mbi ndërtimet pa leje, krijimin e bazës së të dhënave me informatat për secilën ngastër në lidhje me statusin formal të ndërtimit apo posedimit të lejes dhe tutje përcaktimin e kriterëve për legalizim apo mos-legalizim. PZHU po ashtu propozon hartimin urgjent të PRRU me prioritet në zonat ku ka rritje dhe ndërtim të pakontrolluar.

Depopullimi: Një problematikë në vete paraqet boshatisja e shtëpive në dy fshatrat Jasiq dhe Gjocaj dhe zhvendosja e popullsisë në zonën urbane (lagjen "Agim Ramadani"). Aktualisht, në këto dy fshatra jetojnë vetëm 7 familje. Kthimi i popullsisë në këto dy vendbanime është i lidhur ngushtë edhe me investimet në infrastrukturën fizike dhe sociale, si dhe eliminimin e rrezikut të minave, i cili është ende prezent në këtë zonë.

1. 9 Infrastruktura rrugore

Korridorët dominuesë rrugore në Komunën e Junikut janë rrugët regjionale të cilat lidhin Junikun me qendrat më të afërta, si Deçani, Peja dhe Gjakova. Gjendja fizike e këtyre akseve është relativisht e mirë dhe përmes tyre përballohet ngarkesa e trafikut të shkallës së mesme.

Tabela 6. Rrjeti rrugor

Kategoria e rrugës	Nr.	Rrugët	M	Gjendja fizike
Rrugë regjionale:	3	1) Junik-Voksh-Deçan e cila lidhet me rrugën regjionale Pejë-Gjakovë. 2) Junik-Rastavicë lidhet me rrugën Pejë-Gjakovë. 3) Junik-Batushë- Ponoshec, lidh fshatrat malore me qytetet e Shqipërisë së Veriut dhe Gjakovës.	9558	1) Relativisht e mirë. 2) Relativisht e mirë. 3) Relativisht e mirë.
Rrugë kryesore komunale:	1	1) Rruga Junik-Dobrosh-Gjakovë që lidh qendrën me fshatrat e pjesës juglindore,	3596	Relativisht e mirë.
Rrugë lokale:	25	1) Rrugët që lidhin lagjet; 2) Rruga Gjocaj dhe Jasiq,	22000	Jo e mirë/të pa kategorizuara.
Rrugë e karakterit rural:		Rruga që shpie në Bjeshkë (Gjocaj, Jasiq & Lugu i Gjatë).		E pa kategorizuara.
Rrugët sezonale:		Rrugët që përdoren gjatë sezonit veror për qasjen në tokat bujqësore.		

Lidhjet e brendshme:

PZHU i ka trajtuar të gjitha rrugët përbrenda Zonës Urbane. Të gjitha kategoritë e rrugëve dhe shtigjeve kontribuojnë në sigurimin e lëvizjes së brendshme. Shumica e rrugëve që nuk sigurojnë edhe lidhjet e jashtme janë në gjendje të keqe dhe karakterizohen me:

- Zhavorr jo të mjaftueshëm apo të degraduar, gurë apo mbulojë asfalti;
- Paqëndrueshmëri (rrugë pa dalje ose të tërthorta);
- Dimensione të papërshtatshme (gradientë, diametra të lakuar, distanca prej objekteve);
- Mungesë e sigurisë, mbrojtje dhe komoditet për këmbësorë dhe çiklistë (rrjeti i kanalizimit, mirëmbajtja, hapësirat e rezervuara (trotuaret/shtigjet për çiklistë), menaxhimi i parkimit, ndriçimit, të mirëmbajtjes) dhe;
- Mungesë e shenjëzimit (hartave, tabelave orientuese) etj.

Lidhjet e jashtme (ndër-komunale):

Qasja në Junik arrihet nëpërmjet këtyre katër rrugëve kryesore:

- Lidhja me rrugën regjionale Pejë-Gjakovë, rrugë regjionale 5,5 km (deri në udhëkryqin e Rastavicës);
- Lidhja me Gjakovë/Shqipëri nëpër Ponoshec, 2.3 km në territor të Junikut (deri të Batusha);
- Lidhja me Gjakovë nëpër Dobrosh, rrugë komunale, 3.5 km në territor të Junikut dhe;
- Lidhja me Deçan nëpër Voksh, rrugë regjionale, 2 km në territor të Junikut).

Të gjitha lidhjet janë rinovuar rishtas (mbulojë e re asfalti në të gjitha lidhjet dhe disa rikonstrukcione të kryera në lidhjen e Deçanit) dhe janë në gjendje të mirë dhe shërbejnë për nevojat e transportit aktual.

Megjithatë, disa prej çështjeve që duhet të drejtohen janë:

- Lidhja me magjistralen Pejë-Gjakovë është e orientuar në drejtim të Deçanit. Një lidhje tjetër duke përdorur rrugën/shtegun komunal që lidh Hotelin “Oda e Junikut” me rrugën regjionale do të jetë i favorshëm për transport mallrash me shpate më të buta. Kjo, gjithashtu, do të sigurojë një lidhje të shkurtër për në Gjakovë.
- Lidhja me Deçanin përmes Vokshit që kalon afër fshatit Dranoc. Rruga që lidh është praktike për të gjitha automjetet e terrenit. Dranoci është një zonë e rëndësishme e trashëgimisë dhe ka nevojë të jetë i lidhur në funksion të zhvillimit të një qasje ndër-komunale të trashëgimisë dhe të turizmit natyror (lidhja do të shtrihet në territorin e Deçanit e cila është gjithashtu me rëndësi strategjike për Junikun).
- Lidhja direkte me Shqipërinë nëpërmjet rrugëve malore duke shfrytëzuar ish-bazën ushtarake e cila ekziston. Është praktike për të gjitha automjetet e terrenit përtej sektorëve të gjata. Ajo mund të zhvillohet si pjesë e programit të qasjes pyjore/malore dhe të bashkëpunimit ndër-kufitar.
- Ekzistojnë, gjithashtu, edhe rrugët sezonale, të cilat shfrytëzohen për bujqësi dhe meqë këto rrugë ndodhen në pronësi private kjo paraqet një problem në zhvillimin e sektorit të bujqësisë.

Transporti publik

a. Transporti me autobus:

Në Komunën e Junikut transporti publik i brendshëm nuk funksionon është e organizuar vetëm linja për transportin e nxënësve që përshtatet me oraret e mësimit. Por, këtë Komunë e përshkon linja e autobusëve ndër-komunalë dhe për arsye të mungesës së stacionit të autobusëve ata stacionohen në qendër. Përmes këtyre autobusëve, udhëtarët lëvizin në drejtime të ndryshme, si të fshatrave përreth, ashtu edhe në qytetet të tjera. Pra, ka linja të rregullta udhëtimi për Deçan, Gjakovë, Pejë e Prishtinë. Lidhje të drejtpërdrejta dhe të shpejta janë të orientuara drejt Deçanit, Pejës dhe Gjakovës.

Tabela 7. Lidhjet e transportit urban

Lidhja	Numri i nisjeve	Distanca km	Koha e udhëtimit (minuta)
Junik-Deçan-Pejë-Prishtinë.	13	110	20 / 35 / 120
Junik-Deçan-Pejë.	9	12,5 / 28,0	20 / 35
Junik-Batushë-Gjakovë.	9	2 / 25,5	20 / 40
Junik-Rastavicë-Gjakovë.	3	5.5 / 22,5	15 / 45
Junik-Gjakovë përmes Deçanit dhe lidhjes në linjën kryesore rrugore.	22	23	40

1. 9. Rrjeti elektrik

Furnizimi me energji elektrike në Komunën e Junikut është i dobët dhe natyrisht këtë e vështirëson edhe rrjeti i vjetruar energjetik. Shërbimi i furnizimit me rrymë kryhet nga Korporata Elektroenergjitike e Kosovës (KEK). Sipas një informacioni të marrë nga KEK-u, Divizioni i Rrjetit, Distrikti Pejë, dalja 10 kV e Junikut për momentin furnizohet nga linja TS 35/10 kV që vjen nga Lluka e Epërme në Deçan e cila furnizon 12 njësi të kësaj zone, përfshirë qytezën e Junikut, Gjoçajt dhe Jasiqin. Në aspektin energjetik kjo dalje 10 kV bën pjesë në daljet më të mbi ngarkuara dhe gjendja teknike e saj është e paqëndrueshme. Si rrjedhojë e kësaj, në realizim e sipër, është projekti për shkarkimin e kësaj daljeje.

Infrastruktura e rrjetit elektrik të nivelit të TU 0.4 kV është tërësisht në gjendje jo të mirë teknike, duke përfshirë edhe vetë qendrën e Junikut. E tëra është linjë ajrore me shtylla të drurit dhe shumë të vjetruara, sikurse edhe trafo-stacionet e mbingarkuara të cilat nuk i kënaqin kërkesat e konsumatorëve. Situata me furnizim do të përmirësohet me përmirësimin e rrjetit dhe trafove ekzistuese, si dhe ndërtimin e trafos së re ne lagjen Qok (projekt në realizim e sipër). Meqenëse, ky lokalitet është në rritje dhe në ndërtim e sipër është e nevojshme që këto rrjete elektrike ekzistuese të zëvendësohen me rrjete të reja kabllore nëntokësore.

Rrjeti i telekomunikimit dhe internetit: Rrjeti i radio-televizionit ekziston dhe funksionon, por jo dhe ai kabllorik. Rrjeti i telefonisë dhe internetit funksionon dhe operohet nga operatorët PTK-VALA dhe IPKO. Nga të dhënat e PTK-së dhe Ipko-së, aktualisht në Komunën e Junikut ka 420 kyçje në rrjetin e telefonisë dhe internetit. Duke marrë parasysh aspiratat për zhvillimin e turizmit, padyshim që teknologjia informative dhe krijimi i një shoqërie informative ka rëndësi të madhe,

ndaj investimet në zgjerimin e shtrirjes së rrjetit të telekomunikimit janë të nevojshme.

Gjendja e shërbimit të ndriçimit publik: Rrjeti i ndriçimit publik në Komunën e Junikut është i gjatë 3.4 km. Rrugë të asfaltuara në qytezën e Junikut janë mbi 15 km, bazuar në këtë ndriçimi publik përfshin 21.6 % të rrugëve të qytezës. Rrjeti i ndriçimit publik është i vendosur në 45 shtylla të rrjetit elektrik në zonën urbane të Junikut në disa lagje të saj dhe shtyllat janë prej metali dhe 33 shtylla të rrjetit elektrik që janë prej betoni. Përgjithësisht përdoren ndriçues me një kokë dhe janë vendosur nga një në çdo shtyllë, por ka edhe me nga dy koka në një shtyllë. Pra, i gjithë sistemi ndriçues në Komunë ka 78 koka ndriçuese. Juniku ka vetëm 45 shtylla të ndriçimit publik me rreth 46 koka ndriçuese që janë ndërtuar sipas standardeve bashkëkohore.

Rrjeti i qytetit është i vjetruar dhe i stërngarkuar dhe për këtë arsye shpeshherë paraqiten defekte të natyrave të ndryshme, si djegia e trafave dhe përçuesve të rrjetit të shpërndarjes.

Kokat ndriçuese që përdoren janë: 45 koka neoni (ekonomike) me fuqi prej 100 w, si dhe 33 koka neoni (ekonomike) me fuqi prej 80 w.

Tabela 8. Rrugët e ndriçuara

Rrugët e qytezës së Junikut me ndriçim								
Nr.	Lokacioni – (Vendbanimi)	Lagjja	Lloji i shtyllave			Gjatësia në km.	Nr. i kokave ndriçuese	Fuqia llamb.
			Met.	Bet.	Druri			
1.	Qendër-Ura e Erenikut.	Qendër.	17			0.7 km	17	100w
2.	Qendër-Tofaj.	Qendër.	5			0.2 km	6	100w
3.	Qendër-Shk.Fill.	Qendër.	7			0.3 km	7	100w
4.	Qendër-rruga për Dobrosh.	Berishë.	2			0.1 km	2	100w
5.	Qendër-rruga për Rastavicë.	Qendër.	14			0.9 km	14	100w
6.	Qendër-Tofaj.	Gacafer.		33		1.2 km	33	80w
7.	Lagjja- “A. Ramadani”.	“A. Ramadani”.		----		-----	-----	-----
	Total		45	33		3.4 km	79	

Rrugët e lagjes “Agim Ramadani” me ndriçim								
Nr.	Lokacioni - (Vendbanimi)	Lagjja	Lloji i shtyllave			Gjatësia në km.	Nr. i kokave ndriçuese	Fuqia llamb.
			Met.	Bet.	Druri			
1.	Lagje-ana e djathtë.	“Agim Ramadani”.		14		0.4 km	9	100w
2.	Lagje-ana e majtë.	“Agim Ramadani”.	3	30		1.1 km	22	100w
3.	Fabrika e tekstilit.	“Agim Ramadani”.	8				8	100w
	Total		11	33		1.5 km	39	

Pjesa 3

II. VLERËSIMI I GJENDJES EKZISTUESE

2.1 GJENDJA FIZIKO - GJEOGRAFIKE

Lokacioni – Pozita Gjeografike

Pozita: Juniku ndodhet në pjesën perëndimore të Kosovës, pranë Alpeve Shqiptare. Ka territor me sipërfaqe prej 7.777 km² dhe shtrihet në gjerësi gjeografike prej 42° e 22' dhe gjatësi gjeografike prej 20°26'.

Ka pozitë të përshtatshme gjeografike sepse shtrihet deri në veri-perëndim të fushës së Dukagjinit, përballë grykës së lumit “Erenik”, i cili buron nga Liqejtë e “Gjeravicës” dhe dredhon nëpër luginat e Alpeve Shqiptare.

Territori i Komunës së Junikut shtrihet deri në veri-perëndim të fushës së Dukagjinit dhe kufizohet me Komunën e Deçanit, Komunën e Gjakovës, Republikën e Shqipërisë dhe Republikën e Malit të Zi.

Distanca Junik-Pejë është 25 km, Junik- Gjakovë është 20 km, që kalon nëpërmjet fshatit Batushë, ndërsa distanca nga Juniku deri në Rastavicë (magjistralla Pejë-Gjakovë) është 5,5 km.




Figura 1 dhe 2. Karakteristikat gjeografike, pozita e Junikut në Kosovë dhe rajon

Topografia: Komuna e Junikut ka pozitë të përshtatshme gjeografike para grykës piktoreske të lumit “Erenik”. Lartësia mbidetare e Junikut shkon nga 450 deri në 2656 metra. Vet qyteza e Junikut gjendet në lartësi mbidetare 593 m. Maja më e lartë është “Gjeravica”, me lartësi mbidetare 2656 m, e cila është gjithashtu edhe pika më e lartë në Kosovë e Alpeve Shqiptare. Gjithashtu, ekzistojnë edhe dy maja të larta në afërsi të “Gjeravices”, nga pjesa perëndimore “Maja e Gusanit” me lartësi mbidetare 2539m, ndërkaq nga pjesa veriperëndimore “Maja e Rupës” me lartësi mbidetare 2501m. Sipas kësaj që u cek më lartë, shihet se në territorin e Komunës së Junikut gjendet ansambli i majave të larta, ku dy prej tyre janë më të lartat në Kosovë, si “Gjeravica” dhe “Gusani”.

Veçoritë natyrore: Juniku ka lloje të ndryshme peizazhesh, nga ai hidrografik (lumenjtë “Erenik” dhe “Travë”), peizazhe fushore (fusha e Junikut) dhe peizazhe kodrinore apo malore (“Gjeravica”, “Maja e Gusanit”, “Maja e Rupës”, “Rrasa e Zogut”, “Jedova”, “Moronica” etj.). Në vitin 2008 Kuvendi i Komunës së Junikut ka shpallur “Moronicën” (zonë të veçantë të komunës së Junikut). Kjo zonë mendohet të jetë “parku i ardhshëm i qytezës, që do të jetë si urë lidhëse në mes të parkut etnografik dhe parkut nacional Bjeshkët e Nemuna”. Në tërësinë e tij, Juniku paraqitet si entitet që ka qenë, është dhe do të jetë i lidhur ngushtë me natyrën.



Foto 1. Llojlojshmëria natyrore



Foto 2. Uji i kristaltë i Erenikut

Kushtet klimatike: Juniku ka klimë kontinentale, por me disa tipare mesdhetare. Kjo klimë është e përshtatshme për kultivimin e kulturave të ndryshme bujqësore. Mesatarja mujore e temperaturës është 21° C në korrik dhe -11° C në janar. Sasia mesatare e të reshurave është afër 670 mm³, kurse në sezonin e vejetacionit (prej muajit të IV-IX) afër 330 mm³.

Lumenjtë dhe sipërfaqet ujore: Lumi “Erenik” është më i madhi dhe më i rëndësishmi i rajonit, i cili shërben gjithashtu si burim uji edhe për ujitjen e fushës së Junikut. “Ereniku” buron nga liqejtë e “Gjeravices”. Ujërat që rrjedhin përkatësisht vijnë nga kurorat e maleve, nga “Gropa e Erenikut” dhe nga “Alpet Shqiptare”, formojnë rrjedhat sipërfaqësore të ujërave. Nëse menaxhohet mirë dhe nuk ka keqpërdorime të ujit, ka sasi të mjaftueshme edhe për ujitje dhe për pije.



Harta 1. Hidrografia




Foto 3. Rrjedhja e lumit nga bjeshka

Shfrytëzimi i tokës: Nga sipërfaqja prej 7.777 Ha sa ka Komuna e Junikut, afërsisht 4.439 Ha (57.08 %) janë tokë bujqësore. Livadhet e kullotat zënë sipërfaqe prej rreth 2.000 Ha (45.05 %) nga sipërfaqja e përgjithshme e tokës bujqësore, si dhe pyjet që zënë mbi 3.029 Ha (38.95 %) që paraqesin potencial për zhvillim. Në zonën urbane të Junikut dominon tokë relativisht e thellë e përshtatshme për prodhime bujqësore, ndërsa në pjesët tjera jashtë zonës urbane dominon tokë e cekët e përshtatshme për kullosa dhe zhvillim të pylltarisë.

2.2 Gjendja mjedisore

Gjendja e mjedisit në Komunën e Junikut, sa i përket ndotjes, mund të thuhet në përgjithësi se është relativisht e mirë. Aktivitete ndotëse industriale nuk ka.



Harta 2. Mjedis dhe Degradimet

Ndotja e ajrit: Vjen kryesisht nga qarkullimi i automjeteve, pluhuri për shkak të rrugëve të paasfaltuara dhe oxhaqeve të shtëpive. Ndotja vjen edhe si rezultat i një gurëthyesi që operon në lokalitetin Shkoza dhe dy reparacioneve që ndodhen në lokacionet Arasha dhe të prita e katundit.

Ndotja e ujit: Vjen si pasojë e hedhjes së mbeturinave në lumin “Erenik”, si dhe përgjatë bregut të tij, por edhe të lumi “Trava”. Ujërat e kanalizimit nga ekonomitë familjare derdhen në ujëra sipërfaqësore ose nëntokësore pa trajtim adekuat. Nga faza e parë e kanalizimit e cila është e funksionalizuar kryesisht lagjet Tofaj e Hoxhaj nuk janë të kyçura në kanalizim. Në përgjithësi, këto shkarkime shkaktajnë ndotje të mjedisit në resurset ujore. Mirëpo, kjo ndodhë deri në funksionalizim të plotë të kanalizimit, i cili është në fazën përfundimtare, ku njëkohësisht është duke u ndërtuar impianti për trajtim të ujërave të zeza që konsiderohet se ndërtohet sipas normave dhe standardeve evropiane.

Ndotja e dheut: Vjen kryesisht si pasojë e derdhjes së ujërave të zeza të pa trajtuara, lumenj e rrëqe të shumta. Me përfundimin e sistemit të rrjetit të kanalizimit, që është në ndërtim e sipër, situata pritet të përmirësohet.

Zonat e rrezikuara nga degradimi i mjedisit, fatkeqësitë natyrore dhe fatkeqësitë e tjera: Sikurse edhe në gjithë Kosovën, edhe në Junik, vërehen dukuri negative, si dhe prezencë e fatkeqësive natyrore që përfundojnë me pasoja ekologjike, ekonomike dhe sociale.

Prerja e pyjeve: Në pyjet e Junikut dukuria e prerjes së drunjtëve është prezentë, sidomos e shprehur tek pyjet në sektorin publik (në lokacionet Stanishta e Goqit, Zharrë, Gradinë). Pasojat nga kjo, përveç humbjes së masës drusore, paraqiten edhe në çrregullimin e ekosistemit, prishjen e peizazhit, paraqitjen e erozionit në këto zona etj. Komuna nuk posedon të dhëna se sa janë humbjet e masës drusore nga prerja e pyjeve, meqë me pyjet aktualisht menaxhon Agjencia Pyjore e Kosovës. Një brengë tjetër, që ka të bëjë me shkatërrimin e pyjeve, është edhe prezencja e insekteve të rrezikshme të ashtuquajtura Ipso dhe epidemisë që ka prekur drurin e gështenjës (40 % e gështenjave janë të sulmuara nga i ashtuquajhuri kancer i gështenjës). Shpresohet se tani me kalimin e kompetencave në menaxhimin e pyjeve tek institucionet lokale situata në terren të menaxhohet më mirë dhe të pengohet degradimi i pyjeve.

Erozioni: Zonat erozive ku intensiteti është më i madh e të cilat duhet të kenë trajtim të veçantë janë ato zona ku ka prerje të jashtëligjshme të pyjeve (sipas informatave të Komunës prerja e jashtëligjshme nuk bëhet nga banorët e Komunës së Junikut, por nga banorët e komunave të tjera përreth që kufizohen me Junikun). Rreziku nga erozioni është prezent edhe në vendbanimet Jasiq dhe Gjocaj, ku ka rrëshqitje të dheut (informata këto nga banorët se nuk ka studime të bëra për këtë zonë), si dhe në sipërfaqet afër brigjeve të lumenjve. Zonat erozive ku intensiteti është më i madh si pasoje e reshjeve duhet të kenë trajtim të veçantë. Parandalimi i aktiviteteve erozive kërkon marrjen e masave konkrete si: ndalimi i prerjes së pyjeve, zëvendësimi i drunjtëve të prerë me mbjelljen e fidanëve të reja, ndalimi i shfrytëzimit të materialeve inerte që shkaktojnë erozion etj.

Vërshimet: Lumi “Erenik” është lumë shumë i shpejtë dhe i rrëmbyeshëm, dhe paraqet rrezik të vërshimit. Sasia e ujit në lumin “Erenik” rritet sidomos në muajt mars, prill, maj nga shkrirja e borës, kurse në muajt tetor dhe nëntor nga reshjet e shiut dhe kjo paraqet mundësinë e daljes së lumit nga shtrati. Vërshime me përmasa të mëdha kanë qenë në vitin 1979, si dhe ky i fundit i vitit 2010, i cili vërshim shkaktoi përmbytjen e një pjese të zonës urbane, konkretisht lagjes Berishë.

Faktor tjetër që shkakton vërshim janë edhe aktivitetet e nxitura nga njeriu, sidomos nxjerrja e rërës nga lumenjtë. Nxjerrja e rërës nga lumi “Erenik” bëhet në vendin e quajtur të “Prita e Katundit”.

Fatmirësisht, në Komunën e Junikut nuk ka shumë ndërtime afër shtratit të lumit, megjithatë kjo nuk nënkupton mos-marrjen e masave për parandalimin e vërshimit dhe mbrojtjen nga ai, në rast rreziku. Në të ardhmen, kujdes i veçantë duhet t’i kushtohet rregullimit të shtratit të lumenjve me qëllim parandalimi të daljes së tyre nga shtrati. Sipas historisë së treguar nga të vjetrit, “Ereniku” ka një periudhë kur vërshon dhe ajo ndodh diku rreth çdo 30 vjet.

Tërmetet: Nga pikëpamja sizmike, pjesa më e madhe e territorit të Kosovës konsiderohet si zonë me rrezik sizmik mesatar ($0.0g < PGA^5 < 0.24g$)⁶. Sipas të dhënave, probabiliteti i tërmeteve në Kosovë është një dridhje prej 5-8 shkallë të Rihterit që ndodh pas një periudhe të caktuar përafërsisht 50-80 vjet. Juniku bën pjesë në rajonin me aktivitet sizmik prej 6-7 shkallë të Merkalit, parametër ky që tregon se duhet marrë me seriozitet marrjen e masave mbrojtëse ndaj tërmeteve (në ndërtimet e reja). Tërmeti i fundit në Komunën e Junikut ishte ai i vitit 1985.


⁵ PGA-Nxitiimi Horizontal Maksimal i Truallit.

⁶ MEM, Departamenti i Minierave, Divizioni i Sizmologjisë.

Zjarret: Në Kosovë zjarret janë dukuri e shpeshtë. Në periudhën prej vitit 2000-2008 në Kosovë kanë ndodhur përafërsisht 15.077 zjarre, që kanë djegur përafërsisht 7 632 Ha në sipërfaqe malore dhe fushore. Shumica e tyre kanë pasur intensitet të madh. Zonat e përfshira nga zjarret në Kosovë, përfshirë edhe Junikun, janë paraqitur në ilustrimin 4, të dhëna këto nga Departamenti i Menaxhimit të Emergjencave i Ministrisë së Punëve të Brendshme (2007). Në Junik⁷, në dhjetëvjeçarën e fundit, ndodhja e zjarreve është shtuar, si në numër e po ashtu edhe në sipërfaqen e prekur, duke shkaktuar dëme në njerëz dhe të mira materiale. Numri më i madh i zjarreve është në pyje, fusha e ngastra bujqësore.

Shkaqet e zjarreve janë në radhë të parë me karakter: Antropogjeni (pakujdesia e njerëzve), djegia për kullota; vënia e zjarreve me qëllim e interesa personale, si dhe shkaqet natyrore (kushtet klimatike p.sh. temperaturat e larta etj). Duke marrë parasysh dhe faktin që viteve të fundit një numër i konsiderueshëm i banorëve të zonave afër pyjeve dalin në stane me bagëti, gjithashtu edhe një pjesë e popullatës dalin për rekreacion dhe pushime. Kjo shton edhe rrezikun për shëndetin publik të banorëve nga zjarri, si dhe dëme ekonomike e mjedisore. Muajt mars, prill, korrik dhe gusht, janë muajt që paraqesin rreziqe më të mëdha ndaj zjarrit.

Kutia 1: Statistikat e zjarreve në Komunën e Junikut gjatë viteve 2003-2007



Numri i përgjithshëm i zjarreve të raportuara gjatë periudhës 2003-2007 është 40.

Nga këto:

- Zjarre në objektet e banimit familjar - 5 raste;
- Zjarre në trafo-stacionet për shpërndarjen e rrymës elektrike dhe në ormanët e rrymës elektrike - 4 raste;
- Zjarre në automjete të udhëtarëve - 2 raste;
- Zjarre në deponitë e mbeturinave - 7 raste dhe;
- Zjarre në pyje, fusha, ngastra bujqësore, ushqim i thatë kafshëve - 22 raste.

Pasojat në viktimat njerëzore:

- Viktima nga zjarret janë shënuar - 2 raste dhe;
- Të plagosur nga zjarret janë shënuar - 3 raste.

Burimi: Projekt Plani për Mbrojtjen nga Zjarri për Komunën e Junikut, 2009

⁷ Komuna e Junikut (2009), Projekt: Plani i Mbrojtjes nga Zjarri.

Komuna e Junikut në kuadër të Drejtorisë për Shërbime Publike ka themeluar: Njësinë e Zjarrfikësve që operon me një (1) zyrtar për shpëtim dhe tre (3) zjarrfikës. Detyra kryesore e kësaj strukture është kontrolli i zbatimit të ligjit dhe rregulloreve për parandalimin dhe mbrojtjen nga zjarri.

Ndryshimet klimatike: Edhe pse nuk ka studime dhe analiza në këtë fushë, efektet e ndryshimeve klimatike janë të dukshme. Gjatë dy dekadave të fundit në gjithë globin janë vënë re ndryshime të motit me rritje të temperaturave, pakësimit të reshjeve dhe përmbytje nga uji apo edhe thatësira. Parashikimet globale⁸ shprehin se reshjet e shiut në verë do të pakësohen me 10 % (deri në 2020) dhe me 20 % (deri në 2050), ndërsa temperaturat pritet të ngritën prej 1.4 deri 5.8 °C deri në vitin 2100. Padyshim që as Kosova, dhe në këtë rast Komuna e Junikut, nuk i shpëton prekjes nga ky fenomen me ndikim direkt mbi gjithë sektorët e zhvillimit, e sidomos në bujqësi, turizëm dhe prodhim të energjisë dhe si rezultat edhe mbi jetën e banorëve.

Shfrytëzimi i veturave, prerja e drunjtëve për djegie më tepër se sa që mbillen janë dukuri gjatë të cilave shkaktohet tepriçë e karbon dyoksidit në ajër. Një prej arsyeve se pse shfrytëzohen më shumë drunjtë për nxehje është se nuk ekziston sistemi i ngrohjes qendrore në Junik. Problemi tjetër është furnizimi i dobët me energji elektrike në Junik dhe rrjeti i vjetër elektrik, që më tepër ka ndërprerje të rrymës dhe që rezulton në shfrytëzimin e dizel gjeneratorëve dhe drunjtëve për ngrohje.

Juniku ka potencial të papërdorur në krijimin e energjisë alternative dhe burimeve të tjera natyrore, të cilat mund të ndryshojnë për të mirë dhe minimizojnë efektet nga ndryshimet klimatike. Ministria e Energjisë dhe Minierave (MEM) ka hartuar një studim para-fizibiliteti mbi identifikimin e burimeve ujore për hidrocentrale të vogla në Kosovë (2006), ku tre prej këtyre hidrocentraleve gjenden në Komunën e Junikut⁹.

Nga ana tjetër, zvogëlimi i këtyre efekteve lidhet drejtpërdrejt edhe me ndërgjegjësimin dhe mënyrën e sjelljes së Qeverisë, sektorit privat dhe vetë qytetarëve ndaj shfrytëzimit të resurseve natyrore dhe ngritjen e efikasitetit të energjisë.

Zonat e minuara: Një problematikë e shprehur në Komunën e Junikut dhe me ndikim edhe në zhvendosjen e popullatës nga vendbanimet është prania ende e minave në vendbanimet Jasiq dhe Gjocaj. Përkundër faktit që këtu janë zhvilluar shumë aktivitete deminuese, kjo zonë mbetet ende e rrezikshme për kthim të sigurt të banorëve. Në hartë janë paraqitur zonat e minuara në Junik (të dhëna këto nga viti 2000, me vërejtjen se në hartë janë të paraqitur vetëm lokacionet e raportuara, si të minuara dhe theksuar që minat mund të ndodhen edhe në lokacione të pashënuara si të minuara).

Peizazhet, resurset natyrore dhe biodiversiteti

Pozita gjeografike, relievi, malet e larta, grykat, lumenjtë, peizazhet dhe kullosat së bashku me florën dhe faunën që zhvillohet në to, paraqesin një bazë të mirë të zhvillimit të trashëgimisë natyrore për t'i mundësuar kështu Komunës së Junikut të bëhet një vend atraktiv për t'u vizituar dhe zhvilluar në të ardhmen. Vet qyteza e Junikut konsiderohet si një "qytezë e mbështjellë nga natyra" për shkak se natyra depërton në pjesë të konsiderueshme të saj. Zonat që paraqiten, si hapësira me vlerë të rëndësishme natyrore dhe potencial zhvillimi të turizmit janë:

⁸ (Burimi: The Intergovernmental Panel on Climate Change, cituar ne www.bbc.co.uk, hapur me 26/01/10).

⁹ Shoqata shqiptare për energji të qëndrueshme dhe mjedis, studimi i para-fizibilitetit mbi identifikimin e burimeve ujore për hidrocentrale të vogla, MEM, maj, 2006, Kosovë.

a. Peizazhet: Peizazhet hidrografike (lumenjtë “Erenik”, “Travë” dhe Jazet), peizazhet fushore (fusha e Junikut) dhe ato kodrinore apo malore (“Gjeravica”, “Maja e Gusanit”, “Maja e Rupës”, “Rrasa e Zogut”, “Jedova”, “Moronica”) paraqesin vlera të rëndësishme natyrore dhe potencial për zhvillimin e turizmit.

Bjeshkët e Junikut: Janë pjesë përbërëse e “Alpeve Shqiptare” (duke iu referuar raportit të MMPH mbi gjendjen në natyrë, “Bjeshkët e Nemuna” janë propozuar për mbrojtje¹⁰ në nivel kombëtar).

Në vitin 2003, MMPH, respektivisht Instituti për Mbrojtjen e Natyrës dhe Mjedisit të Kosovës në Prishtinë punoi “Studimin mbi arsyeshmërinë e shpalljes së territorit të “Bjeshkëve të Nemuna” Park Nacional”, pasuar me përgatitjen edhe të projekt-ligjit për të. Pritet shumë shpejt që kjo zonë të shpallet Park Nacional. Sipërfaqja e propozuar për këtë park është afro 500 km², mirëpo deri në përfizimin ekzakt të territorit të tij, në këtë stad të PLVM-së ende nuk mund të japim saktë se sa sipërfaqe e “Bjeshkëve të Junikut” mund të përfshihen në të. Gjendja momentale në këtë zonë nuk është e lakmueshme, për shkak të prezencës së dukurive negative (prerja e pyjeve, ndërtimi i objekteve të banimit dhe atyre hoteliere etj.), të cilat po dëmtojnë peizazhin dhe biodiversitetin përreth, ndaj dhe shpallja e kësaj zone “Park Nacional”, do ti kontribuonte ndalimit të këtyre dukurive negative.

b. Biodiversiteti: Në zonën e Junikut ka lloje relikte të faunës dhe florës, përfshirë edhe lloje endemike barishtore autoktone me vlera të larta shkencore dhe farmaceutike. Për shkak të faunës së zhvilluar e sidomos të shumë llojeve të shpendëve prezent, “Alpet Shqiptare” në kuadër të cilave përfshihen edhe “Bjeshkët e Junikut”, janë evidentuar në listat ndërkombëtare si IBA (Important Bird Area)¹¹ dhe Librin e Kuq të Evropës.

Llojet e florës: Studimet në këtë zonë kanë evidentuar këto lloje të florës të cilat janë dhe/apo duhet të përfshihen në listat ndërkombëtare për t’u mbrojtur.

Vlen të theksohen:

- Llojet autoktone të drunjtëve pyjor:
- Pyjet e ahut dhe bredhit (që rriten në lartësinë mbidetare 1300-1500 m);
- Bredhi, Arneni i Bardhë që është endem dhe relik (rritet në Gjeravicë);
- Pinetum Mugo (kërleka) që luan rol me rëndësi në ruajtjen e tokës nga erozioni rritet në lartësinë mbidetare deri 2000 m;
- Në pyjet e dushkut në lartësinë 300-900 m dominojnë: qarri, shpardhi, bunguta, bungu, gështenja. Të pranishëm janë edhe Acer Intermedium (pafti i Hirkanisë), Acer Tataricum (Ulëza), Ostrya Carpinifolia (Mëlleza), si dhe lloje tjera, si: panja e malit, dardha e egër, qershia, lajthia, thana, murrizi njëthelbor, si dhe shumë bimë barishtore.
- Të propozuara për t’u përfshirë në Librin e Kuq të Kosovës, i cili do të hartohet janë: gështenja, kërleka, arneni, bungbuta, draba e korabit, gentiana lutea (Sanëza), zambaku shqiptar, cerasti dinarik, burgulli maqedonas etj.
- **Në mbrojtje rigoroze duhet të jenë:** arneni, kërleka, pafti i hirkanisë, bangëbuta, sanza, etj.
- **Në kontroll të shfrytëzimit:** Në përgjithësi e gjithë flora dhe vegjetacioni i “Alpeve Shqiptare” është në rrezik nga shkatërrimi dhe zhdukja, prandaj Komuna duhet të marrë masa në parandalimin e dukurive negative të shkaktuara nga faktori antropogjen. Ndalja e prerjes ilegale të pyjeve, parandalimi i djegieve aksidentale, janë disa masa. Komuna duhet që në suaza të kompetencave të saj të ketë një kontroll të shfrytëzimit të bimësisë dhe vegjetacionit.

10 Sipas Ligjit për Mbrojtjen e Natyrës, Zonë e Mbrojtur e natyrës është zona e shpallur me qëllim të mbrojtjes dhe përkujdesjes së biodiversitetit, peizazheve, karakteristikave natyrore dhe trashëgimisë kulturore dhe për ofrimin e menaxhimit efektiv përmes mjeteve juridike dhe mjeteve të tjera.

11 MMPH (2003), studim mbi arsyeshmërinë e shpalljes së territorit të “Bjeshkëve të Nemuna” - Park nacional.

Llojet endemike barishtore të Ballkanit me vlera shkencore dhe farmaceutike, që gjenden në Gjeravicë janë: *Draba Karabensis* (*Draba e Korabit*) - në rrezik të zhdukjes; *Cerastium Dinaricum* (*Cerasti Dinarik*) - në rrezik të zhdukjes së plotë; *Sempervivum Macedonicum* (*Burgulli Maqedonas*); *Lilium Albanicum* (*Zambaku Shqiptar*), *Rumex Balcanicus* (*Lëpjeta e Ballkanit*), *Gentiana Lutea* (*Sanza*) etj. *Burgulli Maqedonas* gjendet në listën e Kuqe Evropiane, UNESCO (1991) për shkak të rrezikut nga zhdukja.



Foto 4. Fruta mali nga bjeshkët e Junikut

Llojet e faunës: Karakteristikë për “Alpet Shqiptare” ku përfshihen edhe “Bjeshkët e Junikut” janë: Lloje të Ujë-tokësorëve, Zvarranikëve, Shpendëve, Gjitarët. I regjistruar në Librin e Kuq, është Gjeli i Egër i Madh (*Tetrao Urogallus*), që është i rralluar, meqë është shumë i ndjeshëm ndaj zhurmës dhe pranisë së njeriut dhe jeton në Gjeravicë. Pastaj, *Bonasa Nonasia* prezente në “Bjeshkët e Junikut”; Familja *Accipitridae* - shpend grabitqar me disa lloje të saj, por e veçuar me Shqiponjën e Malit (llojin *Aquila Chrysetos*), e cila ka trup të fuqishëm dhe fluturim elegant dhe një madhësi prej 76-89 cm, që jeton në malet e larta dhe shkëmbinjtë e thepisur në “Bjeshkët e Junikut”. Në territorin e “Alpeve Shqiptare”, jetojnë edhe gjitarët Ariu i Murrme të cilit i kanoset rreziku i ekzistencës (është i ndjeshëm në zhurmën e sharrave, praninë e njeriut, prerja e pyjeve etj). Rreziku i zhdukjes i kanoset edhe Rrëqebullit (*Lynx lynx L*) sepse ajo është e ndjeshme në zhurmë dhe praninë e njeriut. Në zvogëlim e sipër janë Kaprolli dhe Dhia e Egër, Macja e Egër etj.

Për fat të keq, menaxhimi i dobët i këtij resursi natyror shkakton probleme të mëdha në tërë habitatin e saj dhe rrezikon degradimin e mëtutjeshëm. Shpallja e Alpeve shqiptare Park Kombëtar do të krijojë kushte për ruajtjen dhe mbrojtjen e llojllojshmërisë së pasur të faunës së kësaj zone.



Foto 5. Dreri në bjeshkë të Junikut



Foto 6. Derri i egër në pyjet e Junikut

c. Zonat me potencial zhvillimi të turizmit natyror: Shpatijet e përshtatshme për zhvillimin e sporteve dimërore dhe rekreative (ngjitje në bjeshkë), Liqejtë e bukur të Gjeravicës, burime e rrjedha lumenjsh, gryka, pyje të larta dhe një faunë e shumëllojshme e bëjnë Junikun zonë atraktive me mundësi të zhvillimit të turizmit gjatë gjithë vitit. Sipas konceptit të punuar nga Ministria e Tregtisë dhe Industrisë, lokalitetet me potencial të rëndësishëm të zhvillimit të turizmit bazuar në trashëgiminë natyrore janë:

- Hapësira urbane me trashëgiminë kulturore (kullat, mullinjtë, vajavicat);
- Lokalitetin “Moronica” që paraqet potencial të mirë për pushim dhe rekreacion. Fauna e pasur e kësaj zone ofron mundësi për ndërtimin e një kopshti zoologjik;
- Lokaliteti “Lugu i Erenikut” që ofron mundësi të mira për ngritjen e një qendre për sport e rekreacion dhe në veçanti zhvillimin e sporteve ujore;
- Lokaliteti i “Gradinës” paraqet potencial për sport e rekreacion (sport ujqor, peshkim dhe gjueti);
- Lokaliteti “Jedova” - potencial për zhvillimin e turizmit alpin, turizmit rekreativo-kurativ, gjueti etj.;
- Lokaliteti “Gropa e Erenikut” dhe “Rrasa e Zogut” për shkak të pozitës gjeografike paraqet një lokalitet me vlera të larta turistike, si dhe mundësi për zhvillimin e bashkëpunimit ndërkufitar mes Kosovës, Shqipërisë dhe Malit të Zi. Gjithashtu, ka mundësi për zhvillimin e eko-turizmit. Sipas raportit të lartpërmendur dhe duke iu referuar studimeve ndërkombëtare të bëra në vitet ‘70, në rajonin turistik të Junikut “Rrasa e Zogut” paraqet një vend me mundësi për ngritjen e një qendre turistike;
- Lokaliteti “Burimi i Erenikut” dhe liqejtë e “Gjeravicës” ofrojnë mundësi për zhvillimin e eko-turizmit, turizmit alpin për shkak të “Majës së Gjeravicës”, si dhe aplikimin e gjuetisë dhe bashkëpunim ndërkufitar;
- Lokaliteti Gjocaj dhe Jasiq janë lokalitete të cilat ofrojnë mundësi për zhvillimin e turizmit rural dhe eko-turizmit, zhvillimin e gjuetisë dhe turizëm konferencial, dhe;
- Lokaliteti “Zharra” për shkak të karakteristikave gjeo-morfologjike, paraqet potencial për zhvillimin e turizmit rural dhe eko-turizmit, turizmit konferencial, si dhe mundësi për ngritjen e një qendre rekreative-rehabilituese.



Foto 7. Terrene të përshtatshme për skijim



Foto 8. Terrene alpinizmi

Ndotja urbane

Duke pas parasysh mjedisin dhe rëndësinë e tij vitale për shëndetin e njeriut është e domosdoshme qasja ndaj kësaj problematike me përmasa më të mëdha, sesa lokale. Lufta e fundit në Kosovë dhe mbetjet e saj paraqesin rrezik të vazhdueshëm për popullatën, qoftë me veprim indirekt në mjedis apo veprim të drejtpërdrejtë në njerëz, ngase kohë pas kohe shpërthejnë mjete shpërthyes, të cilat përpos që marrin jetë njerëzish, në mënyrë tjetër me lirim e gazrave dhe pluhurave të rrezikshme ndotim mjedisin dhe kështu ky mjedis bëhet shkak i shumë problemeve shëndetësore, i pasuar me vdekje.

Përveç kësaj edhe faktori njeri me ndryshimin e dinamikës së jetës është bërë shkaktar i shkatërrimeve mjedisore. Ndërrimet e klimës, prishja e ekosistemeve, tharja e bimëve dhe e drurëve, ngrohja globale, erozioni etj., janë shenja se duhet të brengosemi seriozisht për mjedisin ku jetojmë.

Ndotja urbane në Komunën e Junikut shkaktohet nga mungesa e infrastrukturës adekuate, përdorimi i madh i veturave të vjetruara, rrugët e paasfaltuara, hedhjes së mbeturinave bregut rrugëve dhe lumenjve, mungesës së ngrohjes qendrore, djegies së mbeturinave etj.

2. 3. Mbeturinat

Komuna e Junikut shërbimin e grumbullimit të mbeturinave e ofron përmes kompanisë “Higjiena” nga Deçani.

Kompania në fjalë ofron zbrazen e kontejnerëve familjar, atyre të institucioneve publike dhe bizneseve dy herë në muaj, si dhe bën pastrimin e 10.000m² të rrugëve të asfaltuara.

Komuna e Junikut ka marr vendim për themelimin e ndërmarrjes komunale për menaxhim të mbeturinave, por në mungesë të fondeve e edhe të harmonizimit të legjislacionit me qeverinë qendrore është në pritje të zbatimit të këtij vendimi.

Mbeturinat komunale dhe lloje të tjera të mbeturinave jo të rrezikshme:

Në Komunën e Junikut nuk ka lokacion të përcaktuar për deponi të mbeturinave e as në dokumente të planifikimit hapësinor për të ardhmen nuk parashihet të ketë. Rishtas në një projekt të përbashkët me USAID-in është hartuar një dokument për menaxhim të mbeturinave dhe po ashtu është realizuar projekti i përbashkët për furnizim me kontejnerë të ekonomive familjare që shtrihen në zonën urbane. Krahas kësaj është kontraktua marrëveshja me kompaninë higjiena për mbledhjen dhe largimin e mbeturinave dhe për këtë kohë të shkurtë sa ka filluar ky projekt veç shihen rezultatet në të mirë të mjedisit.

Deponitë komunale:

Komuna e Junikut nuk ka lokacion të përcaktuar për deponi për grumbullimin e mbeturinave. Grumbullimi bëhet nëpër kontejnerë familjarë institucionalë dhe biznesorë, për tu bartur me tutje përmes kompanisë deri në deponinë regjionale në Sferkë të Klinës. Vëllimi i kontejnerëve është 1.1 m³ dhe kontejnerët familjar 120 l.

Tabela 9. Nr. i kontejnerëve

	Nr. i kont.	Njësia matëse
Institucione	22	1. 1m ³
Biznese	23	1. 1m ³
Ekonomi familjare	40	1. 1m ³
Ekonomi familjare	803	120 l



Foto 9 dhe 10. Deponitë ilegale të mbeturinave. (Deponi të egra)

2. 4. Ajri

Ndotja e ajrit që shkaktohet nga përzierja me substanca që futen në rrugë natyrore apo antropogjenë (të shkaktuara nga njeriu), përbënë shkakun kryesorë të përkeqësimit të cilësisë së tij. Aktualisht, shkaktarët më të mëdhenj të ndotjes së ajrit në Komunën e Junikut janë: komunikacioni-transporti me mjete të vjetra motorike dhe kryesisht pa katalizatorë, gjeneratorët, pastaj deponitë e hapura të mbeturinave komunale, si dhe operatorët e ndryshëm që veprojnë në Komunën e Junikut.

Një ndër ndotësit kryesor të ndotjes së ajrit në Komunën e Junikut janë automjetet, djegia e mbeturinave, dhe oxhaqet e shtëpive.

2. 5. Toka

Bujqësia: Është veprimtari e rëndësishme në Komunën e Junikut. Juniku ka 4439 Ha tokë bujqësore e cila paraqet 57.08 % të sipërfaqes së përgjithshme. Ky është indeks relativisht i lartë, krahasuar me mesataren në Kosovë, që sillet prej 0.15-0.18 Ha tokë bujqësore për kokë banori (limiti kritik është 0.17 Ha) dhe atë në Evropë (0.52 Ha/1b). Toka bujqësore pasluftës kultivohet me një shkallë më të ulët për shkak të konkurrencës joreale në treg dhe mos aplikimit i të mbjellurave profitabile nga fermerët. Aktivitetet bujqësore në Junik zhvillohen qoftë në zonën urbane (për shkak të tipologjisë së banimit me oborre të mëdha), po ashtu edhe atë rurale. Ndërsa, kulturat më të zhvilluara bujqësore janë: gruri, misri, fasulja, thekra, pastaj perimet si: specat, domatet, lakrat dhe qepët. Në masë mesatare kultivohen kulturat e pemëtarisë si: molla, dardha, vishnja dhe dredhëza. Kohëve të fundit shihet tendenca e rritjes së mëtejshme të sipërfaqeve të pemishteve, me një favorizim të rritjes së kapacitetit të ujitjes. Duke iu falënderuar cilësisë së tokës dhe klimës, Juniku karakterizohet edhe me kulturat e bimëve me veti mjekuese si: lincuri, rrudhani dhe disa lloje të kërpudhave.

Perimekultura/Lavërtaria: Në Komunën e Junikut nuk është ende aq e zhvilluar perime-kultura dhe lavërtaria. Kultivohen një numër i vogël bimëve lavërtare. Në sipërfaqe të vogla bimë foragjere dhe pemë. Mbi 45 Ha janë të mbjella në sektorin privat. Interesimi i ulët i fermerëve për kultivim ndodh edhe për arsyt e kostos së lartë të shpenzimeve. Ajo që vihet re është zhvillimi i pakët i kulturave intensive dhe industriale, e sidomos kultivimi në ambiente të mbyllura-serra.

Tabela 10. Sipërfaqet e mbjelluara

Sipërfaqet e mbjellura	Ha	%
Drithëra	1036	58.7
Perime	140	7.9
Foragjere	550	31.1
Pemë	40	2.3

Burimi: Strategjia Zhvillimore Lokale, Junik (2009)

Qasja në tokat bujqësore: Problematikë në vete paraqet qasja në tokat bujqësore. Kjo për arsye se në mungesë të rrugëve, pronarëve, iu duhet të kalojnë nëpër pronat e tjetërkujt për të pasur qasje në tokën e vet. Ky problem është sidomos gjatë sezonit të të korrave. Po ashtu pamundësia për plasimin e produkteve në tregun kosovarë dhe atë rajonal paraqet një dobësi për sektorin e bujqësisë.

Sistemi i ujitjes së tokave bujqësore: Nën sistemin e ujitjes janë 1960 Ha tokë punuese. Komuna në këtë aspekt është duke u ndihmuar nga Ministria e Bujqësisë me ndërtimin e pendës në lagjen Gacafer. Me këtë projekt priten të futen në sistemin e ujitjes, pjesë e madhe e tokave bujqësore. Realizimi i këtij projekti padyshim që do ta përmirësojë pak situatën, por jo në tërësi. Ka nevojë për ngritjen e kanaleve që do ta dërgonin ujin në çdo pjesë të tokave bujqësore. Kështu, fermerëve do t’iu lehtësohet puna për zënien e ujit nga lumi “Erenik” dhe futjen e ujit në sistemin e ujitjes. Ka vite që ujitja e tokave bujqësore bëhet nga ky lum, meqë sasia e ujit është e mjaftueshme për ujitje. Nevojitet që kanalet kryesore dhe ato ndihmëse të rregullohen dhe mirëmbahen.

Blegtoria: Përkundër faktit që ajo pësoi dëme shumë të mëdha gjatë luftës (dëmet rezultuan me humbjen e rreth 90 % të gjedheve, 85 % të deleve, 100 % të pulave dhe rreth 50 % të dhive), blegtoria paraqet një drejtim tjetër strategjik të zhvillimit ekonomik të Komunës së Junikut. Sipërfaqja e madhe me livadhe e kullota brenda territorit të Komunës, si dhe nga tradita e zhvillimit të kësaj lëmie janë faktorë favorizues për zhvillimin e blegtorisë (sidomos në kultivimin e gjedheve dhe dheneve). Sipas të dhënave nga Strategjia Zhvillimore Lokale (2009), në Junik ekzistojnë 200 ferma të vogla dhe dy ferma të mëdha të specializuara.



Foto 11. Zhvillimi i blegtorisë në bjeshkët e Junikut


Organizimi: Në këtë drejtim është me rëndësi të shikohen edhe çështjet nga aspekti institucional dhe organizativ. Stimulimi i bujqve dhe fermerëve nga ana e Ministrisë (MBPZHR) për rritjen e shfrytëzueshmërisë së tokës bujqësore, respektivisht ngritjen e fermave duke respektuar standardet e BE, është i ulët.

Kjo për arsye se Ministria përcjell standardet e BE-së dhe këto standarde kërkojnë bashkëpunim më të madh të bujqve rreth komasacionit të tokave bujqësore (kjo bëhet edhe me qëllimin e mbrojtjes së tokës bujqësore nga fragmentimi). MBPZHR me politikat e saj stimulon fermerët e kategorisë së mesme dhe të lartë, gjë që nënkupton që fermerët e vegjël duhet të bashkojnë fermat e tyre, duke u organizuar në formë kooperativash. Sipas parametrave të MBPZHR, Juniku nuk ka nevojë për më shumë se dy (2) ferma. Sipas informatave nga Komuna e Junikut, mendohet se ekzistojnë rreth 800 dele të shpërndarë në pesë (5) fermerë dhe diku 1100 lopë në rreth 90 fermerë të kësaj Komune. Janë gjithsejtë pesë (5) fermerë që kanë mbi dhjetë (10) krerë lope qumështore të cilët kanë përfituar nga stimulimi i MBPZHR.

E rëndësishme të ceket është edhe mungesa e organizimit: në Junik ende nuk ka shoqatë të bujqve dhe fermerëve dhe fusha e bujqësisë mbulohet me vetëm një punëtorë profesionalë në kuadër të Komunës. Shqetësim paraqet edhe fakti që bujqësia nuk shihet si profesion përfitues nga të rinjtë.

Tokat erozive

Gjatë periudhave kur të reshurat janë të shpeshta dhe pas shkrirjes së borës, sasia e ujit rritet duke krijuar përmytje (vërshime). Zonat e rrezikuara nga vërshimet janë zonat pranë rrjedhave të lumenjve. Mirëpo, në krijimin e tokave erozive ndikon edhe faktori njeri me veprimet e tij në mjedis, konkretisht me prerjen e pyjeve, dëmtimin e brezit mbrojtës pranë lumenjve etj. Në hartën e mëposhtme janë paraqitur tokat erozive në Komunën e Junikut, ku shihet qartë se ka pjesë me erozion të lartë.



Harta 3. Erozioni në Komunën e Junikut

Masat e domosdoshme për parandalimin e erozionit janë:

Masat Bujqësore dhe ato biologjike; parandalimi i prerjes dhe degradimit të pyjeve, parandalimi i kullotjes së tepërt, ndertimi i pendëve mbrojtëse dhe ndalimi i dëmtimit të brezit mbrojtës pranë lumenjve.

2. 6. Pyjet

Potenciali pyjor në nivel të Kosovës është 41.8 % me rreth 455 000 Ha¹³. Pyjet (respektivisht kulturat pyjore ku përfshihen edhe masat drunore në tokat bujqësore), në Komunën e Junikut zënë sipërfaqe prej 3444 Ha¹⁴, që i bie rreth 41 % të territorit të Komunës së Junikut¹⁵. Zona e pyjeve ose njësia Menaxhuese e pyjeve - Junik shtrihet në lmd 700-1900 m. Kjo zonë gjendet nën Gjeravicë, që është maja më e lartë në Kosovë.

Njësia menaxhuese në total është 3.444 ha pyje dhe toka pyjore të pronësisë shtetërore, që konsiderohen si pyje produktive, për më tepër pyje të larta, pyje të degraduara, cungishte dhe shkurre.

13 Sipas të dhënave nga Projekti - Plani Hapësinor i Kosovës, 2009.

14 Sipas Planit menaxhues Pyjor - Njësia menaxhuese Junik dhe Drejtoria koordinuese APK - Pejë, shkurt, 2012.

15 Të dhënat sipas Elaboratit Kadastral Komunal nga regjistrimi i vitit 1983. Situata në terren mund të jetë e ndryshueshme.



Foto 12. Pyjet në Junik

Të dhënat kryesore për sipërfaqen dhe vëllimin:

Tabela 11. Sipërfaqja dhe vëllimi - Sip. dhe vëllimi i masës drusore i matur në këmbë, kanë këtë shtrirje për Nj. M. “Pyjet e Junikut”

Grupi për klasa menaxhimi	Sipërfaqja	Vëllimi
	Ha	M ³
Pyll i lartë shumëmoshar	2,423	607,393
Pyll i degraduar	333	62,347
Pyll i lartë njëmoshar	97	21,093
Pyll cungishte	360	51,633
Shkurre	0	0
Sipërfaqe joproduktive	231	0
Total	3,444	742,466

Sa i përket sipërfaqes të dhënat më lartë, të gjitha sipërfaqet e njësisë menaxhuese, për vëllimin e masës drusore në këmbë janë vetëm ato sip. që janë përfshirë në matje. Kur këtij vëllimi i shtohet edhe vëllimi në këmbë, i vlerësuar për sipërfaqe pyjore, të cilat nuk janë përfshirë në matje prej 54,840 m³, atëherë del se vëllimi në këmbë për këtë njësi është 797,306 m³.

Rritja vjetore kap mesataren rreth 2.7 % nga vëllimi në këmbë i matur.

Llojet dhe kategoritë: Dominohet nga klasa e tokës, si: Tokë e kaft e cektë mbi supstrat gurë-grill (filiti, mikashist etj.), që mbulon 65 % të territorit. Gjithashtu, janë edhe tri klasa të tjera që konsiderohen kryesore: Ranker tipik mbi shkëmbinj bazik (gabro, dijabaz, bazalt) me 19 %, Rendzinë tipike mbi supstrat gëlqeror të fortë me 10 %, Litosol mbi formacione shkëmbinjsh bazikë me 6 % dhe Diluviumi tëltyrorë me përqindje mjaft të ulët.

Tabela 12. Klasat e tokës në sipërfaqe dhe përqindje

Kodi i tokës	Klasa e tokës	Sipërfaqja ha	Përqindja %
7	Litosol mbi formacione shkëmbijshë bazik	206	6
23	Diluviumi i tëltyrorë	1	0
44	Rendzinë tipike mbi supstrat gëlqeror të fortë	343	10
57	Ranker tipik mbi shkëmbijë bazikë (gabro, dijabaz, bazalt)	651	19
120	Tokë e kafentj e cektë mbi supstrat gurë-grill (filiti, mikashist, etj.)	2.243	65
Sipërfaqja totale:		3.444	100

Nj. M. mbulon sipërfaqe duke u nis nga ato me prodhimtari të lartë, ato më të ulët, e deri të sipërfaqet e zhveshura joprodhuese shkëmbore, deri nën kufirin e pyjeve. Megjithatë, ka kushte për prodhim të kualitetit të lartë, posaçërisht të fletorëve të cilët janë në gjendje të mirë edhe pse trashësia e korës së tokës është pjesërisht e cekët.

Llojet e drurit: Përhapja e llojit të drurit dominon me llojin e ahut, hermoqit, ndërsa pjesa e poshtme e saj mbulohet me dushqe dhe fletorë të tjerë, gjë që është normale për pyjet e lartësisë së tillë, të përbërjes së tillë të tokës dhe kushteve klimatike.

Kushtet për prodhimin e kualitetit të lartë të ahut bredhit dhe hermoqit janë të mira në këto pjesë territoriale.

Prerja ilegale: Kjo njësi gjatë viteve të fundit i është nënshtruar një degradimi mjaft të madh, i cili manifestohet me prerje jologjore të shumta dhe duket se ky aktivitet ka qenë më intensive viteve të fundit.

Sipas këtij inventarizimi, vëllimi i prerjeve të jashtëligjshme në këtë njësi për pesë (5) vjetet e fundit është 47.875 m³ që përfaqëson 6.4 % e vëllimit në këmbë. Pra, me këto prerje është nxjerrë masa drusore prej 44.7 % e shtimi vjetor gjatë periudhës së njëjtë. Kjo gjendje është për tu shqetësuar. Vëllimi i prerjeve është bërë nga cungjet e matura (në lartësi prej 0,30cm) në sipërfaqet provë. Për krahasim me njësitë tjera menaxhuese në këtë njësi me prerje të jashtëligjshme janë sulmuar 61,0 % e vëllimit nga llojet halorë dhe 39 % e llojit fletorë (për djegie).

Gjendja shëndetësore e pyjeve dhe biodiversiteti: Më se 33,3 ha, respektivisht 9,7 % e sipërfaqes së pyjeve konsiderohet si pyje të degraduara. Në krijimin e këtij realiteti janë arsyet biotike dhe abiotike, mirëpo arsyet kryesore janë prerjet dhe djegia e tyre.

Sipas po këtij inventarizimi vërtetohet se këto pyje janë të pasura me biodiversitet. Më pak se 1,6 % e druëve të matur janë drunjtë të thatë. Kjo përqindje është më e ulët krahasuar me sipërfaqet e tjera pyjore në Kosovë.

Sfida speciale për këtë pyll:

- Menaxhimi dhe kontrollimi i rreptë i prerjeve;
- Të rritet kualiteti i sipërfaqeve pyjore të klasifikuara, si pyje të degraduara;
- Përmirësimi i kushteve të pyllit dhe kualitetit në pyjet cungishtë. Kjo duhet të bëhet me rralime dhe selektimin e prerjes, si dhe pyllëzimi aty ku duhet me speciet përkatëse dhe;
- Përmirësimi i kualitetit të rrugëve pyjore.

2. 7. Uji

Ujërat që rrjedhin nga majat e “Bjeshkëve të Junikut” formojnë rrjedhat sipërfaqësore të ujit. Lumi “Erenik” është lumi më i madh dhe më i rëndësishëm në rajon dhe shërben si burim ujor për ujitjen e fushës së Junikut. Vlerësohet se nëse menaxhimi i ujërave është i mirë, atëherë zona e Junikut do të jetë e furnizuar mirë dhe do të ketë sasi të mjaftueshme të ujit për ujitje dhe pije.

Cilësia e ujit në zonat rurale është e mirë edhe pse ujërat e zeza dhe të mbeturinave mund të shkaktojnë ndotje të rënda në ujërat sipërfaqësore dhe nëntokësore nëse vije në kontakt të drejtë-përdrejtë me këta trupa. Ujërat sipërfaqësore dhe nëntokësore nuk janë të mbrojtur nga ndotja dhe në disa raste nuk i përmbushin standardet e duhura për pije ose përdorime të tjera. Ujërat e kanalizimit nga ekonomitë familjare derdhen në ujëra sipërfaqësore ose nëntokësore, pa trajtim paraprak. Në përgjithësi, këto shkarkime shkaktojnë ndotje në resurset ujore të Kosovës. Ndotësitë më seriozë përfshijnë ndotësitë organike dhe inorganike, komponentet e azotit dhe të fosforit, metalet e rënda, bakteret dhe viruset patogjene.

Përveç kësaj, mungesa e trajtimit të ujërave të zeza për segmentin e parë të kanalizimit të ndër-

tuar në lagjet Gacafer, berishë dhe të tjera dhe sistemi i papërfunduar funksional i kanalizimit ndikon në krijimin e situatës së dobët të mjedisit, mirëpo kjo gjendje pritet të përmirësohet me funksionalizimin e rrjetit të kanalizimit dhe impiantit për trajtim të ujërave të zeza për fazën e dytë të kanalizimit në Junik. Aktualisht lumi “Erenik” është duke u përdorur si pranues i këtyre mbeturinave dhe kështu ndikon në ndotjen e ekosistemit. Rrjeti i kanalizimit është në ndërtim e sipër dhe do të mbuloj tërë zonën urbane, që mundëson filtrimin e ujërave të zeza sipas standardeve evropiane dhe se me trajtimin e ujërave të zeza mund të përdoren për ujitjen e tokave.



Foto 13. a. Liqeni i Gjeravicës

b. Ujëvara në bjeshkë

c. Gurra e Hasan Agës - Bjeshkë

Burimet dhe furnizimi me ujë të pijshëm

Në Komunën e Junikut me ujin e pijshëm menaxhon KUR “Hidrodrini” SH.A. Pejë, përmes Njësisë Operative në Junik.

Furnizimi me ujë në Komunën e Junikut bëhet përmes tri burimeve, “Burimi i Livadhit të Madh”, “Gurrat e Goçit”, si dhe “Burimi i Lipovicës”. Ka një rezervuar me kapacitet 600m³, ku ka të vendosur klorinatorin që bën klorinimin e ujit në mënyrë automatike. Fshatrat Gjocaj e Jasiq nuk kanë ndonjë furnizim me ujë përmes ndonjë sistemi, por furnizimi atje bëhet përmes burimeve të natyrës me ramje të lirë.

Gjithashtu furnizimi me ujë të pijshëm bëhet edhe për dy lagjet: “Agim Ramadani” në Junik dhe “Dëshmorët e Kombit” në Baballoq, furnizimi me ujë të pijshëm i këtyre dy lagjeve bëhet përmes burimit të Shkozës, që ka një kapacitet (20-64) l/sec.

Sipas informatave të marra nga kompania KUR Hidrodrini, konsiderohet se uji që përdoret për pije është i cilësisë së lartë. Furnizimi me ujë të pijes është i pandërprerë, që konsiderohet si shërbim mjaftë cilësorë. Kur flasim për cilësinë e ujit, i referohemi analizave të Institutit Kombëtar të Shëndetësisë Publike të Kosovës - Dega në Pejë, që monitoron me ujin e pijshëm në Komunën tonë.

Janë gjithsejtë 1098 konsumatorë që furnizohen me ujë të pijes nga këto burime.

Gjendja mjedisore e burimeve ujore të Junikut

Aktualisht gjendja mjedisore e burimeve shikuar në përgjithësi nuk konsiderohet shumë e keqe, mirëpo në rast se nuk bëhet një studim i mirëfilltë mbi këto pasuri dhe hartimi i ndonjë projekti për planifikim, shfrytëzim dhe rregullim të mirëfilltë të tyre, atëherë sipas zhvillimeve në 10 vjetorin e fundit mund të degradohet në tërësi gjendja e këtyre vlerave natyrore. Është e domosdoshme të ndërmerren masat për ruajtje sa është natyra e pa prekur (në disa pjesë të burimeve) në të kundërtën kanoset rreziku edhe i invazionit të komunave fqinje mbi burimet ujore të natyrës.

Burime natyrore:

Juniku mund të mburret me pasurit dhe burimet ujore që ka, si për nga cilësia, ashtu edhe për nga sasia, meqë pati fatin të jetë qyteza në zemër të natyrës.

Burimet më të rëndësishme janë:

- Burimi i “Erenikut” nga liqenjët e “Gjeravicës”;

- Burimi i lumit “Trava” në malet e Junikut;
- Burimi i livadhut të madh;
- Burimi i “Lipovicës” dhe;
- Burimi i “Vrelës” së Goqit.

Përveç këtyre burimeve të cekura, Komuna e Junikut edhe brenda territorit urban përshkohet nga një mori e përroskave, vijave ujore dhe jazeve të cilat ia ngritin vlerat mjedisore kësaj Komune.

Po ashtu në malet dhe bjeshkët e Junikut ka burime nga më të ndryshme të ujit, qoftë si vija ujore apo edhe gurra dhe burime ku del uji edhe nga shkëmbi.

Lumenjtë

Lumenjtë e Junikut janë “Ereniku” dhe “Trava”. “Ereniku” është më i madhi dhe më i rëndësishmi i rajonit, i cili buron nga bjeshkët e Junikut, rrzëzë majës “Gjeravica” (nga Liqejtë e Gjeravicës).

Menaxhimi i ujit

Menaxhimi i sistemit të ujësjes në Komunën e Junikut bëhet nga Kompania Rajonale e Ujësjes “Hidrodrini”, e cila është e licencuar për këtë qëllim.

Trajtimi i ujit të pijes bëhet me sistemin e dezinfektimit, në formën që në burimet e ujit ekzistojnë stacionet e klorimit ku klorohet uji konform standardeve të përcaktuara me dispozitat ligjore. Sistemi i furnizimit me ujë bëhet me rrjedhje me gravitacion, pasi që morfologjia e terrenit e mundëson një rrjedhje të tillë.

Duke pasur parasysh rëndësinë e infrastrukturës së ujësjes, ujërave të zeza dhe ujërave të shiut, për kualitetin e jetës, mirëqenien e popullatës dhe për zhvillimin ekonomik dhe social të Komunës, padyshim që Komuna ka një rol të rëndësishëm në zhvillimin e kësaj infrastrukture. Kjo para së gjithash nënkupton interesin dhe përgjegjësinë e Komunës për ofrimin e shërbimeve cilësore për pjesën e përfshirë të popullatës me këto shërbime dhe po ashtu edhe për zgjerimin e infrastrukturës dhe krijimin e kushteve për përfshirjen e zonave aktualisht të pambuluara me shërbimet e ujësjes dhe ujërave të zeza. Rrjedhimisht, planet zhvillimore dhe urbanistike të Komunës duhet të harmonizohen me planet e investimeve kapitale për rehabilitimin dhe zgjerimin infrastrukturës në territorin e saj administrativ.

Në anën tjetër, infrastruktura e kanalizimit të ujërave të shiut është përgjegjësi e drejtpërdrejtë e Komunës, për të cilën nuk ekziston një kompani publike e as departament komunal i veçantë përgjegjës për menaxhim dhe mirëmbajtjen e saj. Si pasojë e saj mungojnë pasqyra e plotë dhe gjendjes ekzistuese dhe projektet e planifikuara. Gjithsesi për rregullimin e regjimit të ujërave duhet pas kujdes në faktorët që shkaktojnë regjimin dhe të merren masat adekuate tek të gjithë faktorët.

Mbrojtja e ujërave nga ndotja

Sistemi i kanalizimit për qytetin e Junikut është në përfundim e sipër. Segmenti i ashtuquajtur i fazës së parë është funksionalizuar, por pas vërshimit të vitit 2010 separatori që bënte trajtimin e ujërave të zeza është dëmtuar dhe aktualisht është jashtë funksionit, kështu që derdhjet bëhen në lumin “Erenik”. Faza e dytë e kanalizimit pritet që shpejtë të përfundojë dhe të funksionalizohet dhe nga kjo pjesë, gjithashtu është në përfundim e sipër edhe impianti për trajtim të ujërave të zeza me norma dhe standarde bashkëkohore. Uji që del nga ky impiant thuhet se do të del i trajtuar dhe derdhja e tij do të bëhet në lumin “Trava”, i cili ujë do t'i plotësojë normat dhe standardet për ujitje.

Aktualisht, Komuna duhet të mendojë edhe për sistemin e ujërave atmosferike, pasi që deri më sot nuk kanë ndonjë trajtim dhe dihet se edhe ato kanë ndikim në ndotje të ujërave.

Dhe sigurisht duhet të ndërmerren masa edhe për faktorë të tjerë që shkaktojnë ndotje: si hedhja e mbeturinave, eksploatimi i rërës, prerja e pyjeve e shumë faktorë të tjerë.

Problemet mjedisore

Komuna e Junikut për zonën urbane është në përfundim të kompletimit të rrjetit të kanalizimit. Problem mbetet trajtimi i ujërave atmosferike dhe trajtimi i ujërave të zeza për fazën e parë të kanalizimit ku separatori për trajtim të ujërave u dëmtua dhe konkretisht doli jashtë funksionit në vërshimin e fundit të lumit “Erenik” në vitin 2010.

Akoma problem mbetet derdhja e mbeturinave në brigjet e lumenjve, pastaj uzurpimi i pronës së lumit (rreth shtratit), krahasuar me hartat dhe informatat kadastrale të viteve të ndryshme. Shtrirja e infrastrukturës edhe për lokalitetet Gjocaj e Jasiq të cilët me planet tjera hapësinore mendohet të trajtohen si fshatra turistike.

Masat që duhet ndërmarrë:

- Kompletimi i infrastrukturës, funksionalizimi dhe menaxhimi i mirë i saj;
- Kompletimi i administratës komunale me strategji dhe rregullore dhe sigurimi i zbatueshmërisë së tyre;
- Fuqizimi i masave të inspektimit dhe mekanizmave të tjerë;
- Mbrojtja e fuqishme e burimeve natyrore;
- Mbrojtja dhe menaxhimi i mirëfilltë i pyjeve;
- Mbrojtja rigoroze dhe rregullimi i shtretërve të lumenjve, dhe;
- Hartimi i planit rregullues për parkun “Moronica” dhe lidhshmërisë natyrore të tij me lumin “Erenik”.

2. 8. Biodiversiteti natyror

Të dhënat flasin se vetëm në 100 vjetet e fundit zhdukja e specieve e shkaktuara nga njeriu është shuar rreth 1000 herë. Po ashtu, rreth 12 % e shpendëve, 23 % e gjitarëve, 25 % e haloreve dhe 32 % e ujë-tokësorëve kërcënohen për zhdukje, ndërkaq që rezervat peshkore të botës janë reduktuar deri në 90 % që nga fillimi i industrisë së peshkimit.

Vlerësimet e fundit shkencore parashikojnë se, me ritmet e sotme të shpyllëzimeve, brenda 25-30 vjetëve të ardhshëm do të zhduken deri në 10 % të llojeve të njohura në planet. Pasojat e kësaj humbje do të reflektohet edhe në ekonominë botërore dhe në zhvillimet shoqërore në përgjithësi, duke pasur parasysh faktin se afro 40 % e ekonomisë botërore dhe 80 % e nevojave të njeriut plotësohen nga resurset biologjike.

Në “Bjeshkët e Nemuna” gjenden lloje të gjitarëve dhe shpendëve që janë mjaft të rralla për rajonin e Ballkanit dhe më gjerë. Prej tyre ka relikte, endemike, të kërcënuara nga zhdukja dhe për këtë arsye gjenden në listat dhe në librat e kuq ndërkombëtarë.

Llojet më reprezentative të faunës së “Bjeshkëve të Nemuna”, janë: rrëqebulli (*Lynx lynx*), ariu i murrmë (*Ursus arctos*), kaprolli (*Capreolus capreolus*), dhia e egër



Foto 14. Biodiversiteti në bjeshkët e Junikut

(Rupicapra rupicapra), shqiponja perandorake (Aquila heliaca), shqiponja e maleve (Aquila chrysaetos), fajkoi thonjëbardhë (Falco naummani), pulëëgra (Tetrao urogallus) etj., kanë status kombëtarë dhe ndërkombëtarë të mbrojtur. Ato gjenden në listën e IUCN-së (Unioni Botëror për Ruajtjen e Natyrës), EU-RL (Lista e Kuqe Evropiane), ËR-RL (Lista e Kuqe Botërore), LKSH (Libri i Kuq i Shqipërisë), LKGJ (Ligji i Kosovës për Gjuetinë) etj.

Në tërë Kosovën është llogaritur të jenë 110 të tillë.

Nga kafshët shtëpiake rriten kryesisht lopët, delet, dhitë, kuajt, ndërsa nga shpezët pulat, thëllëzat e buta etj.

Sa i përket diversitetit bujqësor, ende nuk është kryer inventarizimi dhe mund të supozohet se intensifikimi i përdorimit të gjenotipeve produktive moderne për prodhimtari intensive, ka sjellë deri të rreziku i zhdukjes së shumicës së llojeve dhe varieteteve autoktone. Ruajtja e këtyre llojeve duhet të jetë një ndër aktivitetet më të rëndësishme të Strategjisë për Mbrojtjen e Biodiversitetit.

Në regjionin e “Alpeve Shqiptare”, ekzistojnë më se 797 lloje të bimëve të ndryshme, pastaj lloje të ndryshme të florës dhe faunës. “Bjeshka e Junikut” është e pasur me fruta mali, si boronica, mjedra, dredhëza, të cilat në të kaluarën ishin edhe burim i ekzistencës për banorët, pasi që bëhej grumbullimi dhe shitja e tyre. Po ashtu, ky rajon është i pasur edhe me një llojlojshmëri të bimëve mjekuese, si lincurri, rrudhani etj., madje është gjetur edhe bima aloe vera që ka një përdorim të gjerë në fushën e mjekësisë dhe estetikës.

Shpyllëzimet masive, shfrytëzimi intensiv i tokës, ndotjet e ajrit, ujit dhe gjuetia e pakontrolluar janë vetëm disa nga faktorët tjerë që vazhdojnë të rrezikojnë biodiversitetin. Nga të gjitha këto, humbja e sipërfaqeve pyjore që ka përfshirë me të madhe ekosistemin natyror është një nga problemet më emergjente për natyrën e Junikut, siç përshkruhet edhe më lartë në pjesën e pyjeve ku gjendja lirisht mund të thuhet se është alarmante.

Kafshët e rralla si rrëqebulli, ariu i murrme, kaprolli, dreri, dhia e egër etj., janë të rrezikuara dhe kanë filluar të pakësohen, si pasojë e dëmtimit dhe ndryshimeve në habitate të tyre, gjuetisë së pakontrolluar, varfërimit dhe degradimit të ekosistemeve, erozionit dhe shpyllëzimit. Për llojet shtazore është shqetësuese sidomos gjuetia e ushtruar gjatë periudhës së riprodhimit, ndërsa për llojet bimore grumbullimi i tyre gjatë fazës së lulëzimit.

Masat që duhet të ndërmerren

- Të hartohet një strategji për biodiversitetin;
- Miratimi i ligjeve përkatëse për këtë fushë dhe zbatimi i tyre;
- Organizimi i fushatave për vetëdijesimin e komunitetit mbi rëndësinë e biodiversitetit etj.;
- Oferta turistike për zhvillimin e turizmit në përgjithësi;
- Zhvillimi i turizmit të gjuetisë të koncentruar në ato vende, të cilat janë të pasura me lloje kafshësh;
- Inicimi i projekteve për furnizim me ushqim për lloje të ndryshme të habitatit;
- Hulumtime dhe inventarizim në nivel shtetëror për llojet e ndryshme të habitatit dhe vënia nën mbrojtje dhe siguri, dhe
- Hulumtimi, inventarizimi i lokaliteteve me rëndësi për biodiversitetin.

Peizazhet

Komuna e Junikut është e pasur me peizazhe natyrore të llojeve të ndryshme: peizazh kodrinor, peizazh bujqësor, peizazh rural, peizazh i livadheve, peizazh lumor etj. “Bjeshkët e Junikut” njihen për peizazhe të bukura dhe atraktive të cilat njëherësh shfrytëzohen për kullosa të bagëtive dhe vendverime të blegtorëve. Peizazhet më të njohura janë: “Rrasa e Zogut”, fshatrat “Jasiq” e “Gjocaj”, “Livadhi i Madh”, “Jedova”, “Qershiza”, “Gropa e Erenikut”, “Pllaqica” etj.

Po ashtu, “Bjeshkët e Junikut” janë të përshtatshme për zhvillimin e skitarisë, pasi që konfiguracioni i terrenit është shumë i përshtatshëm. Këto bjeshkë janë të përshtatshme edhe për zhvillimin e shumë sporteve të tjera, qoftë të ecjes apo vrapimit në natyrë, sporteve ujore, sporteve me motor apo biçikletë etj.




Foto 15. Peizazhe të ndryshme nga Juniku

Shpellat

“Bjeshkët e Junikut” janë lokalitet i njohur edhe për shpella të cilat nuk janë hulumtuar dhe inventarizuar. Mirëpo, junikasit janë dëshmitarë kur në vitet 1970-ta dhe 1980-ta këto bjeshkë vizitoheshin nga shumë turistë botërorë, pikërisht për shkak të këtyre pasurive dhe bukurive natyrore. Ndalimi i këtyre vizitave turistike është bërë në periudhën e paraluftës, kur filloi të bëhej shkapërderdhja e ish-Jugosllavisë. Tash duhet punë dhe promovim i madh për ta sanuar gjendjen e krijuar.

Bota shtazore dhe bimore

Shtazët dhe shpezët e egra: Ariu, ujku, derri, kaprolli, dhia, lepuri, dhelpra, çakalli, ketra, jazbaci, bukla, pula, qura, fëllënza, shqiponja, qyqja, qukapiku, bilbili etj. Në “Bjeshkët e Junikut” rriten edhe disa lloje të gjarpërinjve helmues si: gjarpri me zile, gjarpri me topa, pastaj jo helmues si: breva, bolla dhe specie të tjera të habitatit zvarranik. Mirëpo, shumë prej këtyre llojeve të kafshëve janë të rrezikuara nga gjuajtjet e paligjshme.

Bimët mjekuese: “Bjeshkët e Junikut”, të cilat janë pjesë e ansambllit të “Alpeve Shqiptare”, janë të pasura me lloje të ndryshme të bimëve mjekuese, e që në popullatë njihen me emra populor: Aloe Vera, Rrudhani, Angulijja, Thundër Mushka, Murrizi, Gjethe Dielli, Bar Pezmi, Krasta, Rigoni, Menta, Boronica, Gllijat, Hitha, Bar Blete, Ruta, Lincuri, Shushorka, Pelini, Mjedra, Dredhëza, Kamomili, Mollaga, Rrodhezja, Qakorrrja, Kamfuri, Breza, Kinfusha, Sherbeli, Kleka, Grami, Bar Pate, Lule Kaçe, Molla e Egër, Shtogu, Lena, Valerina, Bukë Arushe, Shotorri etj.

Trashëgimia natyrore: Zona kadastrale e Komunës së Junikut është e pasur me trashëgimi natyrore dhe fatmirësisht akoma nuk ka ndonjë zhvillim dhe ndërhyrje të madhe në të. Mirëpo, kjo nuk na jep të drejtë të presim dhe të presim zhvillimet që do ndodhin. Është momenti i fundit që të kanalizohen detyrat dhe përgjegjësitë dhe secili të jep përgjegjësi para detyrimeve të veta, sa nuk është bërë vonë. Veprimet që do bëhen në këto vepra natyre nuk mund të zhbëhen më. Kështu që është nevojë imediate hulumtimi, inventarizimi dhe vënia nën mbrojtje e trashëgimisë natyrore. Hulumtimi i lokalitetit arkeologjik “Gradina”, vënia nën mbrojtje e ansambllit të majave të “Bjeshkëve të Junikut”, vënia nën mbrojtje e peizazheve ujore, liqeneve, burimeve, gurrave etj. Është nevojë urgjente. Aktualisht Komuna e Junikut ka marr vendim për shpalljen e “Moronicës” zonë me interes të veçantë për qytezën.

Trashëgimia kulturore

Territori i Komunës së Junikut ka trashëgimi të pasur kulturore, materiale dhe shpirtërore. Juniku i takon zonës së “Rrafshit të Dukagjinit”, zonë kjo e njohur për kullat, si fortifikatë e banimit dhe jetesës. Juniku konsiderohet me bindje si një nga zonat më të pasura me objekte të trashëgimisë, duke pasur parasysh se aty gjenden objekte të tipit kullë, pjesë e kullave të Dukagjinit, me vlera historiko-kulturore të mëdha, mullinj dhe vajejica që është karakteristike e vendit, për të cilin po hartohet ky dokument.

Kullat, përveç interesit arkitektonik që mbartin, kanë luajtur dhe një rol shoqëror të rëndësishëm. Për shembull, “Oda e Junikut” ishte njëkohësisht institucion juridik, shoqëror e politik. Aty u mbajtën tubime të ndryshme me rëndësi, jo vetëm për Junikun, por edhe për tërë Kosovën.



Foto 18. Pamje nga pasuria e trashëguar - Kullat

Trashëgimia arkitektonike

Juniku, edhe pse Komunë relativisht e vogël me territor, karakterizohet me vlera të shumta të trashëgimisë kulturore dhe asaj shpirtërore. Llojet e trashëgimisë që mund të hasen në Junik janë: trashëgimia arkitekturale, arkeologjike, si dhe ajo shpirtërore. Trashëgimia kulturore e Junikut lidhet shumë me zhvillimin historik të tij. Në kaptinën e historikut u cek se Juniku paraqet një vendbanim të lashtë ilir. Dëshmi të kësaj janë materialet arkeologjike të zbuluara tek vendbanimi ilir i quajtur “Gradina”, vendbanim ky që ndodhet në grykën e majës së “Gjeravicës” gjurmët e të cilit ekzistojnë edhe sot.

Në periudhën e feudalizmit, Juniku paraqitet si një qendër e rëndësishme e pazarit. Në atë periudhë edhe ndërtohet “Xhamia e Qokut” dhe “Xhamia në Qendër të Junikut”, që edhe sot paraqesin objekte me vlera të rëndësishme kulturo-historike.

“Xhamia e Qokut” është ndër më të vjetrat në Kosovë, ajo është edhe më e vjetër se “Xhamia e Hadumit” në Gjakovë.

Trashëgimia me të cilën Juniku spikatet janë: kullat - banesa të fortifikuara familjare (tipike për rrafshin e Dukagjinit), pasuar me shtëpitë e gurit, objektet tradicionale për shërbime dhe mullinj.

Aktualisht dy mullinj me ujë janë në gjendje të mirë, ku njëri prej tyre është në funksion, ndërsa tjetri është i mbyllur, por ka edhe të tjerë që duhet restauruar.

Kullat

Kulla si banesë shqiptare në Rrafshin e Dukagjinit

Ndërtimtarinë popullore kosovare, përkatësisht shqiptare, e pasurojnë edhe objektet e arkitekturës fshatare të banimit të tipeve dhe varianteve të ndryshme që u ndërtuan gjatë periudhës së sundimit osman. Natyrisht që objektet nga periudhat e hershme, përkatësisht nga shekujt XV, XVI e XVII, nuk kanë mbetur. Mirëpo, duhet theksuar se, padyshim, ndërtimet e mëvonshme të realizuara nga mjeshtrë lokalë kanë përcjellë skemat kompozicionale të ndërtimeve të më parme. Ndërtimet e arkitekturës fshatare ishin nga ato më të thjeshtat, me një ambient, e deri te tipi i çardakut.

Ndërtime të realizuara deri në shek XIX-të. Në Rrafshin e Dukagjinit është i njohur edhe një tip i arkitekturës fshatare. Fjala është për ekzemplarët e kullave, si objekte të banimit ekzistenciale shqiptare. Kulla, si banesë ekzistenciale shqiptare në Rrafshin e Dukagjinit, paraqitet si një produkt dhe proces i një zhvillimi të gjatë historik, nga e cila lindi dhe u zhvillua në mënyrë evolutive ky ndërtim me tipare të veçanta kompozicionale, konstruktive, funksionale, teknike, trajtësore e që në vetvete përmban elemente të caktuara dhe specifike shqiptare. Disa nga këto kulla veçohen me vlerat e tyre artistike e estetike, si nga trajtimi i anës së jashtme, po ashtu edhe nga ai i anës së brendshme.

Kulla është banesë karakteristike e arkitekturës popullore, e cila me kohë u bë mbizotëruese në disa treva shqiptare në Rrafshin e Dukagjinit dhe në Drenicë, në veçanti. Në përdhese ishte ahuri për strehimin e kafshëve, në kat “shtëpia e zjarrit” dhe qilarët që shfrytëzohen nga anëtarët e familjes, kurse në atë më të lartin “oda e burrave” ose e mysafirëve. Kjo kullë, pos funksionit të banimit dhe të mbrojtjes në rast nevoje, kishte edhe dedikime të tjera. Oda e burrave luajti rolin e një institucioni më rëndësi të veçantë historik, shoqëror, politik, ekonomik, kulturor, juridik, arsimor etj.

Komplekset e kullave të vjetra fshatare: Komplekse të vjetra të kullave rurale me ekzemplarë të vlerave artistike të tyre, përkatësisht fshatra me kulla që i takonin muzeumeve nën qiellin e hapur, ekzistonin deri në vitin 1998 e 1999, pra para luftës shqiptaro-serbe. Komplekse të tilla kishim në Nivokaz, Batushë, Brovinë, Junik, Carrabreg, Drenoc, Prilep, Deçan, Strelc, Vranoc, Raushiq, Istog, Vrrellë e në shumë fshatra të tjera të Kosovës.

Juniku përbëhet prej shumë lagjeve prej të cilave më kryesoret, përkatësisht qendrore janë: Tregovishtë, Gacafer, Berishë. Në lagjet në fjalë u ndërtuan edhe kullat, si banesa të fortifikuara familjare, objekte ekzistenciale të tipit kullë.

Tregovishta me kullat e familjes së Hoxhajve paraqesin bërthamën e kompleksit të kullave të vjetra të Junikut. Njëkohësisht duhet theksuar se ky ansambël i kullave filloi të realizohet në dekadat e fundit të shek. XVIII-të dhe mbaroi në fund të shekullit XIX-të. Në këtë periudhë mbi njëshekullore u krijua ky vendbanim me këto ndërtime të karakterit të banimit të fortifikuar. Pra, me këtë kuptojmë se Juniku, si vendbanim rural, ishte i tipit të lagjeve, të vëllazërive. Karakteristikë dhe veçori përfaqësojë identike kishte edhe lagjja Gacafer dhe Berishë. Nga zgjerimi dhe ndërtimi i kullave u krijuan pjesë të komplekseve të reja, konkretisht lindën këto lagje: në lindje lagjja Çoku, Gaxherr e Miroc, në perëndim Çestë e Goçaj, në veri Bajraktar e Pepsh.

Kulla e Hoxhajve, pos vlerës konstruktive-arkitekturore, funksionale, artistike e estetike, pati edhe një rëndësi të posaçme. “Oda e Junikut” ishte institucion juridik, shoqëror e politik. Këtu u mbajtën tubime të ndryshme me rëndësi jo vetëm për Junikun, Rekën e Keqë, por edhe për tërë Kosovën. Në odë u morën shumë vendime më interes shoqëror, politik e juridik. Oda kishte 12 odabash nga të gjitha lagjet e Junikut. Me odabash kryesonte kryeplaku i odës. Kryeplaku është zgjedhur nga 12 odabashët. Pra, kjo ishte pos të tjerash edhe një nga karakteristikat që e bënë kullën në fjalë edhe më të vlefshme dhe më rëndësi për historinë dhe kulturën shqiptare.

Trashëgimia etno-kulturore:

Etnografia: Si u tha edhe më lartë, rajoni i dukagjinit është i pasur për nga trashëgimia natyrore dhe kulturore. Në kuadër të kulturës kulturore gjendet ajo etnografike e cila nuk rri larg nga segmentet tjera të kulturës.

Në Komunën e Junikut në vend të rëndësishëm zë veshja e Katundit (kombëtare) e cila përbëhej nga: Këmisha, çorapet, pështjellakët, jeleku, shalli, marhamja dhe lidhësja, ku edhe sot e kësaj dite rrallë herë ndodhë që ndonjë vajzë të martohet pa këtë veshje.

Përkundër grave të cilat e ruajnë me fanatizëm dhe akoma e punojnë dhe e veshin tek burrat stili i veshjes ka ndryshuar komplet. Dikur veshja e burrave përbëhej nga: tirqit, këmisha e pëlhurës,

shoka, jeleku, xhamadani, herka, japongja, plisi dhe opingat. Sot përdoret vetëm plisi të burrat më të moshuar. Veshja kombëtare e burrave-kryesisht ishte veshje tradicionale e “Rrafshit të Duk-agjinit”.

Ushqimet

Sigurisht se segment i rëndësishëm i kulturës së kësaj ane ishte edhe gatimi, me ç’rast shtëpitë në zë siç quheshin atëherë duhej ta dëshmonin veten edhe në mirëpritje dhe me sofër të pasur. Gjellët e ziera: fasulja e zier në vegsh apo tavë, fasulja e ndrydhur (me qumësht), mish e lakra, sarma, musaka, mish orizi, çervishi, çorba të ndryshme me patate dhe oriz, çorba e kuqe, lakra me lugë etj.

Gatimet prej brumi: flija, pitja e shtrime, pitja me rrathë, llokum të nuses, petullat e brumit, përpeqi, pastaj reseniku, lakrori, kungullori etj.

Gatimet me miell misri: buka kallamoqe, maza e zier, flija e kallamojt, leqeniku, kaçamaku, përshesh me tambël etj.



Foto 19. Llojlojshmëri e ushqimit tradicional në Junik

Vegla të amvisërisë: Saçi, çerepi, saxhaku, vegshi, qypi, kalanica, kënata, lograqa, tangari, tepsia, tigani (fulterja), tava, tinari, koritat, kaca, sheka, tundaçi, buria, ibriku, bucaku, pocërrka, dybeku, debja, magjja, sinia (sofra), stoli (shkomi), funi, tëhollusa, lugët, thikat, breca, gërrysa, sita, garuzhda, çanaku, vagani, sahani, vorba, kusia, kazani, korita, filgjanat, xhezvet, mulliri i kafes etj.

Veglat bujqësore: Qerrja e drunit, qerrja e hekurit, kryqzorja, trina, vllaqa, plugu, (përdoren pak), pastaj vijnë: shati, kosa, gashtra, kulla e çekiçi, t’furku, grabuja.

Veglat shtëpiake: Lopata, drapri, sēpata, kmesa, sqepari, kazma, qyskia, rashqeli (grabuja) teslica, hjekësi, lima, lata, brisku, bugjuku, shosha, trina, kulla, zdrukthi, dalta, çengeli, lmeza, pyka, këmbonët, zilet, sēpata, teslica, zdrugu, qekani, lima, gashtra, biza, dalta, zhigu, brisku, çengelja, tezgjaku, veku, kudhra, gërshërët, përgeli (kompasi), gozhdari, mëngelja, turjela, masha, kacia (lopata e prushit) etj.

Shumë prej këtyre veglave janë në zhdukje e sipër. Rrallë mund të gjenden edhe si raritete. Ka raste që mjeshtrit i punojnë me porosi vetëm si raritete për zbukurim.

Trashëgimia shpirtërore

Besëtytnitë: Syni i keq, apo m’syshi, sehiret, magjitë. Pastaj, shtriga, lugati, dhampiri, kuçedra, drangoi, zana, ora etj.

Ritet: Riti i lindjes, ninullat, fejesa, fjala e nuses, konagejeqi, nata e dasmës, dasma, dita e divanit ritet e vdekjes si e pamja etj.

Këngët popullore: Këngët Kreshnike (lahutarë), Këngët e vajit (vajtimet mortore) dhe Këngët folklorike-rapsodike.

Vallet popullore: Loja me def, loja me tupan dhe Vallja fësht ta-ta fështa (valle pa instrumente).

Lojërat popullore: Gurapeshi, Kërcimi pup, Kërcimi në hap, Rrokja (mundja), Guracaku, cic-mic te cilat janë në zhdukje e sipër. Sot thuaja se nuk i luan askush, madje as nuk janë eksploruar sa duhet.

Veglat muzikore: Lahuta, Çiftelia, Sharkia, Defi, Kavalli, Fyelli, Filikaqa, Mishnicat, Tupani dhe surla.

Veglat baritore: Pipi, gjethi, tatirangja, filikaqa.

2. 9. Zhvillimi ekonomik

Juniku ka pozitë të mirë gjeografike dhe ndërkufitare me resurse natyrore dhe kushte të favorshme që ofrojnë mundësi për zhvillim ekonomik dhe bashkëpunim me komunat dhe shtetet fqinje. Synimet janë që ky sektor të ketë një ngritje në zhvillim në të gjithë sektorët ekonomikë, por në veçanti në atë të turizmit, bujqësisë përfshi blegtorinë me theks të veçantë në bletari; zhvillimin e agro-biznesit dhe agro-industrisë, pasuar me pylltarinë dhe sektorin e energjisë alternative.

Zhvillimi ekonomik në të gjitha sferat e në veçanti në turizëm dhe veprimtaritë përcjellëse të kësaj fushe, bujqësi përfshirë blegtorinë, pylltari dhe energji alternative, si potenciale për zhvillim është parë si prioriteti më i lartë për Komunën e Junikut.

Turizmi

Juniku ka potencial të llojlojshëm për zhvillim të turizmit kulturor dhe atij natyror (rekreativ, kurativ, eko-turizmit, ndërkufitar, turizmit alpin, rural dhe atij konferencial). Koncepti i zhvillimit hapësinor vë në pah lokalitetet me potencial turistik si: “Moronica”, “Lugina e Erenikut”, “Gradina”, “Jedova”, “Gropa e Erenikut”, “Rrasat e Zogut”, “Burimi i Lumit Erenik” dhe liqejtë e “Gjeravicës”, “Maja e Gjeravicës”, “Zharra” etj. Zhvillimi i turizmit kulturor lidhet ngushtë me trashëgiminë arkitektonike (prezencën e kullave tradicionale) dhe atë shpirtërore (ruajtja e dokeve, zakoneve, riteve etj.). Zhvillimi i kësaj fushe, natyrisht, lidhet edhe me elemente të tjera që i japin drejtimin turizmit. Këto elemente janë: qasja dhe mundësia e ardhjes në këto lokalitete turistike, gjë që lidhet kryesisht edhe me informacionet që iu jepen turistëve për të vizituar këto treva, transportin; pastaj elementi përmbajtësor turistik që kryesisht lidhet me resursin turistik, por edhe aktivitetet që turistët mund të zhvillojnë aty, si dhe elementi i infrastrukturës përcjellëse turistike, si akomodimi, shërbimet hotelierike, ushqimi etj.

Tabela 13. Lokalitetet turistike, potenciali turistik dhe objektet e propozuara

Zona e Junikut			Zona - Gryka e Junikut						Zona - Gryka e Zharrës	
“Moronica”	Hapësira urbane	Lugina e “Erenikut”	“Gradina”	“Jedova”	“Gropa e Erenikut”	“Rrasat e Zogut”	Burimi i lumit “Erenik”	Liqejtë e “Gjeravicës”	Fshatrat “Gjocaj” dhe “Jasiq”	“Zharra”
Turizmi i lokalitetit.	Turizëm kulturor.	Turizëm rekreativ -sportet ujore.	Turizëm rekreativ -sportet ujore -gjuetia.	Turizëm rekreativ -kurativ -gjuetia alpinizmi.	Eko-turizmi; Turizëm malor; Turizëm ndërkufitar; -Ecja, shëtitja; -Kampimi; - Kalërimi dhe; - skijimi.		Eko-turizëm, turizëm alpin (Maja e Gjeravicë), turizmi ndërkufitar -Sportet malore (ngjitja në bjeshkë).		Turizmi eko, rural, Konferencial, kulturor dhe rekreativ	Eko turizmi & rural, konferencial & rekreativ dhe habitues;
-Kopsht Zoologjik; -Kopsht botanik; -Muze; -Kullat, mullinjtë dhe; -Qendër rekreative.			Qendër turistike.						Qendër rekreative-rehabilituese dhe; Qendër konferenciale.	

Bujqësia dhe agro-industria:

Kultivimi i drithërave: Bujqësia paraqet një veprimtari të rëndësishme dhe potencial zhvillimor në Junik, por fatkeqësisht shënon kultivim të ulët të rendimenteve bujqësore. Konkurrenca joreale në treg, qasja e vështirë në tokat bujqësore, mos-organizimi i fermerëve, kreditë jo të favorshme, kapacitete të pamjaftueshme njerëzore në Komunë, në këtë fushë, mosinteresimi i të rinjve për t'u marrë me këtë profesion etj., janë disa arsye të ngecjes së zhvillimit të bujqësisë.

Kultivimi i frutave: Kultivimi, grumbullimi i frutave me theks të veçantë atyre pyjore (gështenjat, boronicat) dhe plasimi i tyre në tregjet e jashtme, si dhe bimëve më veti shëruese është një mundësi zhvillimi.

Agro-industria: Krahas ruajtjes së këtij resursi, korniza e zhvillimit hapësinor rëndësi i kushton edhe zhvillimit të agro-industrisë në lokacionin e përcaktuar, si zonë për prodhimtari në PZHU, si dhe tregut të gjelbër, gjithashtu. Fuqizimi i sektorit të bujqësisë në kuadër të Komunës, ngritja e kapaciteteve organizative të fermerëve, fushata vetëdijesimi etj., janë disa aspekte të tjera zhvillimore të bujqësisë.

Apikultura: Nga fusha e blegtorisë, bletaria është parë si veprimtari më shpresëdhënëse dhe potencial për zhvillim pasuar me prodhimin e mjaltës. Zhvillimi i kësaj veprimtarie lidhet ngushtë me prodhimtarinë e pemëtarisë.

Zhvillimi i kësaj veprimtarie është ngushtë i lidhur me bujqësinë e sidomos me kultivimin e pemëve të cilat sigurojnë kushte të mira dhe stimulojnë bletarinë. Ndikim tjetër pozitiv në zhvillimin e kësaj veprimtarie kanë edhe lulet dhe bimët tjera, si erëzat, sidomos ato që rriten në zona të tjera, në bjeshkë dhe rrëzë. Prodhimet nga bletaria, mjalti dhe dylli kanë përdorim të gjerë edhe nga kompanitë farmaceutike dhe kozmetike, si përbërës të medicinës dhe kozmetikës. Edhe në apikulturë, një organizim më i mirë mund të ndikojë në ngritjen, si të kualitetit, ashtu edhe të prodhimtarisë së mjaltës dhe prodhimeve të tjera nga kjo kulturë. Shoqata e bletarëve duhet të synojë që produktet e mjaltit të kenë një etiketë kualiteti të mbrojtur që i shquan ato në Kosovë dhe jashtë saj.

Tabela 14. Zhvillimi i kulturave bujqësore sipas zonave

Zona 1: Bjeshkët	Zona 2: Pyjet	Zona 3: Vendbanimet, banimi, funksionet administrativo-shërbyese	Zona 4: Bujqësia
Bimët mjekësore.	Blegtoria (Bletaria); Pemëtaria dhe; Bimët mjekësore.	Perimekultura dhe; Pemëtaria.	Drithëra; Perimekultura dhe; Kullosat.

Pylltaria: Potenciali i shfrytëzimit të drunjve në favor edhe të zhvillimit të industrisë së drurit dhe përpunimit final nuk është hulumtuar ende. Aktualisht, ky potencial shfrytëzohet për nevoja të ngrohjes dhe menaxhohet nga Agjencia e Pyjeve të Kosovës. Planet e zhvillimit hapësinor, në zhvillimin e kësaj fushe ekonomike, fokusin e kanë në menaxhimin e këtij resursi nga Komuna dhe ngritjen e kapaciteteve njerëzore dhe organizative për menaxhim të qëndrueshëm të pyjeve, pyllëzim dhe ripyllëzim të zonave të zhveshura, si dhe hulumtimin për zhvillimin e industrisë së drurit dhe përpunimin final. Për të arritur këto duhet të aplikohen praktikrat që përfshijnë shumë palë në interes në modalitetet e shumëllojshme të menaxhimit të pyjeve, si dhe të aplikohet menaxhimi i sektorit privat dhe decentralizimi i përgjegjësive që kanë të bëjnë me pyjet.

Energjia alternative: Shtylla e katërt e zhvillimit ekonomik në Junik bazohet në zhvillimin e energjisë alternative fillimisht me fokusin në ndërtimin e tri hidrocentraleve të vogla pasuar edhe me hulumtimin për mundësi të tjera të shfrytëzimit të energjisë alternative (energjisë së erës, diellit, prodhimin të biomasës etj.).

Blegtoria: Humbja e madhe e fondit blegtoral gjatë luftës. ka ndikuar në të ardhurat kryesore që sillleshin kryesisht nga përpunimi dhe tregtimi i produkteve bujqësore dhe blegtorale.

Juniku ka pozitë të mirë gjeografike dhe ndërkufitare dhe një potencial natyror dhe kulturor por të cilat nuk janë të shfrytëzuara. Ekonomia e Junikut nuk është e zhvilluar sa duhet përkundër që turizmi, bujqësia përfshirë blegtorinë, pylltaria dhe hidro-energjëtika paraqesin potenciale për zhvillim ekonomik.

Masat që duhet ndërmarrë për përparimin e blegtorisë:

- Përmirësimin e racave të kafshëve;
- Stimulimi i fermerëve me subvencione;
- Prodhimi dhe përpunimi i ushqimit të kafshëve, përdorimi i mekanizmit bashkëkohorë për përgatitjen e ushqimit voluminoz dhe atij të koncentruar, si: makineri për përgatitjen e sil-lazhes, makinat për zhveshjen e misrit, rrotoballert për konservimin e ushqimit, aparatura për përgatitjen e ushqimit të koncentruar;
- Grumbullimi dhe përpunimi i prodhimeve blegtorale (pika grumbulluese të qumështit);
- Ofrimi i shërbimeve profesionale nëpër fshatra (stacionet për përparimin e blegtorisë dhe shërbimet veterinare), dhe;
- Mënyra e sigurimit të mjeteve (financimit) për zhvillimin e blegtorisë.

Ndërmarrjet e vogla dhe të mesme

Juniku zhvillimin ekonomik e ndërlihd edhe më fuqizimi e ndërmarrjeve të vogla dhe të mesme, si dhe industrinë dhe bizneset me emetim të ulët. Fokusi i ndërmarrjeve lokale duhet të orientohet në prodhimtarinë bujqësore dhe shërbime.

Përveç prodhimit edhe përpunimi dhe përsosja e produkteve ushqimore janë shumë të rëndësishme për zhvillimin e kësaj industrie. Për prodhimin e produkteve cilësore është e nevojshme fuqi punëtoare e aftë, prandaj trajnimet dhe kurset profesionale janë ato që duhet të plotësojnë prodhimtarinë bujqësore dhe përpunimin e produkteve ushqimore.

Për shkak të përbërjes së tokës dhe kualitetit që ka mund të mbillet gruri, drithërat, luledielli pemët dhe perimet. Duhet hartuar politika të mirëfillta për ofrimin e kushteve për zhvillim të ekonomisë, me theks të veçantë bujqësisë në të gjitha degët e saj. Industrinë dhe bizneset të cilat i përpunojnë resurset rajonale, duhet të gjejnë përkrahje në agjencinë rajonale për marrëveshje, që është përgjegjëse për hulumtim profesional të lokacioneve, si dhe menaxhim të tyre. Në kuadër të zonave të krijuara biznesore dhe industriale, duhet të sigurohet infrastruktura dhe lidhjet efikase me rrjetin regjional rrugor. Profesionistët e rinj duhet të trajnohen për zhvillim ekonomik dhe marketing, me anë të seminareve dhe kurseve në shkollat profesionale.

Tregtia

Sektori i tregtisë është pak i zhvilluar, përkundër faktit që pas luftës së vitit 1999 në Junik ka pasur një rritje të regjistrimit të bizneseve private. Aktualisht në Junik gjithsej janë të evidentuara 84 biznese që ushtrojnë veprimtarinë e tyre. Të gjitha janë të regjistruara në Ministrinë e Tregtisë dhe Industrisë. Dhe gjithashtu, këto biznese janë të pajisura me leje pune nga Komuna. Prej tyre shumica e ndërmarrjeve janë biznese familjare, kryesisht, si ndërmarrje tregtare dhe me gjithsejtë 140 të punësuar në sektorin privatë. Komuna e Junikut ka përgatitur edhe Strategjinë për Zhvillim Lokal, e cila i kushton rëndësi të veçantë zhvillimit dhe përkrahjes së biznesit.

Zejtaria

Traditat e junikasve njihen në kultivimin e zejeve, si për përpunimin e leshit, thurjes së rrobave tradicionale, qëndisjes etj. Me qëllim të ruajtjes së traditave, por edhe përfitimit, shërbimeve dhe kultivimit të produkteve të zejtarisë duhet t'i kushtohet rëndësi e veçantë. Zhvillimi i tij duhet të shihet i ndërlidhur me zhvillimin e turizmit. Në ditët e sotme punohet veshja e katundit (elementet e saj) dhe shihet si zanat me mjaft fitime dhe është shumë i kërkuar.

Turizmi dhe hoteleria

Aktualisht turizmi nuk është sektor i zhvilluar në këtë Komunë edhe pse potenciali natyror dhe ai kulturor ekziston. Potenciali turistik i Komunës së Junikut është ngushtë i lidhur me pozitën gjeografike dhe vlerat kulturore e natyrore të Komunës të cilat ofrojnë kushte për zhvillimin e turizmit malor/veror dhe dimëror, turizmit rekreativ dhe atij kulturor.

Shikuar në aspektin e zhvillimit turistik, Komuna e Junikut ndahet në tri zona me lokalitetet turistike: zona urbane: me potencialin e zhvillimit të turizmit kulturor dhe atij rekreativ; zona “Gryka e Junikut” me lokalitetet turistike: Liqejtë e “Gjeravicës”, Burimet e “Erenikut”, “Lugu i Gjatë” dhe “Rrasa e Zogut”, si dhe zona e “Zharrës” me lokalitetet: “Gradina”, “Jedova”, “Zharra”, “Jasiq” dhe “Gjocaj” (shih më gjerësisht kaptinën e potencialit natyror). Aktualisht komplekset/zonat më të vizituara nga turistët janë: “Maja e Gjeravicës” me dy liqejtë natyror, lumi “Erenik”, parku “Moronica”, “Kullat” etj.

Sektori i turizmit është ngushtë i lidhur me zhvillimin e hotelerisë dhe gastronomisë (kuzhinës). Hotelet dhe objektet që ofrojnë shërbime hotelierike në Junik janë: Motel-Restaurant “Oda e Junikut”; Motel “Gjeravica” dhe “Konaku i Ramë Zymberit”, të cilat menaxhohen nga sektori privat. Kapaciteti i këtyre objekteve hoteliere është i kënaqshëm. Meqë turizmit i është dhënë prioritet, si sektor i zhvillimit në të ardhmen, atëherë duhet marrë parasysh edhe ngritjen e kapaciteteve hoteliere. Përveç hotelerisë, faktorë tjerë të cilët gjithashtu ndikojnë në zhvillimin e turizmit janë: qasja (arritshmëria) deri të objektet/lokacionet turistike; konkurrenca; promovimi (marketingu); aktivitetet (ngjarjet kulturore, sportive, argëtuese etj.). Këto elemente mungojnë shumë në Junik ndaj ka nevojë për veprime të menjëhershme në këto fusha si turizmi malor, tranzit, shëndetsorë, kulturor, eko turizem dhe rekreativ.




Foto 21. Lokalitete turistike në bjeshkët e Junikut

Turizmi malor

Turizmi malor si aktivitet ishte shumë i shprehur në periudhën paralufte, mirëpo me zhvillimet që ndodhën dhe luftën e fundit ato janë ndërpre. Tash veç vërehen disa nisma të grupeve të ndryshme të rinjve për ngjalljen e këtij lloji sporti, i cili përveç efekteve atraktive ka edhe ato shëndetësore. “Bjeshkët e Junikut” me bukuritë e veta natyrore me vlera të larta ekologjike,

gjeomorfologjie, me florën dhe faunën e saj shumë të pasur, me peizazhin e jashtëzakonshëm të lokaliteteve, me majat më të larta në vend, me gryka, lokalitete arkeologjike, burime, gurra, shpella dhe me monumente të pasura të trashëgimisë, ofron kushte të volitshme për zhvillimin e turizmit, i cili do të jetë një shtytës për zhvillimin e degëve të tjera të ekonomisë. Turizmi malor, dimëror dhe veror, duhet të jetë një prej formave më të avancuara të turizmit dhe këtë për shkak të kushteve të volitshme që ofron ky rajon për vizitorët. “Bjeshkët e Junikut” njihen për peizazhe të bukura dhe atraktive, të cilat njëherësh shfrytëzohen për kullosa të bagëtive dhe vendverime të blegtorëve.

Ekzistenca e këtyre bukurive ofron kushte të volitshme për ndërtimin e qendrave të ndryshme turistike. Njëherësh, “Bjeshkët e Junikut” ofrojnë mundësi të volitshme për zhvillimin e turizmit dimëror. Morfologjia e terrenit dhe reshjet e borës, si dhe jetëgjatësia e saj deri në muajin qershor, krijojnë parakushte elementare për zhvillim të këtij lloji të turizmit. Sa i përket turizmit veror, mund të thuhet se tashmë ka filluar frekuentimi i këtyre lokaliteteve edhe pse edhe kjo formë e turizmit është në fazën fillestare, për shkak të mungesës së infrastrukturës rrugore deri të këto atraksione, si dhe për shkak të mungesës së infrastrukturës hoteliere në bjeshkë.

Për zhvillimin dhe nxitjen e kësaj formë të turizmit do të duhet të përcillet me kujdes, pasi që shumë lehtë në rast se nuk përcillet mund të devalorizojë këto vlera të çmueshme.

Speleo-turizmi: “Bjeshkët e Junikut” janë të njohura edhe për shpellat e shumta që gjenden në këtë rajon. Nuk ka ndonjë evidencë për numrin e tyre, por tregohen ngjarje interesant për to. Në të ardhmen duhet të bëhen hulumtime dhe inventarizim i tyre në interes të turizmit. Numri i madh i shpellave në bjeshkë janë resurse me potencial për zhvillimin e turizmit. Speleo-turizmi nënkupton vizitën e shpellave dhe labirinteve natyrore. Kushtet e vështira, si lagështia dhe mungesa e dritës, janë faktorë që e bëjnë speleo-turizmin aktivitet aventuristik dhe për këtë arsye është shumë i popullarizuar për moshat e reja. Komuna do të duhej të promovojë hulumtimet në shpellat e njohura dhe të krijojë kushte për këtë lloj turizmi atraktiv.

Turizmi kulturor: Tradita, ritet, trashëgimia kulturore dhe lokalitetet arkeologjike në Komunën e Junikut janë potencial për zhvillimin e turizmit kulturor. Janë këto elemente të cilat akoma jetojnë në Junik, por gradualisht po shuhen. Do të ishte mirë sikur kultura të përcillej me një marketing të mirëfilltë, i cili është mjet i rëndësishëm për t'i joshur turistët e interesuar në trashëgimi kulturore, histori dhe arkeologji. Numri i madh i ndërtesave të trashëgimisë kulturore, kulla, mulli, objekte të religjionit, lokalitete arkeologjike etj., janë resurse të cilat mund të përdoren nga asociacione apo korporata të cilat merren me mirëmbajtjen e tyre, për promovimin e këtij tipi të turizmit.

Objektet e trashëgimisë kulturore, të ndërtuara para shumë shekujsh, të cilat kanë një vlerë të madhe kulturo-historike paraqesin një bazë të mirë për zhvillimin e kësaj forme të turizmit. Rëndësia e politikës së zhvillimit të turizmit kulturor është se ndikon edhe në mbrojtjen dhe ruajtjen e objekteve të ndryshme historiko-kulturore nga shkatërrimet e ndryshme, si dhe i japin vlera më të mëdha atyre objekteve, si dhe e ngrisin imazhin dhe historinë e Komunës së Junikut. Mirëpo, deri më tani për zhvillimin e kësaj forme të turizmit është bërë fare pak. Rekomandohet që të restaurohen objektet e trashëgimisë dhe t'u jepet funksioni, sepse kështu u jepet jeta, në të kundërtën rrezikojmë humbjen e këtyre vlerave dhe njëkohësisht turizmit kulturor në përgjithësi.

Turizmi rural: Komuna e Junikut ka potencial të zhvillimit të turizmit rural, për arsye se gjendet në mes të natyrës dhe edhe zona urbane e tij në mes të lagjeve dhe parcelave ka sipërfaqe ku kultivohen prodhime dhe kultura të ndryshme dhe karakteristike për rajonin. Vend të rëndësishëm zë edhe blegtoria me ç'rast ofrohen prodhime shumë kualitative dhe BIO nga ky sektor i bujqësisë. Informimi i qytetarëve për rëndësinë e objekteve të gurit, trajnimi i tyre për menaxhim të këtij lloji të

turizmit dhe subvencionimi i tyre sa për të filluar veprimtarinë do të ishte një hap i madh drejtë një zhvillimi që do të gjeneronte të ardhura. Ofrimi i kushteve bad & breakfast është ideale dhe një formë e tillë e ofertës nuk është vështirë të ofrohet. Po ashtu hartimi i planeve rregulluese për fshatrat “Jasiq” e “Gjocaj” dhe zbatimi i rreptë i këtyre planeve për këto lokalitete do të ishte bazë e mirë e një zhvillimi ekonomik të qëndrueshëm, pasi që në Planin Zhvillimor Komunal (PZHK) rekomandohen të zhvillohen si fshatra turistike (ngjashëm me Theth-Shqipëri).

Turizmi transit: Kjo formë e turizmit ka qenë e zhvilluar në të kaluarën në periudhën e paraluftës mu për shkak të pozitës gjeografike – vend ndodhjes në trekëndëshin Kosovë - Shqipëri - Mali i Zi, ku shumë turistë në atë kohë vizitonin “Bjeshkët e Junikut”, me theks të veçantë “Gjeravicën”, “Gusanin” e vende të tjera karakteristike dhe në atë kohë ekzistonte edhe shtëpia e turistëve në vendin e quajtur “Dervishkom”.


Rrugëtimi i turistëve nga “Gjeravica”, “Bjeshkëve të Junikut” dhe vazhdonte në Mal të Zi, konkretisht Bogiqe dhe Plavë.

Me një lëvizje dhe promovim të turizmit në panairë ndërkombëtare, hartim të guidave të mira turistike dhe promovim përmes ueb faqeve do të ishte më se e nevojshme.

Eko-turizmi: Juniku me llojlojshmëri natyrore shumë të pasur dhe të pa shkatërruar, me tokë shumë pjellore e cila punohet nga fshatarët të cilët ofrojnë eko-prodhime ushqimore, me bjeshkë atraktive, të cilat ofrojnë kushte të volitshme për pushim dhe rekreacion, pastaj me një përkujdesje më të madhe ndaj pastërtisë së qytezës, mirëmbajtës dhe grumbullimit të mbeturinave, ofron kushte shumë të volitshme dhe ofertë të begatshme për të gjithë turistët që dëshirojnë ta vizitojnë këtë lokalitet.

ÇKA TË NDËRMERRET PËR NXITJEN E TURIZMIT

Përderisa Komuna e Junikut zhvillimin e vet e mbështet në turizëm, pasi që ka potenciale, është koha që të lëvizë me hapa më të shpejtë dhe të sigurtë drejt hulumtimit, inventarizimit, dokumentimit dhe promovimit të potencialit që e ka. Duhet bashkuar forcat, qeveritarë e shoqëri civile, të ndajnë detyrat dhe secili të jep përgjigje para përgjegjësive të veta dhe në këtë mënyrë të kontribuojnë të bashkuar për cakun që kemi të gjithë. Është e nevojshme dhe emergjente hartimi i një studim fizibiliteti për zonën bjeshkë, ngjashëm me atë të Brezovicës, ku pastaj të jepen orientimet dhe normat e shfrytëzimit të kësaj zone me interes të përbashkët. Këtu do duhej të ndihmonte edhe Qeveria qendrore, pasi që “Bjeshkët e Nemuna” – Perlat e Kosovës, paraqesin potencial për shtetin.



Pjesa 4

III. ANKETA ME QYTETARË DHE IDENTIFIKIMI I PROBLEMEVE

Rezultatet e hulumtimit në Komunën e Junikut
Të dhëna bazike rreth të intervistuarve

SHPËRNDARJA E MOSTRËS PËR KOMUNËN E JUNIKUT


Për realizimin të këtij hulumtimi në pjesët urbane të Junikut janë intervistuar 500 respondentë. Ky numër i respondentëve është ndarë tutje në aspektin gjinor: 51 % meshkuj dhe 49 % femra, ndarje e bazuar në të dhënat e regjistrimit të popullsisë të realizuar gjatë pranverës së vitit 2011. Ndarja e mostrës ka filluar tutje të shpërndahet nëpër grupmosha, si për meshkuj, ashtu edhe për femra: 10 % e respondentëve kanë përbërë grupmoshën nën 18 vjeç; 20 % për grupmoshën 18 deri në 25 vjeç; 43 % për grupmoshën 25 deri në 50 vjeç; 20 % për grupmoshën 50 deri në 65 vjeç; si dhe 7 % për grupmoshën mbi 65 vjeç. Kjo ndarje në grupmosha është bazuar në numrin e respondentëve që përbëjnë në atë grupmoshë, ndikimin dhe reflektimin që kanë në jetën sociale, politike dhe ekonomike, si dhe ndikimin dhe reflektimin që mund të kenë në të ardhmen e afërt.

Komuna	Gjinia	Meshkuj (51 %)					Femra (49 %)				
		Mosha # i resp.	>18	18-25	25-50	50-65	65+	>18	18-25	25-50	50-65
Junik	500	10%	20%	43%	20%	7%	10%	20%	43%	20%	7%
		26	51	110	51	17	25	49	106	49	16

1. PERCEPTIMI PËR GJENDJEN E TANISHME MJEDISORE

1.1. Gjendja e tanishme mjedisore në territorin e Komunës suaj:

Në pyetjen se si e vlerësoni gjendjen e tanishme mjedisore në territorin e Komunës tuaj, shumica e respondentëve nga Juniku janë përgjigjur se: gjendja në territorin e Komunës së tyre është e kënaqshme, me gjithsej 35.9 %, e mirë me 29.1 %, si dhe e pakënaqshme me 31.9 %. Nga këto të dhëna mund të konkludojmë se Junikasit gjendjen mjedisore në Komunën e tyre e konsiderojnë si të kënaqshme. Përgjigjja nuk varion tepër kur krahasohet në mes të dy gjinive, për më tepër shih ilustrimin në grafet e më poshtme.




1.2 Pesë (5) problemet kryesore në fushën e mjedisit në Komunën tuaj:

Si problem kryesore mjedisore qytetarët nga Juniku kanë listuar:


- a) Menaxhimin e mbeturinave komunale, si problemin kryesor;
- b) Rrugët jo të mira lokale, shtigjet, mungesa e parkingjeve, si problemin e dytë më të rëndësishëm;
- c) Mungesa e shërbimeve komunale, si problemin e tretë më të rëndësishëm;
- d) Përdorimi i pakontrolluar i tokës bujqësore, si problemin e katërt më të rëndësishëm, si dhe;
- e) 'Mosmirëmbajtja e zonave të gjelbra, parqeve dhe shiritave mbrojtës, është renditur si problem i pestë për nga rëndësia.

Edhe në këtë rast renditja e problemeve mjedisore nuk ka ndryshuar për nga përcipioni gjinor, për ilustrim shih grafet në vazhdim.



1.3 Tre (3) ndotësit kryesorë të mjedisit në territorin e Komunës tuaj:

Si ndotës kryesorë mjedisore në Komunës e Junikut responentët kanë paraqitur: mbeturinat komunale, ekonominë e vogël, kanalizimin dhe bujqësinë. Kjo ndarje nuk varion tepër në aspektin gjinor. Për më tepër shih paraqitjen grafike.



Si ndotës mjedisore tjerë, qytetarët e Junikut kanë identifikuar: Djegien e pyjeve, mbeturinat nga komuniteti dhe mos përgjegjësinë e vetë qytetarëve.


2 STRATEGJIA E ZHVILLIMIT DHE INFORMIMIT

2.1 Çka duhet të jetë bazë e zhvillimit të ardhshëm të Komunës suaj?

Si bazë për zhvillimit të ardhshëm të Junikut, qytetarët e intervistuar listojnë:


1. Turizmin;
2. Bujqësinë;
3. Industrinë dhe;
4. Prodhimin e produkteve ekologjikisht të pastra etj.

Shih ilustrimin grafik për rëndësinë e dhënë, nga të intervistuarit, për fushat bazë për zhvillim të Komunës së tyre në të ardhmen.



2.2 A posedon Komuna personin/shërbimin që merret me mbrojtjen e mjedisit?

Një numër i limituar i qytetarëve të intervistuar janë në dijeni së Komuna e Junikut posedon personin apo shërbimin që merret me mbrojtjen e mjedisit. Në përqindje 22.5 % janë shprehur së Komuna posedon personin apo shërbimin që merret me mbrojtje të mjedisit, 29.4 % shprehen që Komuna nuk e ka këtë shërbim, ndërsa 48.1 % nuk e dinë se a e posedon Komuna këtë shërbim. Për ilustrim shih grafet e më poshtme.




3 VIZIONI ZHVILLIMOR

3.1 Çfarë mendoni se do të jetë gjendja e mjedisit në pesë (5) vjetët e ardhshme në territorin e Komunës suaj?

Shumica e qytetarëve të intervistuar të Junikut janë optimist sa i përket gjendjes së ardhshme mjedisore. Në pyetjen se, çfarë mendoni se do të jetë gjendja mjedisore në pesë (5) vjetët e ardhshme në territorin e Komunës suaj? Shumica e respondentëve janë përgjigjur se do të jetë më e mirë me 78.3 %, e njëjtë 15.5 %, si dhe më e keqe me 4.0 %. Pothuajse mendimin e njëjtë e ndajnë si femrat, ashtu edhe meshkujt.

Për ilustrim shih tabelat e poshtë shënuara.




3.2 Rrumbullakësoni tri (3) problemet që më së shumti ndikojnë negativisht në cilësinë e jetës, në lagjen tuaj?

Në pyetjen se cilat janë tri (3) problemet që më së shumti ndikojnë negativisht në cilësinë e jetës, në lagjen tuaj, respondentët nga Juniku kanë përzgjedhur:

1. Deponitë e mbeturinave komunale, si problemin e parë;
2. Rrugët e këqija lokale apo mungesa e parkingjeve, si problemin e dytë, dhe;
3. Përdorimi i pakontrolluar i tokës bujqësore, si problemin e tretë.

Për më tepër shih ilustrimet grafike mbi problemet që më së shumti ndikojnë negativisht në cilësinë e jetës në lagjen e tyre:



Identifikimi i problemeve

PROBLEMET MJEDISORE NË KOMUNËN E JUNIKUT

Nr.	Problemet
1.	Menaxhimi i mbetjeve urbane dhe deponitë ilegale të tyre;
2.	Rrugët jo të mira, mungesë e shtigjeve për këmbësorë, mungesë e parkingjeve;
3.	Përdorim i pakontrolluar i tokës;
4.	Mungesa e shërbimeve komunale;
5.	Mungesa e hapësirave të lira;
6.	Mbrojtja e biodiversitetit (mungesa e strategjisë për ruajtjen e biodiversitetit);
7.	Zhvillimi i turizmit;
8.	Formimi i deponive ilegale pranë qendrave të banimit dhe vendet rurale;
9.	Keq menaxhimi dhe degradimi i pyjeve;
10.	Hartimi i planit për zona të mbrojtura – kullat;
11.	Trajtimi jo adekuat i ujërave të zeza, përkatësisht derdhja e tyre në lumenj;
12.	Organizimi i aktiviteteve të deminimit;
13.	Rregullimi i itinerarit turistik;
14.	Mungesa e një zhvillimi të qëndrueshëm në zonën turistike;
15.	Hartimi i studim fisibiliteti për parkun “Moronica”;
16.	Mungesë e pronës publike dhe;
17.	Mungesa e strategjive për parandalimin e erozionit.

Masat që duhet ndërmarrë:

Për mbrojtje, shfrytëzim dhe zhvillim të mjedisit në mënyrë të shpejtë duhet të reagohet dhe të ndërmerren masat e duhura, si:

- Hartimi i strategjisë për menaxhim të mbeturinave;
- Zbatimi i plotë i planeve, qofshin hapësinore edhe ato rregulluese,
- Hartimi i studim fisibiliteti për zonën bjeshkë;
- Menaxhimi i rreptë i prerjes dhe degradimit të pyjeve;
- Minimizimi i ndikimeve të rrezikshme, si vërshimet, erërat, zjarret etj.;
- Mbrojtja e llojlojshmërisë së peizazheve natyrore;
- Mbrojtja e burimeve dhe hidrografisë në përgjithësi;
- Rregullimi i hapësirave të gjelbra;
- Rregullimi i hapësirave rreth lumenjve “Erenik” dhe “Trava”;
- Shfrytëzimi, por edhe mbrojtja e burimeve të ujit;
- Minimizimi i veprimeve të dëmshme të njeriut në mjedis;
- Kontrolli i zhvillimit në zonën urbane;
- Përparimi i sistemit të furnizimit me ujë të pijshëm;
- Ndërtimi i sistemit të kanalizimit atmosferik;
- Rikonstruktimi dhe rigjenerimi i zonave të trashëgimisë historike dhe kulturore;
- Mbrojtja e tokës kualitative bujqësore dhe ndalimi i ndërtimit në tokat e kategorisë 1-4;
- Mbrojtja e ndotjes së ajrit nga trafiku dhe prodhimtaria urbane dhe industriale;
- Ndërtimi i kolektorit edhe për segmentin e parë të kanalizimit;
- Mbrojtja e lumenjve nga degradimet;
- Matja e rregullt e sasisë së ndotjes së këtyre ujërave dhe;
- Mbrojtja e shtretërve të lumenjve.

1. Uji

Problemi	Shkaku Listë shkaqesh që sjellin problemin, që mund të jenë, fizike dhe njerëzore.	Shkalla e ndikimit	Ndikimi Paraqet ndikim negative në mjedis, shëndet, mirëqenie etj.	Prioriteti I matur me shkallën: *Pak i rëndësishëm **Mesatarisht i rëndësishëm ***Shumë i rëndësishëm.
1.1 Lumenjtë Rënia e vazhdueshme e nivelit të ujit në lumenjtë “Erenik” dhe “Trava”.	-Ngruhja globale; -Ndryshimet klimatike nga degradimi i pyjeve; -Reshjet e pakta; -Ndryshimet klimatike nga ndotja dhe; -Uzarpimi i sipërfaqeve rreth lumenjve.	E lartë	-Pakësimi i rezervave të ujit; -Degradimi i bregut të lumenjve dhe; -Humbja e sipërfaqeve publike.	***
1.2 Lumi “Erenik” Ndotja e lumit nga derdhjet e ujërave të zeza, mbeturinave dhe vërshimeve.	-Derdhja e ujërave të zeza të patrajuara; -Hedhja e mbeturinave; -Ngushtim i shtretërve të lumenjve nga ndërtimet e pa kontrolluara; -Devijimi nga shtrati i vetë natyror dhe; -Ndërrimi i rrjedhës natyrore të lumit.	E lartë	-Ndotje e ujit; -Degradim dhe ndotje e bregut të lumit; -Rrezik për florën dhe faunën në ujë; -Përmbytja e tokave bujqësore nga ngushtimi i shtretërve dhe kanaleve; -Ujë i papastër; -Ndotje e tokave përmes ujitjes dhe; -Ndikimi i ndotjes edhe në Komunën fqinje, deri të “Drini i bardhë” dhe më tutje.	***
1.3 Sistemi i ujitjes 1.3 a. Mos shtrirja e rrjetit të ujitjes.	-Mos funksionimi i mirëfilltë i sistemit të ujitjes; -Buxhet i vogël komunal dhe; -Vetëdija jo e lartë e popullatës për funksionin e rrjetit të ujitjes.	E mesme	-Zvogëlimi i sipërfaqeve të ujitura; -Humbje e ujit për ujitje dhe; -Zvogëlim i prodhimitarisë.	**
1.3. b. Rrjeti i kanaleve të ujitjes Mosmirëmbajtja e kanaleve të ujitjes; Sistemi i vjetruar i kanaleve dhe; Menaxhim i keq i ujit për ujitje.	-Humbje e ujit; -Mos mirëmbajtja e kanaleve nga ndërmarrja e ujërave; -Mungesë investimesh dhe; -Mungesa e digave për kanale të ujitjes.	E lartë	-Ulja e prodhimitarisë; -Rënie e cilësisë së prodhimeve bujqësore; -Zvogëlim i të ardhurave; -Degradim i kanaleve natyrore dhe; -Konflikt mes banorëve.	***
1.4 Ujërat nëntokësore Rënie e sasisë së ujërave nëntokësore, si pasojë e reshjeve të pakta.	-Ngruhja globale; -Ndryshime klimatike dhe; -Dëmtimi i sipërfaqeve të gjelbra dhe i pyjeve.	E mesme	-Zvogëlim i sasisë së rezervave të ujërave nëntokësore dhe; -Ndikim negativ në mjedis.	**

2. Toka

Problemi	Shkaku	Shkalla e ndikimit	Ndikimi	Prioriteti
2.1 Humbja e tokës bujqësore	-Lëvizjet demografike të pakontrolluara; -Mungesa e planeve rregullative urbane; -Ndërtimet në toka bujqësore dhe; - Ndërrimi destinacionit të tokës bujqësore në ndërtimore.	E mesme	-Ulje e nivelit të zhvillimit të bujqësisë; -Zvogëlim i prodhimitarisë; -Zvogëlim të sipërfaqes prodhuese; -Ulje e zhvillimit ekonomik dhe; -Migrim i popullatës.	**
Përmbytjet e tokës bujqësore.	-Mos rregullimi i shtretërve të lumenjve dhe; -Mos mirëmbajta e kanaleve të ujitjes dhe kanaleve kulluese.	E mesme	-Humbja e sipërfaqes së tokës punuese dhe; -Ndryshimi i përdorimit të tokës.	**
Ulja e nivelit të punësimit në bujqësi.	-Trendi i qytetit - migrimi i popullatës; -Mungesë subvencionesh dhe -Mungesë e tregut të shitjes.	E mesme	-Të ardhura të ulëta; -Ulë vlerat e tokës dhe ndikon negativisht në zhvillimin e qëndrueshëm dhe; -Ulë interesimin për bujqësi.	**
2.2 Tokat pyjore dhe kullosat Humbja e tokës pyjore.	-Keq menaxhimi i pyjeve; -Prerja pa kriter i pyjeve; -Kullosja e tepërt dhe; -Djegia e pyjeve.	E mesme	-Ndryshime klimatike; -Zvogëlim i sipërfaqes pyjore; -Ndikimi në peizazhe; -Ndikim në cilësinë e tokës humusore dhe; -Ulë zhvillimin ekonomikë.	**
2.3 Tokat erozive Bimësi e pakët, ndikim në erozion.	-Eksplotimi i rërës; -Prerja pa kriter i pyjeve dhe; -Mungesa e pendave mbrojtëse.	E ulët	-Humbje e tokës; -Zvogëlim i masës drusore dhe; -Rrezik për njerëz.	*
2.4 Tokat ndërtimore Shfrytëzim joracional i tokës ndërtimore.	-Mosinteresimi i duhur; -Mungesa e zbatimit të planeve hapësinore; -Moszbatimi i ligjeve dhe; -Mungesë fondesh dhe kapacitetesh.	E lartë	-Rritë koston e jetës; -Ulë zhvillimin e bujqësisë; -Pengon mundësinë e zhvillimit të prioriteteve; -Parregullsi urbanistike; -Ulë cilësinë e mjedisit dhe; -Rritë volumin e inerteve dhe ndotjen e ajrit.	**
Rritja e trafikut në qytet. Mungesa e vend-parkingjeve.	-Dinamika e jetës dhe; -Rritja e numrit të automjeteve.	E lartë	-Shton rrezikun për kalimtarët; -Rritë koston e jetesës; -Rritë nivelin e ndotjes; -Rritë nivelin e zhurmës; -Zvogëlim i sipërfaqes së këmbësorëve dhe; -Dëmtimi i trotuareve.	***
Mungesa e hapësirave publike.	-Mungesë e pronës publike; -Mosinteresimi për investime në këtë drejtim; -Mungesë fondesh dhe; -Buxheti i kufizuar.	E lartë	-Ndikim në zhvillim të rinisë; -Zvogëlim i aktiviteteve sportive; -Ulje e aktiviteteve rekreative; -Ulje e aktiviteteve shëndetësore; -Mungesë e mjediseve çlodhëse; -Ajër dhe ambient i papastër; -Ulë vlerat turistike të qytetit.	***

3. Ajri

Problemi	Shkaku	Shkalla e ndikimit	Ndikimi	Prioriteti
Ndotja e ajrit nga emetimet e gazrave të dëmshme.	-Ekzistimi i fermave në zonën urbane; -Përdorimi i automjeteve të vjetruara; -Numri i madh i automjeteve pa filtër; -Përdorimi i gjeneratorëve; -Djegia e mbeturinave plastike, gomave dhe atyre familjare, dhe; -Avullimet nga deponitë dhe rrjeti i zbuluar i ujërave të zeza.	E lartë	-Rreziku i epidemive; -Vështirësi frymëmarrje për njerëz; -Ndikimi në shëndetin e popullatës; -Mundësia e infeksioneve të ndryshme dhe; -Ajër i papastër.	***
Ndotja e ajrit nga pluhurat.	-Strukturë jocilësore e rrugëve; -Mospastrimi i duhur i rrugëve dhe; -Rrugët e paasfaltuara.	E mesme	-Rritje e kostos jetësore; -Ndikimi në shëndetin e popullatës dhe; -Ndotje e ambientit.	**

4. Biodiversiteti

Problemi	Shkaku	Shkalla e ndikimit	Ndikimi	Prioriteti
Biodiversiteti	-Mungesa e një studimi për llojet e rrezikuara të specieve të veçanta; -Mungesa e një strategjie për ruajtjen e florës dhe faunës; -Mosnjohja e vërtetë e vlerave; -Vetëdije e ulët për diversitetin; -Mungesa e hulumtimeve dhe inventarizimit për diversitet; -Mungesa e një strategjie për ruajtjen e biodiversitetit dhe; -Mungesa e investimeve në këtë lëmi.	E lartë	-Rrezik për shfarosje i faunës; -Dëmtimi i florës dhe faunës; -Zhdukja e specieve të rralla bimore dhe shtazore; -Varfërimi dhe dëmtimi i habitateve; -Humbje e vlerave të trashëguara nga natyra; -Ulje e vlerave mjedisore; -Ulje e mundësive turistike; -Ulje në zhvillim ekonomik dhe; -Ulje e nivelit të studimit për këto vlera.	***
Pyjet	-Keq menaxhim i pyjeve; -Mungesa e një strategjie për mbrojtje dhe menaxhim; -Prerja pa kriter i pyjeve; -Djegia masive e sipërfaqeve dhe; -Kanceri i gështenjës.	E lartë	-Humbje e sipërfaqeve pyjore; -Humbje e masës drusore; -Ndryshime klimatike; -Pakësim i reshjeve; -Humbje e gështenjës; -Ndikime shëndetësore; -Ndikim negativ në mjedis dhe; -Pakësim i florës dhe faunës.	***
Bota shtazore dhe e shpezëve	-Mungesa e hulumtimit shkencorë; -Mungesa e përkujdesjes; -Mungesa e inventarizimit dhe vënia nën mbrojtje; -Zhurmat në pyje; -Aktivitetet në pyje; -Aktivitetet e deminimit; -Zvogëlimi i sipërfaqes pyjore dhe; -Gjuetia e paligjshme gjatë kohës së shumimit.	E lartë	-Humbje e specieve të veçanta; -Ulje vlerash turistike; -Humbje e diversitetit; -Prishja e ekosistemit (zinxhirit jetësor-ushqyes) dhe; -Ndikon negativisht në zhvillimin e faunës së egër, gjuetisë sportive dhe turistike.	***
Zonat e mbrojtura.	-Mosnjohja e vlerave për zonat e mbrojtura; -Mungesa e planit për zonat e mbrojtura-kullat; -Vetëdije e ulët për mundësitë që ofrojnë objektet e trashëgimisë; -Mungesa e inventarizimit dhe vënia nën mbrojtje; -Shkatërrimi i tyre dhe; -Mungesa e investimeve.	E lartë	-Humbja e vlerave; -Ulje e mundësive turistike; -Humbja e trashëgimisë; -Ulje e mundësive për zhvillim ekonomik dhe; -Humbja e lidhjes me të kaluarën.	***
Rrjedhat ujore.	-Vetëdije e ulët për vlerat; -Ndryshimi i rrjedhave; -Mosmarrja e masave për sanimin e terrenit të dëmtuar; -Ndërtime të egra të kanaleve; -Hedhja e mbeturinave dhe; -Eksplotim i rërës.	E mesme	-Humbja e vlerave hidrografike; -Ndotje e rrjedhave ujore; -Ndryshim i rrjedhës së lumit e si pasojë erozioni i brigjeve; -Dëmtim i peizazhit natyror dhe; -Peizazh jo i këndshëm.	**

5. Mjedisi social dhe ekonomik

Problemi	Shkaku	Shkalla e ndikimit	Ndikimi	Prioriteti
5.1 Arsimi Mungesë e një strukture të plotë edukimi mjedisor në shkolla dhe në komunitete.	-Aplikimi dhe ndryshimi i reformave arsimore-qendra; -Tregtia me diploma-kualifikime (universitetet); -Vetëdije e ulët për arsim; -Rivaliteti partiak-qendror dhe lokal; -Mungesa e vizionit; -Mungesë investimesh; -Mungesa e aplikimit të praktikës; -Mungesa e lëndës së mjedisit, si e obliguar në arsim dhe; -Kordinim jo i mirë në mes institucioneve relevante.	E lartë	-Ndikim negativ në menaxhimin e natyrës; -Ulje e vlerave qytetare të rajonit; -Ndikon në rritjen e brezit të ri (ambientalist); -Atakime të përditshme në vlerat mjedisore dhe; -Ulje e vlerave mjedisore.	***
5.2 Bujqësia Sipërfaqet e tokës.	-Ndërtimet e pakontrolluara; -Copëzimi i tokave; -Kthimi i tokës në livadhe; -Konkurrenca jo e drejtë e tregut; -Ndryshimi i stilit të jetesës dhe; -Humbja e interesimit për bujqësi.	E lartë	-Ulje e zhvillimit ekonomik; -Humbje e tokës bujqësore; -Trendi i qytetërimit; -Ulja e vlerave të tokës dhe; -Humbja e llojllojshmërisë së misrave dhe kulturave të tjera.	**
Ulje e nivelit të punësimit në bujqësi.	-Mungesë e tregut të shitjes; -Mungesë subvencionesh; -Konkurrenca jo e drejtë tregtare dhe; -Mungesa e politikave strategjike.	E lartë	-Të ardhura të pakta ekonomike; -Nxitje e emigracionit; -Ulje e prodhimtarisë dhe; -Humbja e interesimit për kultivim dhe mbjellje.	***
5.3 Blegtoria Sektori i blegtorisë.	-Vetëdije e ulët për këtë sektor; -Mungesë politikash zhvillimore; -Mungesë investimesh në përmirësimin racorë; -Mos subvencionimi dhe; -Konkurrenca jo lojale.	E lartë	-Rënie e të ardhurave ekonomike; -Rënie e interesimit për blegtori; -Humbja e diversitetit dhe; -Ulje e vlerave turistike.	***
Përpunimi dhe tregu.	-Mungesa e fondeve për teknologjinë e përpunimit; -mungesa e sigurimit të tregut dhe; -Mungesa e politikave zhvillimore.	E lartë	-Ulje e krerëve të blegtorisë; -Ulje e prodhimtarisë; -Bie interesimi për kultivim dhe; -Ulje e diversitetit.	***

6. Turizmi

Problemi	Shkaku	Shkalla e ndikimit	Ndikimi	Prioriteti
Turizmi	<ul style="list-style-type: none"> -Mungesa e promovimit të ofertës turistike (turizmit malor fushor, speleo-turizmit); -Mungesa e ekspertëve për hartimin e një plani afatshkurtër; -Mungesa e paketave turistike profesionale për tërheqjen e klientëve të huaj dhe vendës; -Mungesa e një rrjeti të infrastrukturës turistike; -Menaxhimi joprofesional i hoteleve; -Mungesa e restoranteve tradicionale; -Staf me një nivel të ulët profesional; -Mungesa e promovimit të restoranteve tradicionale; -Lënie pas dore; -Mosinteresimi i institucioneve relevante nga niveli qendror dhe lokal; -Mungesa e trajnimeve për aftësimin e kadrove për menaxhim të turizmit dhe; -Mungesa e materialeve promovuese turistike (tabela orientuese, spote, broshura etj.). 	E lartë	<ul style="list-style-type: none"> -Ulje e përfitimeve ekonomike; -Ulje e vlerave turistike; -Ulje e numrit të turistëve; -Formë e paorganizuar e turizmit; -Mosinteresimi për vizitë në vend; -Humbje e vlerave turistike; -Degradim i vlerave turistike të rajonit; -Moszhvillimi i Komunës dhe; -Migrimi i popullatës për mungesë pune. 	***

Pjesa 5

IV. PLANIFIKIMI I VEPRIMEVE

Veprimet: Lista e veprimeve që duhet të ndërmerren për zgjidhjen e problemeve:

Prioriteti - i matur me shkallën: *Pak i rëndësishëm, **Mesatarisht i rëndësishëm, ***Shumë i rëndësishëm

Afati kohor - i matur me shkallën: Afatshkurtër, deri 5 vjet - Afatmesëm, deri 10 vjet - Afatgjatë, deri 15 vjet

Akterët përgjegjës dhe bashkëpunëtorët e mundshëm: Mund të jenë institucionet që janë direkt përgjegjës për problemin, si dhe akterë të tjerë në rolin e bashkëpunuesit

Efekti: Një përshkrim i efektit pozitiv që vjen nga zgjidhja e këtyre problemeve.

1. UJI

Problemi	Veprimet	Prioriteti - Afati kohor	Akterët	Efekti
1.1 Lumenjtë (përroskat, ujërat sipërfaqësore) Ndotja e ujit dhe degradimi i lumenjve dhe përroskave nga komuniteti dhe faktorët natyrorë.	-Gjobitja e dëmtuesve; -Ndalimi i hedhjes së mbeturinave të ngurta në lumenj; -Ngritja e gardheve antierozive në brigjet e zhveshura; -Rregullimi i shtretërve të lumenjve “Erenik” dhe “Trava” dhe; -Vetëdijesimi i qytetarëve.	*** Afatshkurtër	-Komuna; -Ministritë përkatëse; -Donatorët e mundshëm dhe; -Komuniteti.	-Mjedis i pastër për jetesë; -Harmoni mjedisore; -Mjedis rekreativ dhe i shëndoshë; -Shpenzim i kontrolluar i ujërave; -Mjedis sportiv; -Mbrojtja e tokave nga përmbytjet dhe; -Uji i pastër për ujitje.
1.2 Lumi “Erenik” Derdhja e ujërave të zeza të patrajuara, dhe Degradimi i rrjedhës së lumit dhe ulja e nivelit të tij.	-Ndërtimi i kolektorit për trajtimin e ujërave të zeza (faza e parë) dhe; -Pastrimi dhe rregullimi i shtratit të lumit.	*** Afatshkurtër	-Ministritë përkatëse; -Donatorët dhe -Komuna.	-Pastrimi i ujit për përdorim; -Përdorim i ujit për bujqësi; -Mbrojtja e florës dhe faunës së lumit dhe; -Mjedis i pastër.
Mostrajtimi i ujërave atmosferike.	Ndërtimi i kanaleve për disiplinimin e ujërave atmosferike.	** Afatmesëm	Ministritë përkatëse; -Donatorët dhe; -Komuna.	-Shmangen përmbytjet e qytetit dhe; -Evitohen ndotjet e rrugëve e me këtë edhe mjedisit.
1.3 Sistemi i ujitjes -Dëmtimi i kanaleve të ujitjes dhe; -Rrjeti i kanaleve të ujitjes.	-Riparimi i kanaleve të ujitjes; -Ndërtimi i kanaleve të ujitjes dhe; -Riparimi dhe ndërtimi i pendëve për ujitje.	*** Afatmesëm	-Komuna; -Ministritë përkatëse dhe; -Donatorët	-Rritje e prodhimit të bujqësore; -Uji i pastër; -Shtim i sipërfaqes së tokës në sistemin e ujitjes; -Rritje e sip. të gjelbëruara; -Përdorim i kontrolluar i ujit dhe; -Minimizim i humbjeve të ujit.
1.4 Ujërat nëntokësore	-Studimi hidrologjik për rënien e nivelit të ujërave nëntokësore dhe; -Pyllëzimi i sipërfaqeve të zhveshura.	*** Afatmesëm	-Ministria e Ambientit dhe Bujqësisë, dhe; -Komuna.	-Përmirësim i ekosistemeve në rajon; -Rritja e sipërfaqeve të pyllëzuara dhe; -Përmirësim i klimës.

2. TOKA

Problemi	Veprimet	Prioriteti - Afati kohor	Akterët	Efekti
2.1 Tokat bujqësore a. Copëzimi i sipërfaqeve të tokave.	-Të bëhet rigrupimi i sipërfaqeve të tokave (komasacioni); -Nxjerrja e rregulloreve për përdorimin e tokave bujqësore; -Kontrollimi i lëvizjes demografike të popullatës dhe; -Zbatimi i planeve hapësinore dhe atyre rregulluese.	*** Afatshkurtër	Ministritë përkatëse; Komuna dhe; Donatorët	-Rritje ekonomike; -Rritje e sipërfaqeve të tokës; -Rritja e rendimenteve bujqësore dhe -Rritje e mirëqenës dhe përmirësim i mjedisit.
b. Përmbytjet e tokave bujqësore.	-Rregullimi i shtretërve të lumenjve; -Hapja e kanaleve kulluese dhe; -Pastrimi i kanaleve ujitëse dhe ndërtimi i tyre.	*** Afatshkurtër	Komuna; Ministritë dhe; Qytetarët	-Rritja e sip. prodhuese; -Zhvillim ekonomik; -Ruajtja e sipërfaqes bujqësore; -Shtim i prodhimit; -Shtim i sektorit të blegtorisë dhe; -Mjedis i këndshëm.
c. Konkurrenca jo e drejtë në treg. d. Rënia e interesimit për të punuar tokën.	-Hartimi i politikave favorizuese; -Stimulimi i fermerëve me kredi të volitshme; -Organizimi i trajnimeve për menaxhimin e pemishteve dhe mbjelljen e bimëve industriale (farorëve, vreshtave), dhe; -Shtimi i masave stimuluese-subvencioneve shtetërore për bujqësinë.	*** Afatmesëm	Ministritë; Komuna; Donatorët dhe; OJQ-të.	-Rritje e interesimit për bujqësi; -Kushte më të mira jetese; -Hapja e vendeve të reja të punës; -Zhvillim ekonomik; -Ngritja e nivelit të dijës të fermerëve dhe; -Aplikimi i teknologjive të reja në bujqësi.
2.2 Tokat pyjore	-Ndalimi i prerjes së pyjeve; -Pastrimi i tokave; -Ndalimi i shfrytëzimit pa kriter i kullosave dhe; -Plehërimi i sipërfaqeve të caktuara të kullosave.	** Afatgjatë	Komuna dhe Ministritë përkatëse.	-Shtim i sip. tokësore; -Mjedis i mirë; -Klimë e përshtatshme; -Përmirësohet gjendja e kullosave dhe; -Zvogëlohet rreziku nga erozioni.
2.3 Tokat erozive a. Prerja pa kriter i pyjeve. b. Zhveshja e sipërfaqeve të tokave nga gurëthyesit.	-Menaxhimi i mirë i pyjeve; -Stopo prerjes së pyjeve; -Stopo eksploatimit të natyrës; -Vendosja e rrytave mbrojtëse dhe pyllëzim i sip.; -Pyllëzimi i sipërfaqeve të zhveshura; -Parandalimi i shfrytëzimit joracional i resurseve natyrore dhe; -Ndërtimi i pendëve dhe gardheve mbrojtëse.	** Afatgjatë	Ministritë; Komuna dhe; Donatorët.	-Zvogëlim i rrezikut nga erozioni; -Mbrojtja e mjedisit; -Mbrojtja e jetës së njerëzve; -Mbrojtja e sip. së tokës; -Pengimin i prurjeve të ngurta nga përrenjtë malor dhe; -Zvogëlon rrezikun e përmbytjeve në zonën urbane.

<p>2.4 Tokat ndërtimore</p>	<p>-Hartimi i planeve rregulluese për pjesën tjetër të territorit; -Zbatimi i planeve aktuale; -Inspektim dhe mbrojtje e tokave sipas planeve; -Zbatimi i ligjeve dhe -Ngritje e kapacitetesh projektuese.</p>	<p>*** Afatshkurtër</p>	<p>Qeveria; Komuna</p>	<p>-Qytezë e urbanizuar; -Infrastrukturë cilësore; -Mbrojtje e sip. së tokave; -Banim cilësor; -Qytezë e planifikuar; -Ndalon parregullsitë urbanistike dhe; -Rritë cilësinë mjedisit, zvogëlon shtimin e inerteve dhe ndotjen e ajrit.</p>
<p>a. Shtimi i trafikut në qytet. b. Mungesa e vend-parkingjeve.</p>	<p>-Ndërtimi i rrugëve transite; -Largimi i komunikacionit të rëndë nga zona e banimit; -Stop vendosjes së veturave në trotuare; -Hartimi i studimeve për rikonstruimin e rrjetit rrugor; -Ndërtimi i vend-parkingjeve sipas planeve dhe; -Zbatimi i planeve ekzistuese.</p>	<p>*** Afatmesëm</p>	<p>Ministritë; Komuna dhe; Donatorët.</p>	<p>-Përmirësim i kualitetit të jetës; -Përmirësim i ajrit; -Lehtësim për këmbësorë; -Përmirësimi i qarkullimit të automjeteve dhe të këmbësorëve; -Mbrojtja e zonave të veçanta të qytezës nga mbingarkimi; -Qytezë e urbanizuar; -Qytezë mjedisore dhe; -Mbrojtje e mjedisit.</p>
<p>c. Mungesa e hapësirave të lira.</p>	<p>-Studim fisibiliteti për parkun “Moronica”; -Hartim i planit rregullues dhe zbatimi i tij për parkun “Moronica”; -Rregullimi i sip. rreth lumit “Erenik”; -Të bëhet rregullimi, përkatësisht gjelbërimi, i mjediseve të shkollave; -Mirëmbajtja e oborrit të gjimnazit K. i Junikut dhe; -Ndërtimi i urave për këmbësor mbi lumin “Erenik” - lidhja me “Moronicën”.</p>	<p>*** Afatshkurtër</p>	<p>Ministritë; Komuna dhe; Donatorët.</p>	<p>-Krijimi i mjediseve për rekreacion e sporteve; -Përmirësim i peizazhit; -Ngrit vlerat turistike të qytetit; -Lidhja e urbanes me natyrën; -Mjedis i shëndoshë dhe; -Popullatë sportive.</p>

3. AJRI

Problemi	Veprimi	Prioriteti - Afati kohor	Akterët	Efekti
a. Ndotja e ajrit nga emetimi i gazrave të dëmshëm për shëndetin.	-Eliminimi i deponive të mbeturinave në vende urbane dhe rurale; -Stop djegies së mbeturinave; -Ndërtimi i një furre moderne për djegien e mbetjeve spitalore të rrezikshme; -Largimi i komunikacionit të rëndë nga zona e banimit dhe; -Vendosja e fermave jashtë zonës së banimit.	*** Afatshkurtër	Ministritë; Komuna dhe; Donatorët.	-Ulë rrezikun nga sëmundje të ndryshme të rrugëve respiratorë, bronkiet dhe astme-bronkiale; -Minimizim i ndotjes së ajrit; -Minimizon ndotjen e ajrit rreth territorit të QKMF-së dhe; -Mjedis i shëndoshë.
b. Ndotja e ajrit nga pluhurat.	-Pastrimi i rrugëve dhe trotuareve, me mjete për larjen e rrugëve; -Asfaltimi i rrugëve dhe rrugicave në qytet dhe zona urbane dhe; -Sigurimi i aparatit monitorues për matjen e cilësisë së ajrit nga ndotësit e ndryshëm.	*** Afatmesëm	Ministritë; Donatorët dhe; Komuna.	-Përmirësim i situatës mjedisore; -Njohja e saktë e situatës së ndotjes së ajrit, si dhe rrit mundësinë e ndërhyrjes në zbutjen ndotësve në zona të banuara të qytezës.

4. BIODIVERSITETI

Problemi	Veprimet	Prioritet - Afati kohor	Akterët	Efekti
4.1 Biodiversiteti a. Rrezikimi i florës dhe faunës e sidomos i specieve të rralla.	-Hulumtimi dhe studimi lidhur me llojet e florës dhe faunës; -Inventarizimi i zonave të pasura me florë dhe faunë; -Vënia nën mbrojtje e këtyre zonave; -Të hartohet strategjia për ruajtjen e biodiversitetit dhe; -Të bëhet studimi për llojet e rrezikuara të specieve të veçanta dhe mbrojtja e tyre.	*** Afat mesëm	Ministritë; Komuna; Donatorët dhe; OJQ-të.	-Ruajtja e llojllojshmërisë; -Zhvillim i turizmit; -Pasuri mjedisore; -Mbrojtja e specieve të veçanta të bimëve dhe shtazëve; -Ruajtja e ekosistemeve.
b. Pyjet.	-Menaxhim i mirë i pyjeve; -Ndalimi i prerjes pa kriter i pyjeve; -Pastrimi sanitar i pyjeve: <ul style="list-style-type: none"> • Stanishta e Goqit; • Struka; • Stanishta e Stubllës; • Rrasat e Zogut; -Pyllëzimi i sipërfaqeve të zhveshura; -Preventivë për tharjen e halorëve dhe; -Mbrojtjen nga insekti ipso.	*** Afat mesëm	Ministritë; Komuna; Agjensioni pyjor dhe; Donatorët.	-Mbrojtja e mjedisit; -Ruajtja e resursit pyjor; -Zhvillim ekonomik; -Efekt në turizëm; -Efekt në klimë; -Llojllojshmëri mjedisore; -Ruajtja e peizazheve dhe; -Ruajtja e vlerës ekologjike.
c. Sigurimi i mbijetesës, florës dhe faunës.	-Pastrimi sanitar i pyjeve; -Dërgimi i ushqimit për faunë gjatë dimrit; -Ndërtimi i shtëpizave për shtazë dhe shpezë; -Ruajtja e qetësisë së pyllit; -Masat mbrojtëse ndaj tharjes së	*** Afat mesëm	Ministritë; Komuna; Shoqata e gjuetarëve dhe; Agjensioni pyjor.	-Mbrojtja e florës dhe faunës; -Zhvillimi i pasurive natyrore; -Mundësi më të mëdha për vizita turistike; -Mundësi për zhvillim të

	<p>halorëve;</p> <p>-Hulumtimi i sëmundjes së gështenjës;</p> <p>-Masat mbrojtëse ndaj tharjes së gështenjës;</p> <p>-Shtimi i sipërfaqeve pyjore;</p> <p>-Mbrojtja e mjedisit nga mbeturinat;</p> <p>-Vendosja e shportave për mbeturina në lokacione të caktuara dhe largimi i tyre sipas orareve, dhe;</p> <p>-Ndalimi i gjuetisë së paligjshme, si dhe gjuetisë në kohën e shumimit.</p>			<p>qëndrueshëm;</p> <p>-Ruajtja dhe shtimi i vlerave të larmisë biologjike;</p> <p>-Shtimi i shtazëve dhe shpendëve të rrezikuar nga zhdukja;</p> <p>-Zhvillimi i gjuetisë sportive dhe turistike;</p> <p>-Ruajtje dhe kultivim i llojllojshmërisë dhe;</p> <p>-Mjedis i pasur.</p>
4.2 Zonat e mbrojtura.	<p>-Futja e tërë sipërfaqes së “Bjeshkëve të Junikut” në kuadër të projektit për Shpalljen e “Bjeshkëve të Nemuna” - Park Nacional;</p> <p>-Zbatimi i kuvendit të Junikut për “Moronicën” si zonë e veçantë;</p> <p>-Sensibilizimi i komunitetit për njohjen e vlerave të zonave të mbrojtura dhe rëndësinë e tyre;</p> <p>- Hartimi i planit hapësinor për zona të veçanta-kullat dhe objektet të tjera të trashëgimisë;</p> <p>-Hulumtimi dhe inventarizimi i zonave të cilat duhet të vihen nën mbrojtje dhe;</p> <p>-Hartimi i strategjive për shfrytëzim të zonave të mbrojtura.</p>	<p>***</p> <p>Afat shkurtër</p>	<p>Ministritë; Komuna’ OJQ-të mjedisore dhe; Komuniteti .</p>	<p>-Mbrojtja dhe zhvillimi i planifikuar i mjedisit;</p> <p>-Ruajtje e origjinalitetit;</p> <p>-Ruajtje dhe kultivim i llojllojshmërisë;</p> <p>-Ruajtja e ekosistemeve (zinxhirit natyror);</p> <p>-Ruajtja e florës dhe faunës;</p> <p>-Ruajtja dhe kultivimi i peizazhit dhe;</p> <p>-Mjedis i pasur me llojllojshmeri.</p>

5. MJEDISI SOCIAL DHE EKONOMIK

Problemi	Veprimet	Prioritet - Afatet kohore	Akterët	Efekti
5.1 Arsimi a. Mungesa e një strukture të plotë mjedisore në shkolla dhe në komunitete. Mungesa e programeve mjedisore.	<p>-Futja e lëndës së mjedisit si lëndë e obligueshme;</p> <p>-Publikim i materialeve të shkruara, botim i librave për edukimin mjedisor;</p> <p>-Mbajtja e kampeve natyrore;</p> <p>-Kampet për botanikë;</p> <p>-Kampet për hulumtim të llojllojshmërisë mjedisore dhe;</p> <p>-Organizimi i ekskursioneve mjedisore në natyre .</p>	<p>**</p> <p>Afat mesëm</p>	<p>Ministria e Arsimit dhe; Komuna.</p>	<p>-Vetëdije për mjedisin;</p> <p>-Kultivim i traditës mjedisore;</p> <p>-Vetëdijesim për llojllojshmerinë;</p> <p>-Mbrojtja e përgjithshme e mjedisit dhe;</p> <p>-Rritje e vlerave turistike.</p>
5.2 Bujqësia Zvogëlimi i sipërfaqes së tokës.	<p>-Të bëhet bashkimi dhe rregullimi i tokave (komasacioni);</p> <p>-Të sigurohet tregu për prodhime bujqësore;</p> <p>-Të subvencionohen prodhuesit bujqësorë;</p> <p>-Të zbatohen në përpikëri planet ekzistuese;</p> <p>-Të kontrollohen ndërtimet e reja;</p> <p>-Të sigurohet infrastruktura bujqësore;</p> <p>-Të zgjidhen problemet për rrugët sezonale;</p> <p>-Rregullimi i kanaleve të ujitjes për</p>	<p>***</p> <p>Afat mesëm</p>	<p>Ministria përkatëse; Komuna dhe; Donatorët.</p>	<p>-Rritet vullneti i të interesuarve për bujqësi;</p> <p>-Shfrytëzim i mirë i tokës;</p> <p>-Rritje e prodhimtarisë;</p> <p>-Rritje e sipërfaqes së tokës punuese;</p> <p>-Zhvillim ekonomik dhe;</p> <p>-Rritë mirëqenien e popullatës.</p>

	tokat bujqësore dhe; -Hapja e sipërfaqeve të tokës të mbuluara me shkurre.			
Ulje e nivelit të punësimit në bujqësi.	-Aplikimi i teknologjive të reja në prodhimtarinë bujqësore; -Ofrimi i infrastrukturës adekuatë për eksportin e prodhimeve bujqësore; -Ngritja e serave për prodhimin e perimeve; -Trajnime për fermerët; -Ndihmë fermerëve në planifikim për bujqësi; -Sigurimi i tregut për prodhime; -Sigurimi i pikave grumbulluese për prodhimet bujqësore dhe; -Konkurrenca e drejtë.	*** Afat shkurtër	Qeveria; Komuna; Donatorët dhe; Fermerët.	-Rritë mirëqenien; -Edukim në menaxhim të sektorëve bujqësorë; -Rritje e kapaciteteve prodhuese; -Prodhime të freskëta në çdo stinë; -Ulë importin e prodhimeve perimore; -Rritje e numrit të të interesuarve për bujqësi; -Zhvillim ekonomik dhe; -Regjenerim i të hyrave.
5.3 Blegtoria Pakësim i krerëve në Blegtori.	-Sigurim i tregut për prodhimet nga ky sektor; -Hapja e fabrikës për përpunim të leshit dhe lëkurave; -Hapja e fabrikës për përpunim të mishit; -Stimulim për shtimin e fondit në blegtori dhe; -Përmirësim i racave të kafshëve me potencial të lartë prodhimi.	** Afatmesëm	Ministria e Bujqësisë; Komuna dhe Donatorët.	-Ulja e papunësisë; -Rritja e zhvillimit ekonomik; -Mundësi për turizëm; -Ruajtje e llojllojshmërisë; -Rritje e eksportit të bio-prodhimeve; -Përmirësim i racave; -Rritje e mirëqenies dhe; -Shtim i prodhimit për treg.
Mungesa e reparteve për përpunimin e prodhimeve blegtorale.	-Përkrahje e blegtorëve përmes kredive të volitshme dhe afatgjate; -Krijimi i reparteve për përpunim; -Krijimi i pikave shitëse dhe; -Krijimi i pikave grumbulluese.	*** Afat shkurtër	Qeveria; Bankat dhe; Donatorët.	-Sigurim i jetesës; -Rritje ekonomike; -Mundësi turistike; -Rritje e të ardhurave; -Shtim i fondit blegtoral dhe; -Aplikimi i teknologjive të reja prodhuese.

6. TURIZMI

Problemi	Veprimet	Prioritet - Afatet kohore	Akterët	Efekti
a. Mungesë planifikimi për zhvillimin e turizmit.	-Hartimi i strategjisë në nivel vendi për zhvillimin e turizmit dhe; -Hartim i strategjisë lokale për zhvillim të turizmit.	*** Afatshkurtër	-Komuna; -Ministria përkatëse; -Donatorët dhe; -OJQ-të mjedisore.	-Përcakton zhvillimin turistik të Komunës; -Turizëm i planifikuar dhe i akorduar; -Turizëm përfitues për banorët dhe; -Harmonizon politikat Zhvillimore.
b. Mungesa e produktit turistik.	-Krijimi i paketave turistike në nivel regjional; -Krijimi i paketave me llojllojshmëri prezantuese; -Hapja e një ueb- faqes turistike; -Promovimi i turizmit në panairë ndërkombëtare; -Promovimi i paketave në ueb-faqe për turizëm dhe; -Hartimi i një plani rregullues që përcakton kriteret mjedisore	*** Afatmesëm	Ministritë; Komuna dhe; Donatorët.	-Mbrojtja e mjedisit; -Gjenerimi i të hyrave; - Zhvillim ekonomik; -Përfitim i qytetarëve; -Rritje e numrit të turistëve; -Zhvillim turistik i zonës dhe; -Shtim i vlerave turistike.

	për zhvillimin e turizmit.			
c. Mungesa e studimeve të atraksioneve turistike malore.	<ul style="list-style-type: none"> -Të hulumtohen zonat me potencial; -Të inventarizohen dhe vendosen në harta zonat potenciale; -Të promovohen zonat potenciale; -Ndërtimi i rrjetit të rrugëve malore; -Të bëhet evidentimi dhe hulumtimi i shpellave; -Hartimi i planeve rregulluese për fshatrat turistike dhe zbatimi i këtyre planeve; -Krijimi i infrastrukturës për vizita në atraksionet turistike dhe; -Edukim për personel për atraksionet turistike. 	*** Afatmesëm	Qeveria; Komuna; Donatorët; Komuniteti dhe; OJQ-të mjedisore.	<ul style="list-style-type: none"> -Përfitim për banorët; -Zvogëlim i papunësisë; -Ruajtje e llojlojshmërisë; -Zhvillim i qëndrueshëm; -Mbrojtja e resurseve atraktive natyrore dhe; -Ruajtja e natyrës.
d. Menaxhimi jo i mirë i hotelierisë. d. 1. Mungesa e restauranteve tradicionale.	<ul style="list-style-type: none"> -Trajnimi i stafit udhëheqës të hotelierisë; -Trajnim i personelit ndihmës; -Trajnime për gastronomi; -Trajnime për ushqime tradicionale dhe; -Inicimi, përkrahja dhe promovimi i turizmit rural-zakoneve dhe ushqimeve tradicionale. 	*** Afatshkurtër	Komuna; Ministria; Donatorët dhe; Biznesi privat.	<ul style="list-style-type: none"> -Menaxhim i mirë i hotelierisë; -Kushte më të mira për turistë; -Gjenerim i të hyrave; -Zbutje e papunësisë; -Zhvillim ekonomik; -Përmirësim i jetesës; -Rritja e fluksit të turistëve vendas dhe të huaj; -Ruajtje e trashëgimisë; -Rritja e vlerave tradicionale të vendit dhe; -Ngritja e kapaciteteve profesionale.
e. Trashëgimia kulturore dhe arkeologjike e pa hulumtuar.	<ul style="list-style-type: none"> -Të hulumtohet dhe dokumentohet neutraliteti i Junikut – film dokumentarë; -Të hulumtohet dhe dokumentohet ngjarja “Kuvendi i Junikut”, si film dokumentarë; -Të hartohet plani rregullues; -Të bëhet hulumtimi, inventarizimi dhe vënia nën mbrojtje e trashëgimisë; -Të bëhen hulumtime arkeologjike për “Gradinën” dhe; -Të bëhet hulumtimi, evidentimi dhe ruajtja e trashëgimisë së pasur shpirtërore, përmes botimeve të katalogëve dhe xhirimeve filmike me qëllim të promovimit turistik. 	*** Afatmesëm	Ministria; Komuna; Donatorët dhe; OJQ-të.	<ul style="list-style-type: none"> -Mbrojtje e trashëgimisë dhe lokaliteteve arkeologjike; -Funksionalizim i trashëgimisë; -Gjenerimi i të hyrave; -Ruajtja e kësaj trashëgimie të pasur nga degradimi i mëtejshëm; -Rritje e vlerave turistike në vend; -Promovimi i zonës; -Zhvillim ekonomik dhe; -Ngritja e kapaciteteve turistike.

PLANI I VEPRIMIT PËR ZBATIM

Plani i veprimit për implementimin e PLVM-së me monitorim dhe vlerësim

Prioriteti 1 – Trajtimi i ujërave dhe mbrojtja e lumenjve

Aktivitete Ligjore dhe Politike (L)

Aktiviteti	Lokacioni	Përshkrimi	Kriteri/Indikatorët e suksesit
L1	Junik	Hartimi i rregullores komunale për gjoba dhe dënime për ndotësit e ujërave.	Ulja e ndotjes së ujërave.

Aktivitete Administrative dhe Inspektuese (A)

Aktiviteti	Lokacioni	Përshkrimi	Kriteri/Indikatorët e suksesit
A1	Junik	Botimi i broshurave, palosjeve, për trajtimin e ujerave dhe mbrojtjen e lumenjve.	Njoftimi i popullatës me gjendjen e ujërave, rëndësinë dhe menaxhimin e tyre.

Aktivitete Teknike dhe Teknologjike (T)

Aktiviteti	Lokacioni	Përshkrimi	Kriteri/Indikatorët e suksesit
T1	Junik	Rregullimi dhe funksionalizimi i kolektorit për trajtim të ujërave të zeza në lumin “Erenik”.	Ujë i pastër për përdorim në bujqësi: -Mbrojtja e florës dhe faunës; -Prodhime bujqësore cilësore dhe; -Mjedis i pastër.
T2	Junik	Pastrimi dhe rregullimi shtratit të lumit “Erenik” edhe më tutje, pasi që janë realizuar dy faza.	Krijimi i hapësirave rekreative: -Krijimi i kushteve për sporte ujore; -Klimë e përshtatshme; -Mjedis harmonik me Natyrën dhe; -Mbrojtja e tokave nga përmytjet.
T3	Junik	Rregullimi i infrastrukturës dhe ndërtimi i urave këmbësorie mbi “Erenik” – lidhja me parkun “Moronica”.	Shfrytëzim në natyrë si: ecja, kalërimi, çiklizmi, vrapimi etj.
T4	Junik	Rregullimi i shtratit të lumit “Trava”.	Krijimi i kushteve të mira mjedisore: -Ruajtje e mjedisit dhe; -Ruajtje e kapaciteteve ujore.
T5	Junik	Rregullimi i shëtitores dhe hapësirave rreth lumit “Erenik”.	Krijimi i hapësirave publike: -Krijimi i kushteve rekreative, sportive; -Krijimi i mjedisit të këndshëm.
T6	Junik	Rregullimi dhe ndërtimi i pendëve të ujitjes.	
T7	Junik	Ndërtimi i kanaleve për trajtimin e ujërave atmosferik në qytet.	-Zhvillim i bujqësisë e me këtë edhe rritje ekonomike; -Krijim i vendeve të punës; -Përmirësim i jetesës dhe; -Shmang përmytjet e qytetit.
T8	Junik	Riparimi dhe ndërtimi i kanaleve të ujitjes.	Rritje e kapacitetit të ujit për ujitje: -Minimizim i ujit të humbur; -Shtim i prodhimtarisë bujqësore dhe; -Rritje ekonomike.
T9	Junik	Studimi hidrologjik për rënien e nivelit të ujërave nëntokësore.	Ujë i pastër.

L1 Plani i detajuar i implementimit të aktiviteteve

Lokacioni	Junik
Aktiviteti	L1
Emri i aktivitetit	Hartimi i rregullores komunale për gjoba dhe dënime për ndotësit e ujërave.
Objektivi	Të hartohet një rregullore e ambientit, e cila vendos gjoba për ndotësit e ujerave.

Fazat e punës		Organizata përgjegjëse	Vlera e përafërt (€)
1	Formimi i grupit punues.	Komuna dhe MMPH.	5000
2	Përfshirja e ekspertëve.	Komuna dhe donatorët.	2000
